

Nisi fushata,
referendumi
mund të presë
edhe pak


Fq.4



REVOLTA
QYTETARE

Vetëm
premtime për
malin e Gazi Babës

Fq.5



Ankohen
italianët:
Na mbyti
droga
shqiptare

Fq.20



Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3414 · e hënë, 16 korrik 2018

19°C | 31°C

15 DEN



KOHA për
sport

Fq.12-15

EDITORIAL

Mustafa
Nano, ajo
Serbia jote
ideale nuk
ekziston!



Mustafa Nano para ca ditësh kishte shku në Beograd për të kërkuar një Serbi ideale. Një Serbi me të cilën Shqipëria do të kufizohej në Morinë. Një Serbi që do ta kishte afër Shqipërinë, jo për diçka tjetër, por...

Fq.2

RAJON

Kë e frikëson
Ushtria e
Kosovës?

Fq.16

SPECIALE

Ylli i kuq
që drejtoi
BRSS-në

Fq.18

GLOBI

Cari i vdekur
që po ndanë
Putinin
nga Kisha

Fq.17



DREJT BE-SË DHE NATO-S ME NJERËZ TË PASTËR

KUR DO TË NDËSHKOHEN “TË FORTIT” E POLITIKËS?



Tek ekspertët, deri më tani ka dominuar mendimi se Maqedonia nuk mund të jetë përjashtuese sa i përket ndëshkimit të “të fortëve të politikës” nga vendet tjera të Ballkanit, përfshirë Kroacinë, Serbinë, Malin e Zi, Rumaninë, Bullgarinë dhe Shqipërinë. Kohëve të fundit, policia financiare vetëm se ka nisur procedurata ndaj funksionarëve të lartë shtetëror dhe disa biznesmenëve të përfshirë në larjen e parave

Fq.3

Prindi që shoqëron fëmijën, të lirohet nga pagesa

Shkup, 15 korrik - Procesi i shtrimit të fëmijëve në spital është i vështirë për prindërit. Situata paraqitet edhe më e vështirë për fëmijët me sëmundje të rënda për të cilët shtrimi në spital është më i gjatë, më i ndërlikuar. Gjatë procesit të hospitalizimit, fëmija i sëmurë duhet të ketë përkujdesje jo vetëm të mjekut, por edhe prindërit. Prindi që shoqëron fëmijën që trajtohet në kushte spitalore, bën pagesën 800 de-

narë në ditë. Për shumë prindër me të ardhura të ulta mujore, që kanë një fëmijë të sëmurë e të shtrirë në spital, kjo shumë është e lartë. Shoqatat e shoqërisë civile në emër të prindërve të fëmijëve që qëndrojnë në spital për një kohë të gjatë kërkojnë të lirohen prindërit nga kjo pagesë. Kjo kërkesë sipas tyre është e vjetër dhe duhet të rishqyrtohet për shkak se ende nuk është zgjidhur. Rregullorja...

Fq.6



EDITORIAL

MUSTAFA NANO, AJO SERBIA JOTE IDEALE NUK EKZISTON!



Emin AZEMI

Mustafa Nano para ca ditësh kishte shku në Beograd për të kërkuar një Serbi ideale. Një Serbi me të cilën Shqipëria do të kufizohet në Morinë. Një Serbi që do ta kishte afër Shqipërinë, jo për diçka tjetër, por për ta pasur më lehtë ta gjente gjeografin e ri Mustafa Nanon tekta po e fshinte nga harta e Ballkanit Republikën e Kosovës. Në Tiranë ka si Mustafa edhe të tjerë që e duan Serbinë për shkak të Beogradit që iu duket si Parisi, Roma, Berlini, Madridi etj. Është ky kompleks i njohur i njerëzve inferiorë që gjejnë një mijë e një arsye për ta justifikuar gjendjen e tyre shpirtërore që është e barasvlershme me kërkesat minimale për të patur një vend të rezervuar në ndonjë tavolinë kafeneje në "Beogradska Terazija", ku mund të shoqërohesh me shlivovicë tekta vajtueshëm këndohet balada për ushtarin e plagosur që një ditë sërish do të kthehet në fushën me lulëkuqe të Kosovës për ta rimarrë në "gjiun e nanës Serbi".

Kishim dëgjuar marrëzira të shumta të njerëzve në Tiranë që historinë po e trajtonin si një lëndë plasteline, që mund t'i japësh formë sipas legenit që ta jepnin të tjerët, por ja që tani na u shtua edhe gjeografia si lëndë e njerëzve të marrë që shkojnë në Beograd dhe deklarojnë se duhet përrjashuar Kosovën nga diskursi i marrëdhënieve të mira fqinjësore në mes të Serbisë dhe Shqipërisë. Në Beograd ka plotë intelektualë serbë që kur dëgjojnë marrëzitet e Mustafa Nanos habiten me sasinë e pakontrolluar të injorancës që ky njeri shpërndan tekta mundohet ta shohë çështjen shqiptare pa Koovën si determinuese kryesore e marrëdhënieve shqiptaro-serbe. Sot nuk është kurrfarë problemi t'i vardisesh dikujt dhe t'i shprehësh hapur ndjenjën e përlulisë, por është problem shumë i madh kur projekton realitete që as një diplomat perëndimor, madje asnjë intelektual liberal në Beograd nuk e përfill, nëse në atë projektion Kosova paraqitet si pjesë e Serbisë. Mustafa Nano mund të jetë frymëzuar nga Kushtetuta serbe e cila Kosovën ende e trajton si pjesë integrale të Serbisë dhe vetëm aty mund të gjejë preheje ideja e tij për një marrëdhënie shqiptaro-serbe, e cila do të ishte shumë ideale po të mos ishte Kosova. Ai në Beograd tha se ka më shumë gjëra që i bënë të

njëjtë serbët dhe shqiptarët dhe sipas tij Kosova nuk do të duhej të shërbente si pengesë që Serbia e Kosova të kenë marrëdhënie të shkëlqyera. Nuk e di për cilat gjëra të njëjta ka mendu Mustafai, por e di që shqiptarët në historinë e tyre asnjëherë nuk kanë ngulë pleq e fëmijë serbë nëpër hunj, siç bënë serbët në krahinën e Lumës e Dibrës gjatë luftërave Ballkanike, e di që shqiptarët asnjëherë nuk dhunuan vajzat serbe në sytë e nënave të tyre siç bënë kriminelët e Arkanit dhe Millosheviqit në Kosovë, e di që politikanët kosovarë as që u ka shku mendja të organizojnë ndonjë krim në mesin e shqiptarëve që pastaj t'i fajësojnë serbët, siç vepruan politikanët serbë, e di që asnjë diplomat i Tiranës nuk ka provuar të mohojë identitetin nacional e kulturor të serbëve, siç po bëjnë politikanët serbë të cilët nuk kanë lënë institucion ndërkombëtar pa trazuar në dëm të mëvetësisë së Kosovës dhe kulturës së saj, e di që nuk ka një autor a ideolog shqiptar të ketë hartuar ndonjë elaborat për shfarosjen e serbëve siç vepruan Çubrilloviqi, Gjorgjeviqi, Andriqi, Cvijiqi etj. Di edhe shumë pangjashmëri në mes të shqiptarëve dhe serbëve, ashtu siç di edhe jo pak virtyte të serbëve, por asnjëherë nuk më ka shkuar mendja ta barazojë shkallën time të përlulisë ndaj serbëve me tragjedinë e popullit tim që ia shkaktuan pikërisht pjesëtarët e atyre që paskan "gjëra të njëjta me shqiptarët".

Mustafa Nano mund ta dashurojë Serbinë me Kosovën si pjesë të saj që nuk duhet të paraqitet si guralec në opingën e tij, por Serbia o Mustafa nuk të do ty, jo pse nuk ka nevojë për një mbrojtës të zjarrtë të Kushtetutës së saj në mes të Tiranës, por ajo tani e ka hallin se si t'i disiplinon serbët e vet në Beograd që po kërkojnë hapur heqjen dorë nga Kosova, si kusht për normalizimin e marrëdhënieve shqiptaro-serbe. Për dallim nga demokratët serbë, Mustafa Nano nuk e konsideron Kosovën si kusht, por si hendikep të këtyre marrëdhënieve. Ky nuk është dallim i vogël konceptual, kurse ngjashmëritë që Mustafai i gjen në fantazinë e tij mund të jenë vetëm kartë-kredit për ndonjë projekt që do ta bënte atë me zyrë diku në "Knjez Mihajlova" në Beograd. Asgjë më tepër.

TRUMPI, PUTINI DHE KOSOVA

"Presidenti Trump krenohet se si ai po i zgjidh çështjet e mëdha për të cilat kanë folur të gjithë paraardhësit e tij, por nuk kanë ndërmarrë asgjë.

Ngjashëm paraqitet edhe presidenti Putin, duke theksuar se ai po i riparon dëmet në kurriz të Rusisë për shkak të liderëve të dobët rusë para tij.

Çka nëse në tryezë hidhet për diskutim çështja e Kosovës?

Dhe çka nëse dy liderët më të fuqishëm të globit pajtohen ad hoc për një model të caktuar të zgjidhjes së shpejtë, si mjet kusurritjeje për çështje më të mëdha? Nuk kemi parë të ketë ndonjë brengosje të theksuar nga klasa politike në Kosovë për këto zhvillime të hovshme në skenën politike botërore. Më me rëndësi, kush do ta fitojë Kampionatin Botëror në futboll helbete!", shkruan në profilin e tij në Facebook, gazetari nga Prishtina, Adriatik Kelmendi.



PASURIA NË DUART E INJORANTIT ËSHTË PASQYRA E DJALLIT

"Pasuria ka kuptim vetëm kur përdoret për qëllime të larta njerëzore, humane dhe kombëtare, jo edhe për kënaqësi personale! E vetmja sëmundje, nga më të rëndat në jetën e njeriut, për të cilën ne shqiptarët nuk duam të paguajmë mjekët e as ilaçet, ndërsa kërkojmë të shërohemi prej saj, është sëmundja „mungesës së lirisë dhe bërjes së shtetit (siç e duam)".

Për dallim nga periudha e Rilindjes kombëtare kur pasanikët shqiptarë kanë sakrifikuar gjithçka nga vetja dhe pasuria e tyre për shërimin e kësaj sëmundje, pasanikët (biznesmenët) e sotëm shqiptarë u ngajnë gjithnjë e më shumë mbretërve që vdesin me kokën në arkat e floririt, me shpresë se edhe botën tjetër mund ta blejnë me para. Nuk jemi rastësisht kështu siç jemi dhe këtu ku jemi!", shkruan në profilin e tij në Facebook, prof. Abdullah Mehmeti.



FSK DHE DEKLARATAT E SERBISË

"Së pari, Kosova nuk ka asnjë pretendim territorial. Së dyti, Forca e Sigurisë së Kosovës në tranzicion, do të jetë forcë mbrojtëse profesionale dhe shumetnike dhe sipas standardeve të NATO-s.

Për më tepër, se deklaratat e Serbisë janë të paqëndrueshme, dëshmojnë me faktin se Kosova nuk synon të zëvendësojë KFOR-in, nuk synon të zëvendësojë prezencën e NATO-s në Kosovë edhe pas tranzicionit të FSK-së, që do të ndodhë së shpejti...", shkruan në profilin e tij në Facebook, eksperti i sigurisë, Burim Ramadani.



MEDIA Citate

TË RINJTË KOSOVARË, NË VENDIN E TRETË PËR PASAPORTË ZVICERANE

Më pak se 500 të rinj kanë aplikuar për nënshtetësi zvicerane që kur ligji ndryshoi më parë këtë vit për të lehtësuar rregullat e natyralizimit për emigrantët e gjeneratës së tretë. Sipas Sekretariatit Shtetëror për Migrim (SEM), në mes të 15 shkurtit - kur hyri në fuqi ndryshimi i ligjit - dhe në fund të qershorit, 482 emigrantë të rinj të gjeneratës së tretë kërkuar një pasaportë zvicerane, shkruan "Swissinfo.ch".

Më së shumti kërkuar pasaportë zvicerane italianët (255), pasuar nga turqit (65), kosovarët (38), spanjollët (30), maqedonasit (17) dhe portugezët (17). Vitin e kaluar ka pasur një votim kombëtar për këtë çështje. Në shkurt 2017, 60.4% e votuesve miratuan një reformë për të thjeshtuar procedurën e shtetësisë për emigrantët, gjyshërit e të cilëve erdhën në Zvicër. Sipas profesorit të sociologjisë në Universitetin e Gjenevës, Philippe Wanner, rreth 25,000 të rinj të moshave 9 deri në 25 vjeç janë teorikisht të ligjshëm për një pasaportë. Procedura normale në Zvicër është se jo-shtetasit duhet të kenë kaluar dhjetë vjet në vend para se të aplikojnë për shtetësi, pas së cilës ata të ulen teste dhe intervista. Ligji i ri lehtëson barrën e kohës për ata që plotësojnë disa kushte. Ata duhet të kenë lindur në vend, të kenë një leje C, kanë shkuar në shkollë në Zvicër për pesë vjet dhe kanë një gjysh të lindur në vend ose që ka jetuar ligjërisht në Zvicër për të paktën gjashtë vjet. Moshë maksimale për aplikim përmes këtij kanali të lehtësuar është 25. Ashtu si me procedurën standarde, kandidatët pritet të jenë mirë të integruar në komunitetet e tyre dhe të respektojnë vlerat e kushtetutës zvicerane.

(Swissinfo.ch, 15 korrik)

NËSE NUK E KENI DITUR...

KUSH JANË SPONSORËT MË TË MËDHENJ TË BOTËRORIT?

Që nga viti 1982, Kupa e Botës është fituar gjashtë herë nga shtete europiane (dy herë nga Gjermania, dy herë nga Italia, një herë nga Spanja dhe një herë nga Franca), dhe tri herë nga shtete të Amerikës Latine (dy herë nga Brazili dhe një herë nga Argjentina). Për sa u përket sponsorëve më të mëdhenj, shpërndarja gjeografike është krejtësisht ndryshe. Në vitin 1986, katër kompani europiane, katër nga Amerika e Veriut dhe katër nga Azia e mbështetën këtë ngjarje sportive. Në vitet 1990, pati rritje të shpejtë

në sponsorizimin e shteteve nga Amerika e Veriut, e cila më pas u ndal në fund të atij dhjetëvjeçari. Edhe pse numri i shteteve europiane që fitonin këtë ngjarje të rëndësishme sportive rritej nga njëri Botëror në tjetrin, numri i kompanive europiane që po sponsorizonin këtë Kampionat erdhi në rënie. Në Botërorin e këtij viti, vetëm një kompani europiane ka sponsorizuar para në të. Pra, cili është tashmë shpenzuesi gjigant i ri? Azia! Në 2018-n, 7 nga 12 partnerët dhe sponsorët kryesorë janë nga Azia, rreth 60%.

Tek ekspertët, deri më tani ka dominuar mendimi se Maqedonia nuk mund të jetë përjashtuese sa i përket ndëshkimit të "të fortëve të politikës" nga vendet tjera të Ballkanit, përfshirë Kroacinë, Serbinë, Malin e Zi, Rumaninë, Bullgarinë dhe Shqipërinë. Kohëve të fundit, policia financiare vetëm se ka nisur procedurata ndaj funksionarëve të lartë shtetëror dhe disa biznesmenëve të përfshirë në larjen e parave

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 15 korrik - Qeveria këto ditë tërësisht është e dhënë pas festës lidhur me ftesën për anëtarësim në NATO. Të gjithë faktorët përjashtoj VMRO-në e Hristijan Mickovskit, kanë përgëzuar Qeverinë si për marrjen e ftesës për në NATO ashtu dhe për vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian për të çelë negociatën me Maqedoninë në qershor të vitit të ardhshëm. Të martën, në Shkup do të vijë për vizitë Komisioneri evropian për fqinjësi të mirë dhe politikë për zgjerim Johannes Han, përmes të cilit dhe do të fillojë skринingu për Maqedoninë, gjegjësisht analizimin e gjendjes në Maqedoni për të filluar më pas përshtatjen e plotë të legjislacionit vendor me legjislacionin evropian, me direktivat, rregulloret, vendimet dhe udhëzimet që i nxjerr Këshilli i Bashkimit Evropian.

Siç dihet, edhe tek plotësimi i kushteve për në NATO do të preken sektorët që lidhen edhe me kushtet e BE-së, sidomos në atë të sigurisë, inteligjencës, ushtrisë, doganave. Gjatë fundit të këtij viti, pas

DREJT BE-SË DHE NATO-S ME NJERËZ TË PASTËR

KUR DO TË NDËSHKOHEN "TË FORTIT" E POLITIKËS DHE GJYQËSISË?



mbajtjes së referendumit dhe sidomos nga fillimi i vitit të ardhshëm, më gjasë mund të vijë në shprehje edhe llogaridhënia politike, për të korrupuarit, personat e lidhur me krimin, keqpërdoruesit e organeve të inteligjencës dhe personat tjerë që kanë dëmtuar shtetin dhe qytetarët. Tek ekspertët deri më tani ka dominuar mendimi se Maqedonia nuk mund të jetë përjashtuese sa i përket ndëshkimit të "të fortëve të politikës" nga vendet tjera të Ballkanit, përfshirë Kroacinë, Serbinë, Malin e Zi, Rumaninë, Bullgarinë dhe fundmi - Shqipërinë. Te kjo e fundit, ministri i Punëve të Brendshme, Sajmir Tahiri u detyrua të japë dorëheqje si rezultat i ndjekjes së prokurorisë italiane në bashkëpunim me prokurorinë shqiptare si i dyshuar për lidhje kriminale, konkretisht me transportuesit e drogës nga Shqipëria në Itali. Në Kroaci kishim kryeministrin në detyrë, Ivo Sanader, i cili u detyrua të japë dorëheqje si i dyshuar për përfshirje

në larjen e parave.

Shqipëria, megjithëse ende mbahet e përkëdhelur sa i përket politikanëve kryesor, në këtë vend fqinj ka nisur një proces tejet serioz i ashtuquajtur Veting, për verifikimin e pasurisë së gjyqtarëve prokurorëve, policisë dhe funksionarëve qeveritar. Ky proces pritet të pastrojë shtetin dhe politikanë nga të inkriminuarit, sekserët, keqpërdoruesit e ndryshëm. Në Maqedoni, me raste ka pasur ndëshkim të korrupsionit në gjykata, por nuk është ndërmarrë asgjë që të verifikohet prejardhjen e pasurisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Me ndryshimet e fundit është bërë një përparim i vogël, duke i hequr mundësinë gjykatave, gjegjësisht Këshillave penal që të kërkojnë përgjegjësinë e gjyqtarëve, por atë do ta bëjë Këshilli Gjyqësor.

Ajo që është e vërtetë është se askush nuk kërkon llogari se filan gjyqtari apo prokurori, por edhe ministri a drejtori si ka ardhur deri tek

pasuria, tek disa marramendëse, ku me pagë prej 1 mijë euro nuk kanë pasur asnjë mundësi të kursejnë dhe të blejnë shtëpi luksoze, vetura luksoze dhe gjëra tjera super të shtrenjta. Ish-prokurori Aleksandar Nakov për TV21, ka thënë se me ndryshimet eventuale ligjore, vetingu i gjykatësve lehtë do të zbatohet në vend.

"Kjo është mënyrë e kontrollimit dhe freskimit të gjyqësorit, si një mënyrë për reforma në vetë gjyqësorin. Me këtë bëhet shqyrtim i gjendjes materiale të gjykatësve, integritetit dhe kapacitetit të tyre personal, por edhe i rezultateve të arritura gjatë punës së tyre", thotë ish-prokurori Nakov.

Si shembull për këtë hap, më së shpeshti përmendet Shqipëria. Edhe nga Koalicioni për Gjykim të Drejtë, kanë thanë se në kushte në të cilat gjendet sistemi gjyqësor në Maqedoni, përmirësimi i vetëm i gjendjes, e cila për vite me radhë kritikohet në raportet vendore dhe

ndërkombëtare, është kontrolli i gjykatësve. "Shembulli më i afërt të cilin do ta kisha përmendur është Republika e Shqipërisë. Reformat e fundit të cilat i kanë bërë ata si shtet, është procesi i vetingut të gjykatësve, i cili për fat të keq tek ne nuk u lejua dhe nuk u zbatua. Mendoj se për të bërë ndonjë reformë thelbësore, kjo është një nga mënyrat më të përshtatshme në kushtet në të cilat është gjyqësori në Maqedoni për momentin", ka deklaruar nga Koalicioni për Gjykim të Drejtë, Natali Petrovska. Nevojën për një hap të tillë, Petrovska e arsyeton edhe me Raportin e Ministrisë së Drejtësisë, në të cilin janë cekur një sërë parregullish gjatë shpërndarjes kompjuterike të lëndëve nëpër gjykata. Por sa i përket veprimet politik të shumicës qeveritare, shumë gjëra po i vonon për ndëshkimin e kriminit dhe korrupsionit. Ka katër muaj që anëtarët e Komisionit për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit ka dhënë dorëheqje dhe në Parlament ende nuk janë votuar të rinjtë. Një element negativ që i bën hije të zezë Qeverisë është dhe afrimi i personave si këshilltar të kryeministrit me të kaluar negative si Zoran Verushevski ish drejtor i Shërbimit Sekret i etiketuar në opinion me rastin "Sopoti" dhe Lube Boshkovski ish ministri i Policisë gjatë konfliktit të vitit 2001. Po ashtu në poste qeveritare aktualisht ka persona që përfliteshin për keqpërdorime të mëdha edhe atë jo vetëm maqedonas por ehe shqiptar nga aradhet e BDI-së duke i dëgjuar bisedat mes tyre gjatë materialeve të përgjuara.

PARTITË TË PADARKORDUARA PËR KONSTITUIMIN

Sot pritet që në Parlament të koordinohen edhe një herë qëndrimet e partive politike lidhur me këtë çështje, por edhe për të parë mundësi të reja për tejkalimin e ngërçit politik

Koha

Evis HALILI

Shkup, 15 korrik - Kjo është java e fundit ku çështja për formimin e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve duhet të mbyllet. Çdo vonesë për zgjedhjen e anëtarëve të KSHZ-së do të sillte automatikisht

Java përfundimtare për KSHZ-në

edhe shtyrjen e afateve të parashikuara për zhvillimin e referendumit. Të hënën pritet që në Parlament të koordinohen edhe një herë qëndrimet e partive politike lidhur me këtë çështje, por edhe për të parë mundësi të reja për tejkalimin e ngërçit politik. Nëse në nivel të grupeve të punës nuk arrihet që të dakordohen pozicionet e tyre, takimi i liderëve është një prej mundësive që nuk përjashtohet. VMRO-DPMNE insiston që në bisedimet për KSHZ-në të përfshihet edhe paketa e reformave. Kreu i kësaj partie, Hristian Mickovski, ka mohuar zërat për tentativat për bllokimin e procesit të zgjedhjes së anëtarëve të rinj të këtij trupit të ri të zgjedhjeve në

shkëmbim të ligjit për amnistinë.

"Kjo çështje nuk duhet shikuar ndaras nga paketa e reformave, pasi procesi filloi me të ashtuquajturat ligjet e reformave, të cilat ishin të miratuara në mars dhe prill të këtij viti. Opozita mori pjesë në krijimin e tyre dhe miratimin kur u kthye nga bojkotimi disa muaj. Puna e dytë është miratimi i Ligjit për financimin e partive politike, ku duhet të definohen të njëjtat kushte që i kishte opozita në kohën e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 2016, e më pastaj do të vijë në rend të ditës formimi i KSHZ-së", ka deklaruar Mickovski.

Ndërkohë që kryeministri Zaev për këto kërkesa të VMRO-DPM-

NE ka lënë me dije se nuk nevojiten negociata shtesë, pas marrëveshjes së Përzahinos, ndërsa ligji për financimin e partive që është dorëzuar në Parlament ka për qëllim që t'i bëjë më imune partitë politike ndaj korrupsionit dhe çfarëdolloj ndikimi. Nga BDI prasin të bisedojnë edhe një herë për harmonizimin e qëndrimeve. Koordinator i grupit parlamentar, Ejup Alimi, thotë se në takimin e së hënës me kreun e Parlamentit Talat Xhaferi të hënën do të shohin se cilat janë të rejtat lidhur me këtë çështje. "Do të mblidhemi për të koordinuar qëndrimet lidhur me zgjedhjen e anëtarëve të KSHZ. Çdo parti do të prononcohet për qëndrimet e veta, por po ashtu do

të shihen edhe të gjitha mundësitë e tjera për zgjidhjen e kësaj çështje", thotë Halimi. Zgjidhja e anëtarëve të KSHZ ka skaduar më 29 qershor. Por edhe pse partitë politike i kanë emrat e përfaqësuesve të tyre në KSHZ, kryetari i Komisionit për zgjedhje dhe emërim, Ilija Dimovski, ende nuk e ka vendosur datën se kur do të mbahet seanca. KSHZ duhet t'i bëjë të gjitha përgatitjet për referendumin, që është një prej detyrave që del nga Marrëveshja për zgjedhjen e çështjes së emrit dhe partneritetit strategjik me Greqinë, por edhe pjesë e procedurave të brendshme që duhet të zbatohen para anëtarësimin të plotë të vendit në NATO.

"Maqedonia ka arsye të festojë. Pritëm ngjarje të mëdha. Po i realizojmë qëllimet e tona të përbashkëta strategjike, ëndrrat dhe shpresat e tona të përbashkëta. Koncertet sonte janë ftesë për bashkim me të gjithë dallimet tona politike rreth qëllimeve të realizuara strategjike të vendit tonë - anëtarësim në BE dhe NATO", porositi Zaevi

Shkup, 15 korrik - Me festën e një dite më parë në 15 qytete të Maqedonisë, edhe zyrtarisht ka filluar fushata për referendumin për mbështetje të Marrëveshjes me Greqinë për emrin e vendit. Të shtunën mbrëma, kremtimi qendror u mbajt në Shkup, ndërsa u festua edhe në 14 qytete tjera të Maqedonisë, derisa u përmend ftesa për në NATO e marrë javën e kaluar në Samitin e Brukselit. Nën moton "Ecim përpara, Maqedonia në BE dhe NATO", kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev nga Manastiri theksoi se pas pritjeve të gjata, Maqedonia ka arsye të fortë për të festuar.

"Maqedonia ka arsye të festojë. Pritëm ngjarje të mëdha. Po i realizojmë qëllimet e tona të përbashkëta strategjike, ëndrrat dhe shpresat e tona të përbashkëta. Koncertet sonte janë ftesë për bashkim me të gjithë dallimet tona politike rreth qëllimeve të realizuara strategjike të vendit tonë - anëtarësim në BE dhe NATO", porositi Zaevi. Sipas tij, këto janë ngjarje që na janë dhënë dhe të merituar si dhe atë që ta dër-

VMRO BETONOHET KUNDËR MARRËVESHJES PËR EMRIN

NISI FUSHATA, REFERENDUMI MUND TË PRESË EDHE PAK



gojmë në histori dhe ta harrojmë njëherë e përgjithmonë sindromin që ta shkatërrojme suksesin e tjetrit sepse çdo sukses është sukses për të gjithë ne, për të gjithë qytetarët.

Ai vlerësoi se atë që e bëri Maqedonia për vetëm një vit është sukses për të gjithë pa dallim të përcaktimit politik. "Kemi se pse të festojmë dhe të ngrihemi mbi ndarjet. Tani si asnjëherë deri më tani t'ia shtrijmë dorën njëri-tjetrit. Dëshiroj t'i ftoj të gjithë qytetarët dhe t'i porosim sot se forcat që na ndajnë nuk janë aq të fuqishme sa forcat që na bashkojnë. Forcat që na bashkojnë janë data për negociata me BE-në dhe ftesa për anëtarësim në NATO. Ato janë forcat që na hapën ardhmërinë", thek-

soi Zaev. Në Shkup ndërkohë ishte organizuar festa qendrore, ndërsa të pranishmëve iu drejtua zëvendëskryeministrja dhe ministre e Mbrojtjes, Radmilla Shekerinska, ministri i Punëve të Jashtme,

Nikolla Dimitrov, si dhe zyrtarë tjerë të Qeverisë.

Megjithatë, sapo kishte nisur festa në sheshet e qyteteve të vendit, ka reaguuar VMRO-DPMNE e Hristijan Mickovskit. VMRO ka

akuzuar Qeverinë se me festat po manipulon qytetarët, siç kanë thënë në VMRO, për gjoja ftesë për anëtarësim në NATO.

"Qytetarët e Maqedonisë, përkundrazi, nuk kanë asnjë arsye për të festuar. Maqedonia u kthye mijëra hapa mbrapa. As ftesë për në NATO dhe as ftesë për në BE nuk kemi marrë, ndërsa jemi të vetmit liderë në korrupsion, kriminalitet dhe vrasje. Kjo Qeveri nuk është asgjë tjetër pos cirkut. Për këtë arsye, duhet të rrënohet dhe largohet nga pushteti. Mjaft me gënjeshtër", tha zëdhënësi i VMRO-së, Dimçe Arsovski. Ndryshe nga festat e LSDM-së në 15 qytete, VMRO po të shtunën mbrëma realizoi një protestë në qytetin e Kavadarit, ndërsa ka hedhur poshtë çfarë do lloji mbështetje për referendumin. (E.H)

ADEMI I SIGURT NË SUKSESIN E REFERENDUMIT

Ministri për Diasporën, Edmond Ademi, shpreson se referendumi do të jetë i suksesshëm, sepse sipas tij, pjesa dërmuese e qytetarëve të Maqedonisë janë të vetëdijshëm se çka do të thotë votimi pro NATO-s dhe Bashkimit Evropian. "Realisht nuk shoh asnjë problem se si do të përfundojë referendumi. Jam absolutisht i sigurt se do të jetë pozitiv dhe mendoj se qytetarët janë të vetëdijshëm për momentin historik dhe se verdiktin e tyre do ta japin shumë qartë në ditën kur do të mbahet ky referendum", deklaroi Ademi. I pyetur për bllokimet që bën opozita maqedonase gjatë kësaj kohe, Ademi thekson se VMRO ende nuk ka dalë nga kthetrat e politikanëve

të korruptuar. "Fatkeqësisht, edhe pse opozita maqedonase ka lidhë të ri, akoma është nën kthetrat e politikanëve të korruptuar dhe të kriminalizuar, para se gjithash mendoj për ish-kryetarin si dhe anëtarët tjerë. Ata ende janë të kapur nga kthetrat e kësaj strukture dhe këtu është shumë i qartë pozicioni, ose je pro NATO dhe BE, ose je kundër. Asnjëfarë amnistie nuk vjen parasysh, të jetë si kushtëzim për diçka që veç partitë politike janë dakorduar për krijimin e KSHZ-së. Kushtet e reja që VMRO i kërkon qoftë për amnisti apo diçka tjetër, ato janë budallallëk për skenën aktuale politike", tha Ademi.

Pas Marrëveshjes së Prespës fillon një erë e re

Athinë, 15 korrik - Marrëveshja e Prespës është shumë e rëndësishme dhe pozitive edhe për Greqinë edhe për IRJ të Maqedonisë dhe mendoj se edhe në rrugën drejt finalizimit të marrëveshjes, por edhe menjëherë pastaj do të mund të zbatohet në praktikë shumë ide të mira dhe pozitive për bashkëpunim të dy vendeve në nivel të teknologjive të reja. Kështu në një intervistë për MIA ka thënë ministri grek për politikë digjitale dhe media, Nikos Pappas, ndërsa është shprehur i sigurt se tashmë mes dy vendeve ekzistojnë edhe ide, të cilat në të ardhmen do të realizohen dhe potencoi se tani, fillon era e re për dy shtetet. "Ndërlidhja dhe politika digjitale janë fushat e aktiviteteve të cilat mund t'i sjellin dy vendet së bashku drejt hapit të ardhshëm

drejt të ardhmes. Ekzistojnë mundësi të mëdha për zhvillim të përbashkët dhe dy palët jemi të vendosur që t'i shfrytëzojmë. Megjithatë mendoj se është herët të bisedojmë për gjëra konkrete, por në këtë moment ne e përshpejtojmë politikën digjitale dhe jemi më shumë të lumtur që t'i ndajmë me fqinjët tanë, me ish-Republikën jugosllave të Maqedonisë, ide dhe aktivitete për projekte të këtu", ka thënë Pappas, sipas të cilit, vetëm çështja e emrit, për bashkëpunim më të afërt mes dy vendeve. "Vetëm çështja e emrit ishte pengesë gjithë këtyre viteve. Për fat të keq ishte pengesë, keq edhe për Greqinë keq edhe për ish-Republikën jugosllave të Maqedonisë. Mirëpo tash, po fillon një erë e re", u shpreh Pappas.

Bashkëpunimi i suksesshëm politik dhe operativ

Shkup, 15 korrik - Avancimi i bashkëpunimit bilateral policor me qëllim që të përfordhet lufta kundër krimit të organizuar, si dhe përmirësim të qarkullimit të udhëtarëve në vendkalimet kufitare midis Maqedonisë dhe Kosovës, kanë qenë pjesë e temave për të cilat në Shkup kanë biseduar ministrat e Punëve të Brendshme të Maqedonisë dhe Kosovës, Oliver Spasovski dhe Bejtush Gashi.

Siç kumtuuan nga MPB-ja, ministri Spasovski i ka prezantuar përvojat e deritanishme dhe punën e Sektorit për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale, të cilët janë të orientuar drejt konfirmimit të veprimit joprofesional dhe jologjor të nëpunësve policorë dhe të punësuarve në MPB. Ai ka theksuar se Sektori bashkëpunim



edhe me organizatat qytetare dhe Avokatin e Popullit dhe e ka njoftuar kolegun e tij me modelin e ri të vendosjes së mekanizmit të pavarur të jashtëm për kontroll mbi punën policore.

Ministrat janë dakorduar që në periudhën vijuese të realizohen vizita dhe takime të përbashkëta të

nivelit të ekspertëve, në interes të avancimit të bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe ballafaqim të përbashkët me kanosjet globale të sigurisë. Që të dytë kanë vlerësuar se bashkëpunimi i deritanishëm midis dy ministrat është i suksesshëm edhe në nivelin politik dhe atë operativ.

QYTETARËT KËRKOJNË MIRËMBAJTJEN E GJELBËRIMIT

VETËM PREMTIME PËR MALIN E GAZI BABËS

Institucionet lokale dhe qytetarët nuk mund të arrin "pajtim" për mirëmbajtjen e malit të Gazi Babës. Përderisa njërës palë i kujtohet të investojë kohë pas kohë, qytetari i cili vazhdimisht e viziton këtë pjesë të qytetit të Shkupit, fare pak kontribuon për ruajtjen e ambientit dhe të mirës publike

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 15 korrik - Parku në malin e Gazi Babës nevojitet të mirëmbahet dhe rregullohet në mënyrë të vazhdueshme. Kjo është kërkesë e banorëve dhe qytetarëve që gati për çdo ditë e vizitojnë këtë kompleks rekreativo-sportiv. Investimet dhe rregullimi i këtij mali, i cili ofron kushte tepër të volitshme për rekreacion, siç thonë banorët që jetojnë përreth tij, nuk janë bërë një kohë të gjatë. Si pasojë e mungesës së vetëdijes qytetare dhe mungesës së riparimit në një pjesë ulëseve, shtigjeve për vrapim dhe veglat për fitnes janë dëmtuar. Qytetarët që jetojnë në afërsi të Fakultetit Matematiko-Natyror në lagjen e

Gazi Babës, shprehin pakënaqësi ndaj faktit se institucionet lokale - Qytetit i Shkupit dhe Komunës e Çairit, gjatë dy viteve të kaluara fare pak janë interesuar për këtë pjesë të gjelbëruara të qytetit. Ndonëse kur me Qytetin e Shkupit udhëhiqte Koce Trajanovski, u realizua ndërtimi i fushës së sportit dhe hapësirës përreth, banorët shqiptarë thonë se ai nuk arriti ta plotësoi premtimin e dhënë për ndërtimin e parkut dhe investimeve tjera. Të vetëdijshëm se pozita e këtij kompleksi, sipas kompetencave është e ndarë në mes Qytetit të Shkupit, Komunës së Gazi Babës dhe asaj të Çairit, qytetarët njëzëri kërkojnë rritjen e kujdesit institucional ndaj kësaj pasurie natyrore. Lidhur me këtë çështje, nga Qyteti i Shkupit, thonë se ato vazhdimisht kujdesen për rregullimin dhe mirëmbajtjen e parkut në malin e Gazi Babës, me çka shtojnë se deri në fund të vitit pritet të përgatitet plani gjithëpërfshirës për menaxhimin afatgjatë të aktiviteteve që realizohen në këtë pjesë të qytetit.

"Mirëmbajtja e pajisjeve dhe veglat të vendosura është paraparë me Programin e vitit 2018, i miratuar nga Këshilli dhe i dhënë për realizimin NP 'Parqe dhe Gjelbërime'. Për rinovimin e pajisjeve ekzistuese dhe hapësirë së gjelbër, po ashtu janë paraparë një milion denarë, të cilat në muajt në vazhdim do të investohen në terren", thonë nga Qyteti i Shkupit.

Padyshim se barra më e madhe për plotësimin e nevojave të qytetarëve bien mbi Komunën e Çairit, për të cilën

banorët shprehin se deri më tash, nuk ka reaguar ndaj kërkesave dhe problemeve të tyre. Uzurpimi i hapësirës publike dhe dëmtimi i shtyllave të futbollit dhe të basketbollit paraqesin njëherë prej brengave të banorëve të kësaj ane.

Autoritetet e Çairit nuk i mohojnë vërejtjet dhe kritikën e qytetarëve, por njoftojnë se gjatë kësaj periudhe po ndërmerren masat e nevojshme për realizimin e shumë aksioneve përgjatë territorit të saj e që kanë të bëjnë kryesisht me përmirësimin e infrastrukturës rrugore, krijimin e infrastrukturës adekuate sportive, mirëmbajtjen e nivelit të pastërtisë publike dhe lirim të hapësirave të uzurpuara.

"Duke e pasur parasysh këtë dinamikë pune, kuptohet se pjesë e planit operativ të funksionimit është edhe riparimi i zonës rekreativo-sportive në parkun e malit Gazi Babë. Në rrjedhë e sipër është përgatitja e procedurës ligjore për ulëset dhe shportat për mbeturina, e publikuar në Sistemin Elektronik për Furnizime Publike dhe me përfundimin e saj, ndër lokacionet prioritet ku do të vendosen të njëjtat, është edhe zona në fjalë. Për dinamikën e punës, kohën dhe detajet e realizimit të punimeve, opinionin do ta informojmë me kohë", thonë nga Komuna e Çairit.

Ndryshe, në malin e Gazi Babës, krahas aktiviteteve individuale, shumë klube lokale të çiklistëve, futbollit dhe mundjes i shfrytëzojnë për përgatitjet e tyre fizike. Viteve të fundit janë realizuar edhe gara në çiklizëm.

Buxheti i mbrojtjes do të rritet gradualisht

Tetovë, 15 korrik - Zëvendësministri i Mbrojtjes, Bekim Maksuti, gjatë festës së mbrëmshme në Tetovë për marrjen e ftesës për anëtarësim në NATO, ka thënë se armata një kohë të gjatë ka përmbushur kushtet, por ka qenë vetëm aspekti politik ai që qenë i përmbushur. "Sigurisht se ne si Ministri e Mbrojtjes, gjegjësisht armata edhe deri më tani ka qenë e gatshme për në NATO, sepse nëse e bëjmë një analizë të të gjitha planeve aksionale

vjetore, këtë vit e filluam të 18-in radhazi, ne do të shohim që armata de facto ka qenë pjesë e NATO-s. Këtë e ka dëshmuar edhe me pjesëmarrje në misione ndërkombëtare, këtë e ka dëshmuar edhe me të gjitha aktivitetet e NATO-s, me pjesëmarrje nëpër shtabet dhe celulat tjera komanduese, mirëpo ishte aspekti politik ai që duhej të përmbushej. Nëse do të shihni planin aksional prej 18 pikëve, diku dy e treta e atyre u përkasin aspekte-

ve politike dhe vetëm një e treta i takon aspektit ushtarak, gjegjësisht të modernizimit. Pas ftesës, të gjitha pjesëmarrjet do të rriten nëpër shtab dhe misione, pavarësisht se numërikisht sado e vogël të jetë Maqedonia, të qenurit brenda NATO-s neve na bën anëtarë të plotfuqishme me anëtarët tjera", tha Maksuti. Në ndërkohë, ai shpreson se në të ardhmen do të rritet edhe buxheti për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Armatën.

KRONIKË

Plumbi qorr përfundoi në barkun e 23-vjeçarit

Në një çajtoreshë në Haraçinë, të shtunën është lënduar një burrë njëzet e tre vjeçar nga një plumb qorr. I lënduari është dërguar në spitalin e qytetit ku i është dhënë ndihma mjekësore. Nga MPB kumtuam se në ora 23:00 nga ana e Urgjencës është denoncuar se në një çajtoreshë në rrugën "10" ku ka qenë mysafirë, E.I., është lënduar nga një plumb qorr. Personi është dërguar në Spitalin e përgjithshëm të qytetit "Shën Naumi i Ohrit", ku i është dhënë ndihma mjekësore dhe është konstatuar lëndim sipërfaqësor nga një plumb qorr në pjesën e stomakut. Policia ndërmerr masa për zbardhjen e rastit.

Arrestohen 32 "valltare" në Tetovë

Në një aksion kontrolli të MPB-së në dy objekte hotelierike në Tetovë janë arrestuar 32 vajza nga rajoni. Siç kumtoi MPB-ja, në aksionin që është zhvilluar nga 23 deri në ora tre të mëngjesit të shtunën, në dy objektet policia ka gjetur dhe ka arrestuar 22 shtetas të Shqipërisë, një të Kosovës, dy të Serbisë dhe shtatë të Maqedonisë.

Zhdukjet një 12-vjeçar nga Shkupi

Një djalosh 12-vjeçar nga Shkupi dje rreth orës 12 është zhdukur nga shtëpia familjare dhe është nisur në drejtim të panjohur. Siç kumtoi MPB-ja, rastin në Stacionin policor "Petrovec" e ka denoncuar e ëma e fëmijës, B.I.(39) nga Shkupi. Policia po ndërmerr masa për gjetjen e djaloshtit.

Në Vardar është gjetur trupi i një burri

Në ujërat e lumit Vardar afër fshatit Koçillarë, të Velesit, është gjetur trupi i një burri. Siç informoi edhe MPB-ja, për shkak të terrenit të vështirë, trupi i pajetë është nxjerrur me 24 orë vonesë, ndërsa po vijojnë ekspertizat dhe identifikimi i të ndjerit.

Bëhet i ditur identiteti i tre të lënduarve në Tetovë

Me urdhër të prokurorit publik janë dhënë urdhra për ekspertizë të armës, automjetit dhe gjurmëve të gjetura në vendin ku mbrëmë në Tetovë kishte këmbim zjarri në të cilin u lënduan tre persona. Me urdhër të prokurorit publik, të gjithë të involvuarve në incident do t'u merren doreza parafine për shkak të kontrollit të prezencës së grimcave të barutit, ndërsa do të kontrollohet edhe prezenca e alkoolit në gjak, informojnë nga Prokuroria Publike. Ndryshe, në policinë e Tetovës thonë se përlëshja e armatosur në Tetovë të shtunën mbrëmë në rrugën "29 Nëntori" do të zbardhet në tërësi shumë shpejt. Rasti ishte paraqitur në ora 02:20 në stacionin e policisë në Tetovë. Lëndime trupore nga pistoletat kishte marrë 37 vjeçari S.K. dhe 26 vjeçari S.K., ndërsa 49 vjeçari M.A. kishte përfunduar me lëndime në kokë. Që të tre, për shkak të seriozitetit të lëndimeve janë dërguar në kompleksin e klinikave "Nëna Terezë". Zëdhënësi i SPB Tetovë, Marjan Josifovski, deklaroi se menjëherë pas denoncimit në terren kanë dalë ekipet e SPB Tetovë dhe nga Prokuroria publike dhe se nga vendi i ngjarjes janë marrë një revole e tipit "Zbroevka", kornizë me tetë plumba dhe pesë gëzhoja. Në vendin e ngjarjes është gjetur edhe një automjet udhëtimi "mercedes" me targa të Tetovës.

PËRSËRITET KËRKESA E SHOQËRISË CIVILE

PRINDI QË SHOQËRON FËMIJËN NË SPITAL, TË LIROHET NGA PAGESA

Prania e një fëmije të sëmurë në familje është stresuese në çdo moment dhe ky stres ndihet shumë nëse fëmija ndodh të ketë një çrregullim, i cili kërkon kujdes të vazhdueshëm dhe shtrime të përsëritura në spital. Sëmundja e fëmijës prek të gjithë familjen



Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 15 korrik - Procesi i shtrimit të fëmijëve në spital është i vështirë për prindërit. Situata paraqitet edhe më e vështirë për fëmijët me sëmundje të rënda për të cilët shtrimi në spital është më i gjatë, më i ndërlikuar. Gjatë procesit të hospitalizimit, fëmija i sëmurë duhet të ketë përkujdesje jo vetëm të mjekut, por edhe prindërit. Prindi që shoqëron fëmijën që trajtohet në kushte spitalore, bën pagesën 800 denarë në ditë. Për shumë prindër me të ardhura të ulta mujore, që kanë një fëmijë të sëmurë e të shtrirë në spital, kjo shumë është e lartë. Shoqatat e shoqërisë civile në emër të prindërve të fëmijëve që qëndrojnë në spital për një kohë të gjatë kërkojnë të lirohen prindërit nga kjo pagesë. Kjo kërkesë sipas tyre është e vjetër dhe duhet të rishqyrtohet për shkak se ende nuk është zgjidhur. Rregullorja thotë se nëse fëmija është deri në moshën tre vjeçare dhe prindi e shoqëron, prindi nuk paguan ndejnë në spital. Por për një fëmijë mbi tre vjeç që është në spital me një prind, prindi gjithashtu paguan tetëqind denarë në ditë. Nëna me iniciale I.M, e cila është shtruar në spital,

për ta shoqëruar fëmijën e saj të sëmurë, thotë se asnjë nënë nuk ka guxim ta lë vetëm në spital, fëmijën e vogël. Jo vetëm për kujdes mjekësor, por fëmija ka nevojë për ta ngushëlluar, për ta argëtuar, në mënyra të ndryshme. Ajo shton se ka parë prindërit që janë të dëshpëruar kur fëmija do të duhet të vazhdojë qëndrimin e tij në spital e ata të mos janë prezent. Pra, në vend të merakoset prindi për fëmijën e sëmurë, ai shqetësohet më shumë për pagesën e faturës. Nga spitali për fëmijë në Kozle, gjegjësisht Instituti për sëmundjet pulmonare thonë se shpesh ka raste kur pacientët, madje prindi me fëmijën, ikën pa paguar detyrimet spitalore. Drejtori i këtij spitali, dr. Angelço Andonovski thotë se prindërit që janë të liruar nga pagesa, janë vetëm rastet social, e jo të tjerët. Ai sqaron se kanë parasysh se një fëmijë, qoftë i moshës 7 vjeçare, që është ende i sëmurë ka nevojë për një prind pranë tij. Ligji thotë se

nëse fëmija është tre vjeç dhe për një ditë, prindi që shoqërohet fëmijën duhet të paguajë. Andonovski shton se një dispozitë e tillë duhet të ndryshohet dhe se edhe ata fëmijë të moshës 4, 5, 6, 7 vjeç, është e nevojshme të kenë nënën ose babain pranë. Nga shoqata "Jetë me sfida" thonë se ky është një problem i gjatë që duhet zgjidhur. Kujdestari prindërorë për një fëmijë të sëmurë duhet të jetë plotësisht e lirë, pa pagesë ose të zvogëlohen çmimet që aplikohen. Asnjë nënë nuk do ta linte një fëmijë përveçse kur ajo nuk do të ketë një zgjedhje tjetër. Nga kjo shoqatë thonë se shpresojnë që një zgjedhje e përshtatshme do të gjendet në këtë çështje. Ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe, paralajmëroi se programi qeveritar ka parashikuar masën për lirim nga participimi për shërim spitalor për të gjithë qytetarët.

I pyetur nga gazeta "Koha", nëse mund të ketë lirim nga pagesa

edhe prindi që shoqëron fëmijën e sëmurë në spital, Filipçe u përgjigj se ka një kërkesë nga ana e prindërve dhe shoqatave që moshën e caktuar të fëmijëve të sëmurë që shoqërohen në spital të rritet dhe këtë janë duke e rishqyrtuar.

Poashtu Filipçe përsëriti se nga fillimi i vitit të ardhshëm trajtimi spitalor do të jetë plotësisht falas, por kjo nuk do të thotë se klinikat dhe spitalet do të mbesin pa mjete. Nga buxheti përmes Fondit për Sigurim Shëndetësor të Maqedonisë do të investohet vlerë shtesë në të gjitha klinikat dhe spitalet. Dhe se në asnjë rast nuk do të pakësohet numri i metodave të reja të cilat planifikojmë t'i implementojnë. Ndryshe, prania e një fëmije të sëmurë në familje është stresuese në çdo moment dhe ky stres ndihet shumë nëse fëmija ndodh të ketë një çrregullim, i cili kërkon kujdes të vazhdueshëm dhe shtrime të përsëritura në spital. Sëmundja e fëmijës prek të gjithë familjen.

Këtë vit numër rekord turistësh

Ohër, 15 korrik - Ministri i Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi, të dielën zhvilloi një vizitë pune në Ohër, ku u takua me kryetarin e Komunës së Ohrit, Jovan Stojanovski, dhe pas takimit me kryetarin e komunës u takua me përfaqësues të Shoqatës së Hotelierëve të Maqedonisë HOTAM, me të cilët bisedoi për sezonin turistik 2018 dhe masat e qeverisë për të mbështetur objektet turistike të vendit. Ministri Bekteshi tha se këtë vit shënohet rritje e numrit të turistëve dhe bujtjeve në gjithë vendin, e sidomos në qytetet e Strugës dhe Ohrit. "Vitin e kaluar e përmbyllëm me afro 1 milion turistë dhe me 2.7 milion bujtje. Në kuartalin e parë të këtij viti kemi 227.000 turistë me afro 470.000 bujtje, dhe duke pasur parasysh se dy kuartalet kryesore veç më janë në vijim, presim që numri prej 1 milion turistëve të tejkalohet. Në Strugë kemi dyfishim të numrit të turistëve dhe bujtjeve, ndërsa në Ohër një rritje shumë të kënaqshme", deklaroi Bekteshi. Kryetari i Ohrit Jovanovski tha se sezoni turistik është shumë i suksesshëm dhe se kapacitetet e hotele janë të mbushura plotësisht. "Neve i kemi kapacitetet e përmbushura, ajo që biseduam me ministrin Bekteshi është çfarë të ndërmarrim që ti plotësojmë kapacitetet jashtë sezonit", deklaroi Jovanovski pas takimit. Kryetari i Shoqatës së hotelierëve HOTAM, Blazhe Kërsteovski the se është i kënaqur me mbështetjen që kanë nga pushteti lokal dhe ai qendror. "Hotelet punojnë me kapacitet të plotë, ndërsa ai shoqatë dhamë propozimet tona se ai mund ti plotësojmë ato edhe jashtë sezonit turistik", tha Kërsteovski. Bekteshi paralajmëroi edhe lëshimin e katër aero-linjave nga aeroporti i Ohrit drejt qendrave evropiane, përmes kompanive me buxhet të ulët.

Për gjashtë muaj, 57 foshnja të vdekura

Shkup, 15 korrik - Nga 26 në 17 ka rënë përqindja e vdekjes së të sapolindurve në gjashtë muajt e parë të këtij viti krahasuar me të njëjtën periudhë vitin e kaluar. Aktualisht, Maqedonia ka numrin më të vogël të vdekjes të foshnjave në rajon, apo është e para sa i përket mbijetesës së foshnjave të lindur në javën e 23-të. Në Klinikën e Gjinekologjisë, ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe, dje informoi se vitin e kaluar, kanë vdekur gjithsej 82 foshnja, ndërsa këtë vit, 57.

"Kjo është rezultat i investimeve të Qeverisë në inkubatorë për përkujdesje intensive të ashtuquajtur GAK, në ekipimin edhe më të madh të ekspertëve, të punësit të mbi 20 infermiere-



ve...", tha ministri Filipçe, ndërsa siguroi se Ministria e Shëndetësisë do të vazhdojë investimet në mjete për Gjinekologjinë e Shkupit, por edhe qyteteve tjera.

Mes tjerash, ministri informoi se shumë shpejt, do të ketë edhe një ekipim të ri të mjekëve dhe infermierëve në Klinikën e Gjinekologjisë, por edhe edukim të tyre

në Klinikën gjinekologjike të Sofjes, në Bullgari. Mjekja Elizabeta Petkovska ndërkohë informoi se 80 nga 85 për qind e foshnjave të vdekura kanë qenë me proble-

me të lindura: peshë tepër të vogël, më pak se 1.5 kilogram, ndërsa disa të tjerë kishin lindur me komplikime në mushkëri dhe mungesë zhvillimi e sistemit nervor. Duke bërë paralele me nivelin e vdekjeve sivjet dhe vitin e kaluar, Petkovska tha se në 2017 kishte 336 lindje dhe 82 vdekje, ndërsa këtë vit, 321 lindje dhe 57 vdekje.

"Jo vetëm që u parandalua trendi i vdekjes së foshnjave, por kemi edhe ulje. Arritëm suksese edhe në uljen e vdekjeve të foshnjave të lindura në javën nga 29 deri në 36, ku ishte më e theksuar vdekja e të sapolindurve", tha mjekja Alizabeta Petkovska, duke shtuar se aktualisht, në inkubatorë po trajtohen 42 foshnja të lindura para kohe. (D.K)

PEMË-PERIMET MË TË EKSPORTUARA

KRYESOJNË RRUSHI DHE DOMATET

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 15 korrik - Rrushi i freskët dhe mollët me nga 12 milion euro, si dhe domatet dhe lakra me nga 15 milionë euro, janë pemë-perimet më të eksportuara në Maqedoni në vitin e kaluar. Nga ana tjetër, Rusia me eksport të vlefshëm 7.5 milionë euro është shteti ku më shumë eksportojmë perime. Më së shumti pemë dhe atë rrush në vitin e kaluar me vlerë prej pesë milionë euro në vitin 2017 si shtet kemi eksportuar në Serbi.

Sipas analizës së revistës "Kapital", eksporti i pemë-perimeve në vitin e kaluar ishte 150 milionë euro. Rekord i eksportit në periudhën e kaluar arriti kulminacionin në vitin 2016 me 171 milionë euro, duke shënuar rritje për 67 milionë euro në raport me vitin 2017, kur u shënuar eksport i pemë-perimeve prej 104 milionë euro. Agronomët thonë se Maqedonia, krahas shumave të mëdha të subvencioneve prej afër qindra milionë euro, që për çdo vit ju ndahen fermerëve, akoma nuk ka shfrytëzuar kushtet e volitshme klimatike, por edhe traditën e bujqësisë vendore për të prodhuar më shumë prodhime bujqësore që mund të plasohen në tregjet e jashtme.

Agronomët kërkojnë një angazhim më të madh të shtetit në gjetjen e tregjeve të reja për prodhimet bujqësore, por edhe orientimin e fermerëve që të plotësojnë standardet e ndryshme që kërkohen për pemë-perimet në tregjet e jashtme, duke filluar nga ato për sasitë maksimale të pesticideve që mund të përdoren, periudhën e karencës apo të bëhet kujdes se pas përdorimit të një pesticide duhet të shikohet karencja e tyre (karencja është data kur spërkatet bima dhe koha e caktuar që produkti i bimës



Rrushi i freskët dhe mollët me nga 12 milionë euro, si dhe domatet dhe lakra me nga 15 milionë euro janë pemë-perimet më të eksportuara në Maqedoni në vitin e kaluar. Nga ana tjetër, Rusia me eksport të vlefshëm 7.5 milionë euro është shteti ku më shumë eksportojmë perime, ndërsa Serbia me pesë milionë euro rrush, shteti ku shesim më shumë pemë

të mos përdorët). Nëse produkti i bimës përdoret më herët sesa karencja e paraparë, atëherë fryti i përdorur mund të ketë efekte negative në konsumatori. Probleme me karencën, para disa vitesh shkaktuan edhe telashe të mëdha me eksportin e trangujve nga Maqedonia në shtetet e jashtme.

Njëherazi, analizat tregojnë se potencial më të madh për eksport nga Maqedonia kanë pemët, pjeshkat, kumbullat, dredhëzat dhe sidomos qershitë, vishnjat, boronicat

dhe mjedrat. Gjithashtu edhe mollët japoneze kanë një potencial të madh eksporti. Sa i takon perimeve, trangujt, por edhe lulëlakra dhe brokula, patëllxhani i zi, kungujt, si dhe kërpudhat kanë mundësi të madhe të për eksport.

Të dhënat më tej tregojnë se shtetet fqinje që janë anëtare të CETA-s, Rusia dhe shtetet e Bashkimit Evropian janë destinacionet kryesore eksportuese të pemë perimeve të freskëta vendore.

Sipas agronomëve, është me interes për bujqësinë e Maqedonisë të bëhet orientimi i prodhimit sipas predispozitave që kanë regjionet e caktuara për prodhimin e pemëve, perimeve apo prodhimeve blegtorale. Kërkohej të bëhet edhe planifikimi i prodhimit sipas trendeve të zhvillimit të tregut për të mënjeluar mundësinë e paraqitjes së tepërisë së prodhimit të një kulture të caktuar bujqësore dhe mungesën e një kulture tjetër në treg, që si pasojë sjell çrregullimin dhe disbalansin e çmimeve të atij produkti, ku një vit është i papërbalueshëm për konsumatorin, ndërsa viti tjetër është i vështirë për prodhuesin.

Në ndërkohë, analiza tregon se në vitin e kaluar kemi eksportuar edhe pjeshka në vlerë prej afër 3.8 milionë euro, kumbulla në vlerë prej 2.7 milionë euro, shalqi në vlerë prej 2.5 milionë euro, vishnje dhe qershi në vlerë prej 1.5 milion euro, persimoni apo mollë japoneze me 900 mijë euro, kajsitë me afër 500 mijë euro, dredhëzat me afër 400 mijë euro etj.

Ndër perimet më të eksportuara në vitin 2017 me afër 9 milionë euro ishin specat, kërpudhat me 6 milionë euro, trangujt me afër 3.2 milionë euro, qepa me një milion euro, patatet me 800 mijë euro, patëllxhani i zi me 450 mijë euro, lulëlakra dhe brokoli me afër 140 mijë euro etj.

Ndryshe, sipas njohësve të bujqësisë dhe organizatave të fermerëve në Maqedoni, prodhimi stihik dhe laraman në vend të atij të specializuar bujqësor dhe orientimi për tu marrë me bujqësi si mjet ekzistence dhe jo si biznes fitimprurës, janë shkaqet kryesore të problemeve të përvitshme me plasmanin e sigurt të prodhimeve bujqësore të fermerëve në shtet.

Investim i ri në Bunarxhik, "Dura" fillon me ndërtimin e fabrikës

Shkup, 15 korrik - Në Zonën teknologjike industriale në Shkup, sot do të fillojë ndërtimi i kapacitetit prodhues të kompanisë amerikane "Dura". Bëhet fjalë për kompani nga industria automobilistike, ndërsa investimi vlerësohet në mbi 30 milionë euro. Këtë e paralajmëroi zëvendëskryeministri i angazhuar për Çështje Ekonomike, Koço Angjushev, duke iu përgjigjur pyetjes së gazetareve mbrëmë në Veles në kremtimin me rastin e ftesës për anëtarësim në NATO.

"Në shtatë-tetë muaj e fundit 16 investime kanë nënshkruar marrëveshje për hyrje në Republikën e Maqedonisë. Ajo që kryeministri e përmendi bëhet fjalë për "Dura"-n, e cila të hënën do të vendosë gur-themel në Bunarxhik në zonën e lirë doganore. "Dura" është kompani amerikane nga industria e automobilave me mbi 30 milionë euro investim. Qeveria nuk ka për qëllim të bëjë pi-ar të lirë nga çdo investim i huaj, ky investim është i investuesve. Ne vetëm u ndihmojmë ata që të vijnë dhe i inkurajojmë me gjithçka që mundemi si administratë atë ta bëjnë. Për këtë arsye ne nuk dëshirojmë të premë shirit, të hedhim lopatë, ne do t'i përshëndesim dhe do t'u dëshirojmë shumë fat, por do t'u mundësojmë që ata të vijnë", theksoi Angjushev dhe shtoi se Qeveria do të mundësojë që ata të vijnë. Ai potencoi se nëse në shtatë-tetë vitet e fundit në Maqedoni janë bërë 20 investime të tilla, tani për 10 muaj janë filluar 16 me ç'rast, siç tha, nuk shpenzuar të holla për marketing dhe shpresoj se qytetarët do të mund ta bëjnë dallimin. Paralajmëroi, gjithashtu, investime në rajonin e Velesit. "Mendoj se në Veles do të ketë investime madje një dhe ne intensivisht punojmë në këtë. Në Veles ka papunësi, por ajo nuk është aq e madhe. Ne duhet të sigurojmë më shumë punë për të rinjtë të cilët kanë përfunduar arsim të lartë në të ashtuquajturit akceleratorë përmes Fondit për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik. Për të rinjtë të cilët këtë me sukses e bënë nga Qeveria do të marrin grante dhe mendoj se kjo është mënyra që të ecet përpara", potencoi Angjushev. Lidhur me zgjidhjen e problemit me Fabrikën e Velesit për automjete të binarëve "Kolska", shpjegoi se për momentin po punohet në sigurimin e punës dhe pagës për të gjithë të punësuarit, por kjo siç tha, nuk është zgjidhje e përhershme.

Tevdovski optimist, pret investime pas hyrjes në NATO

Shkup, 15 korrik - Përvojat nga vendet e tjera tregojnë rritje të madhe të investimeve të drejtpërdrejta të huaja pas hyrjes në Aleancën e NATO-s. Nëse merret parasysh mesatarja nga pesë vite para dhe pas anëtarësimit të fqinjëve tanë Bullgaria dhe Shqipëria, shihet rritje e disahershme e investimeve të huaja, thotë ministri i Financave, Dragan Tevdovski, në deklaratë për MIA-n.

"Në Bullgari, investimet e drejtpërdrejta të huaja, analizuar pesë vite para dhe pas hyrjes në NATO, janë thuhetse tre herë më të larta, respektivisht 7 për qind në 19,8 për qind nga BPV-ja. Në Shqipëri janë dyfish më të larta, ose nga 5 për qind në 9 për qind nga BPV edhe atë në kohë të krizës

ekonomike botërore. Do të thotë, efektet mund të ishin edhe më intensive. Në Rumuni, gjithashtu ka rritje të lartë prej 2,8 për qind në 7,2 për qind pas hyrjes në NATO, në Çeki prej 3,2 për qind në 7,7 për qind, në Estoni prej 7,5 për qind në 13,5 për qind. Kjo është ardhje e kapitalit të freskët, që krijon fabrika të reja, kapacitete të reja prodhuese, vende të reja pune, prodhime të reja, transmeton know-jow", thekson Tevdovski.

Siç thekson stabiliteti dhe statusi ndërkombëtar që i sjell anëtarësimi në NATO, ndikojnë në vendimet e investimeve, si tek investuesit vendor, ashtu edhe të jashtëm. Në vendet e reja anëtare të NATO-s vërehet rritje edhe e nivelit të investimeve të përgjithshme.

Kështu që, në vendet që u anëtarësuan në NATO në vitin 2004, pjesëmarrja mesatare e bruto-investimeve në BPV janë rritur nga 25 për qind në periudhë pesëvjeçare para anëtarësimit në 31 për qind në periudhën pesëvjeçare pas anëtarësimit.

"Biznesi tek ne kërkonte anëtarësim në NATO dhe kjo është e logjikshme. Vendi do të ketë status më të mirë ndërkombëtar, do të jetë në shoqëri me vendet më të zhvilluara. Për bizneset do të jetë shumë më lehtë të hyjnë, të vendosin lidhje dhe të tregojnë pas hyrjes në NATO. Në vendet të cilat u anëtarësuan në NATO në vitin 2004, rritja mesatare e eksportit është rritur për 6.8 për qind në periudhën para anëtarësimit në



NATO në 11,8 për qind në periudhën pas anëtarësimit në NATO", thekson Tevdovski.

Ministri i Financave thekson edhe se hyrja në Aleancë do të thotë edhe ulje të rrezikut, që pozitivisht mund të ndikojë në rejttingun kreditor, gjegjësisht e njëjta të rritet.

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (tekst i pastruar Të publikuar në Gazetën zyrtare të RM nr. 167/2015 dhe ndryshim të plotësimit të LMP numër 27/2016 dhe ndryshimet dhe plotësimet të LMP numër 120/2018), nenit 5, 6, 7 dhe 8 të Marrëveshjes kolektive të Operatorit të sistemit elektropërçues të Maqedonisë, Shoqëria akcionare për përçim të energjisë elektrike dhe menaxhim me sistemin elektroenergetik në pronësi të shtetit Shkup ose shkurtimisht SHA MEPSO, Shkup (nr. ark. 02-6432 të datës 31.10.2013), dhe Vendimit numër 02-4414 të datës 12.07.2018 për nevojën e themelimit të marrëdhënies së punës, Operatori i sistemit elektropërçues të Maqedonisë, Shoqëria akcionare për përçim të energjisë elektrike dhe menaxhim me sistemin elektroenergetik në pronësi të shtetit Shkup ose shkurtimisht SHA MEPSO, Shkup publikon

SHALLJE PUBLIKE

Për nevojën e themelimit të marrëdhënies së punës me 22 (njëzetedy) punëtor për realizim të punëve për kohë të pacaktuar në Operatorin e sistemit elektropërçues të Maqedonisë, Shoqëria akcionare për përçim të energjisë elektrike dhe menaxhim me sistemin elektroenergetik në pronësi të shtetit Shkup ose shkurtimisht SHA MEPSO, Shkup.

Kandidatët, krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të përmbushin kushtet e posaçme për plotësim të vendeve të punës në vijim:

- 1 (një) realizues në vendin e punës bashkëpunëtor për furnizime komerciale në shërbimin për punë furnizuese komerciale, Departamenti për punë komerciale, Sektori për punë financiare, me përgatitje të mesme profesionale – PMP – shkalla IV, pa përvojë pune, për të cilin vend pune pagesa arrin 27.200,00 denarë.
- 1 (një) realizues në vendin e punës sekretar teknik në kabinetin e drejtorit në Sektorin për teknologji informatike dhe telekomunikim, me përgatitje të mesme profesionale – PMP – shkalla IV, me përvojë pune prej 1 viti, për të cilin vend pune pagesa arrin 27.200,00 denarë.
- 1 (një) realizues në vendin e punës ndihmës punëtor në arkiv në shërbimin për punë të përgjithshme, Departamenti për punë të përgjithshme, Sektori për punë juridike dhe të përgjithshme, me arsim fillor – shkalla I, pa përvojë pune, sholla fillore, për të cilin vend pune pagesa arrin 19.200,00 denarë.
- 1 (një) realizues në vendin e punës MONUTES 3 I MAKINERISË në punëtorin, në shërbimin për mirëmbajtje të ST, Departamenti për ST, Filiali OPM me përgatitje të mesme profesionale – PMP – shkalla III/ IV, shkolla e makinerisë, pa përvojë pune, për të cilin vend pune pagesa arrin 25.500,00 denarë.
- 1 (një) realizues në vendin e punës MIRËMBAJTËS TË HIGJIENËS në Punëtorin, në shërbimin për mirëmbajtje të ST, Filiali OPM me arsim fillor – shkalla I arsimit fillor, pa përvojë pune, për të cilin vend pune pagesa arrin 19.200,00 denarë.
- 1 (një) realizues në vendin e punës ELEKTRICIST REPARTI, ST SKOPJE 4, në shërbimin për PTR, Departamenti për ST, Filiali OPM, me përgatitje të mesme profesionale – PMP – shkalla IV shkolla elektroteknike, me përvojë pune prej 1 viti, për të cilin vend pune pagesa arrin 29.400,00 denarë.
- 1 (një) realizues në vendin e punës PËRSHTATËS MOBIL NË QENDRËN RAJONALE TETOVË, ST JEGUNOVÇE, në shërbimin për PTR, Departamenti për ST, Filiali OPM, me përgatitje të mesme profesionale – PMP – shkalla IV shkolla elektroteknike, me përvojë pune prej 2 vjet, për të cilin vend pune pagesa arrin 29.400,00 denarë.
- 1 (një) realizues në vendin e punës ELEKTROMONTUES 1 në DV EKIP SKOPJE në shërbimin për mirëmbajtje të DV, Departamenti për DV, Filiali OPM me përgatitje të mesme profesionale – PMP – shkolla elektroteknike/makinierisë (drejtimi teknik) – shkalla III/IV kushtet shtesë për punë në lartësi (certifikatë të mjekut për gjendjen e përgjithshme psikofizike dhe vërtetim mjekësor për punë në lartësi), me përvojë pune prej 4 vjet, për të cilin vend pune pagesa arrin 29.400,00 denarë
- 1 (një) realizues në vendin e punës INXHINIER PËR KONTROLLIM TË MBROJTJES RELEJE ELEKTRIKE DHE LIDHJEVE SEKONDARE në shërbimin për kontrollim të mbrojtjes releje elektrike dhe lidhjeve sekondare, Departamenti për mbrojtje releje elektrike dhe lidhje sekondare, Filiali OPM me Përgatitje sipërore profesionale – PSP – shkalla VII /I Fakulteti elektroteknik elektroenergetika ose sipas kornizës nacionale për KAS/SETK - VIA/240 setk pa përvojë pune, për të cilin vend pune pagesa arrin 38.500,00 denarë
- 1 (një) realizues në vendin e punës SEKRETAR TEKNIK NË KABINETIN E DREJTORIT TË OEPS, Filiali OEPS me përgatitje të mesme profesionale – PSP – shkalla IV shkolla ekonomike, me përvojë pune prej 2 vjet, për të cilin vend pune pagesa arrin 27.200,00 denarë.
- 1 (një) realizues në vendin e punës INXHINIER PËR APLIKACIONE TË RRJETIVE në shërbimin për SCADA/EMS, Departamenti për informatikë teknike Filiali OEPS me përgatitje sipërore profesionale – PSP – shkalla VII /I Fakulteti elektroteknik – informatikë ose sipas kornizës nacionale për KAS/SETK - VIA/240 setk, pa përvojë pune, për të cilin vend pune pagesa arrin 35.100,00 denarë.
- 1 (një) realizues në vendin e punës INXHINIER PËR APLIKACIONE ENERGJETIKE DHE AGC në shërbimin për SCADA/EMS, Departamenti për teknikë informatike, Filiali OEPS me përgatitje sipërore profesionale – PSP – shkalla VII /I Fakulteti elektroteknik – informatikë ose sipas kornizës nacionale për KAS/SETK - VIA/240 setk, pa përvojë pune, për të cilin vend pune pagesa arrin 38.500,00 denarë.
- 1 (një) realizues në vendin e punës INXHINIER I PAVARUR PËR AMR në shërbimin për AMR/MDM, Departamenti për informatikë teknike, Filiali OEPS me përgatitje sipërore profesionale – PSP – shkalla VII /I Fakulteti elektroteknik – informatikë ose sipas kornizës nacionale për KAS/SETK - VIA/240 setk, pa përvojë pune, për të cilin vend pune pagesa arrin 38.500,00 denarë.
- 1 (një) realizues në vendin e punës TEKNIK PËR MATJE në shërbimin për teknikë dhe kontroll për matje (MT dhe KNMER), Departamenti për matje të energjisë elektrike Filiali OEPS me përgatitje të mesme profesionale – PMP – shkolla elektroteknike, shkalla IV, pa përvojë pune, për të cilin vend pune pagesa arrin 30.600,00 denarë.
- 2 (dy) realizues në vendin e punës ELEKTRICIST REPARTI, ST BITOLA 2, në shërbimin për PTR, Departamenti për ST, Filiali OPM me përgatitje të mesme profesionale – PMP – shkalla e IV shkolla elektroteknike, me përvojë pune prej 1 viti, për të cilin vend pune pagesa arrin 29.400,00 denarë.
- 1 (një) realizues në vendin e punës PËRSHTATËS MOBIL NË QENDRËN RAJONALE MANASTIR, ST BITOLA 1, në shërbim për PTR, Departamenti për ST Filiali OPM me përgatitje të mesme profesionale – PMP – shkalla e IV shkolla elektroteknike, me përvojë pune prej 1 viti, për të cilin vend pune pagesa arrin 29.400,00 denarë.
- 1 (një) realizues në vendin e punës PËRSHTATËS MOBIL NË ST VELES në shërbim për PTR, Departamenti për ST Filiali OPM, me përgatitje të mesme profesionale – PMP – shkalla e IV shkolla elektroteknike, me përvojë pune prej 2 vjet, për të cilin vend pune pagesa arrin 29.400,00 denarë.

- 1 (një) realizues në vendin e punës PËRSHTATËS MOBIL NË QENDRËN RAJONALE OHËR, ST OHËR, në shërbim për PTR, Departamenti për ST Filiali OPM me përgatitje të mesme profesionale – PMP – shkalla e IV shkolla elektroteknike, me përvojë pune prej 1 viti, për të cilin vend pune pagesa arrin 29.400,00 denarë.
- 1 (një) realizues në vendin e punës PARAPUNËTOR në DV EKIP SHTIP, në shërbimin për mirëmbajtje të DV, Departamenti për DV, Filiali OPM me përgatitje të mesme profesionale – PMP – shkalla e IV shkolla elektroteknike, me përvojë pune prej 4 vjet, për të cilin vend pune pagesa arrin 30.600,00 denarë.
- 1 (një) realizues në vendin e punës ELEKTROMONTUES 1 në DV EKIP SHTIP në shërbimin për mirëmbajtje të DV, Departamenti për DV, Filiali OPM me përgatitje të mesme profesionale – PMP – shkolla elektroteknike/makinierisë (drejtimi teknik) – shkalla III/IV kushtet shtesë për punë në lartësi (certifikatë të mjekut për gjendjen e përgjithshme psikofizike dhe vërtetim mjekësor për punë në lartësi), me përvojë pune prej 4 vjet, për të cilin vend pune pagesa arrin 29.400,00 denarë.
- 1 (një) realizues në vendin e punës ELEKTROMONTUES 2 në DV EKIP SHTIP në shërbimin për mirëmbajtje të DV, Departamenti për DV, Filiali OPM me përgatitje të mesme profesionale – PMP – shkolla elektroteknike/makinierisë (drejtimi teknik) – shkalla III/IV kushtet shtesë për punë në lartësi (certifikatë të mjekut për gjendjen e përgjithshme psikofizike dhe vërtetim mjekësor për punë në lartësi), me përvojë pune prej 2 vjet, për të cilin vend pune pagesa arrin 27.200,00 denarë.

Së bashku me fletëparaqitjen, në të cilën shënohet se për cilin vend pune aplikohet, kandidatët duhet të dorëzojnë dokumente e nevojshme, varësisht nga kushtet e theksuara për vendin konkret të punës për të cilin aplikojnë:

- Biografi të shkurtë (CV) dhe letër motivimi në gjuhën maqedonase
- Dëshmi për arsim të mbaruar (në original ose kopje të vërtetuar në noter)
- Certifikatë të shtetësisë (kopje)
- Dëshmi për përvojë pune, duke theksuar përvojën e punës dhe kohëzgjatjen e asaj përvojë, të dhënë nga kompania/institucioni/organi, me të cilën do të dëshmohet se personi (kandidati) me shkallë konkrete të përgatitjes profesionale ka fituar përvojë pune afërsisht dhe të ngjashme (në original ose kopje të vërtetuar në noter) ose Listë nga SPIM dhe
- Telefon për kontakt

Shpallja zgjatë 3 (tre) ditë pune nga dita e publikimit (duke mos llogaritur ditën e publikimit).

Zgjedhja e kandidatëve të paraqitur do të realizohet në afat prej 45/90/120 ditë pas skadimit të afatit për paraqitje varësisht nga numri i kandidatëve të paraqitur.

Marrëdhënia e punës bëhet për kohë të pacaktuar.

Java e punës zgjatë 5 ditë pune (prej ditës së hënë deri në ditën e premtë), orari i plotë i punës është 40 orë në javë, me 8 orë pune në ditë, fillimi dhe mbarimi i orarit dior të punës është prej 07.45 deri në 08.15, ndërsa largimi nga vendi i punës është prej 15.45 deri në 16.15, me të drejtë pauzë për 30 min. në periudhën prej ora 10.00 deri në ora 12.00.

Punët dhe detyrat e punës nga vendet e punës të theksuara në pikat 6, 7, 15, 16, 17, 18 do të realizohen në hapësirat afariste të stacioneve transformatore të punëdhënësit - Operatori i sistemit elektropërçues të Maqedonisë, Shoqëria akcionare për përçim të energjisë elektrike dhe menaxhim me sistemin elektroenergetik në pronësi të shtetit.

Për vendet e theksuara të punës, orari i punës është me dy ndërime edhe atë:

- Ndërrimi i parë fillon prej ora 06.45-07.15 ndërsa përfundon 18.45-19.15
- Ndërrimi i dytë fillon prej ora 18.45-19.15 ndërsa përfundon 06.45-07.15

Me të drejtë për pauzë gjatë punës ditore me kohëzgjatje prej 45 minuta, pa u lëshuar vendi i punës.

Punët dhe detyrat e punës punëtori do t'i realizojë në hapësirat afariste të punëdhënësit - Operatori i sistemit elektropërçues të Maqedonisë, Shoqëria akcionare për përçim të energjisë elektrike dhe menaxhim me sistemin elektroenergetik në pronësi të shtetit, Shkup në pajtim me vendosjen organizative të vendit të punës.

Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit si dhe fletëparaqitjet e pakompletuara, nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

Afati për dorëzimin të fletëparaqitjeve dhe dokumenteve të kandidatëve të interesuar është 3 (tre) ditë pune, duke llogaritur nga dita e ardhshme e publikimit të shpalljes publike (duke mos llogaritur ditën e publikimit).

Të gjitha aplikacionet do të shqyrtohen me besim maksimal.

Për zgjedhjen e realizuar kandidatët e paraqitur do të informohen në afat prej 5 (pesë) ditëve të punës nga dita e lidhjes së marrëveshjes për punësim me kandidatin e zgjedhur.

Operatori i sistemit elektropërçues të Maqedonisë, Shoqëria Akcionare për përçim të energjisë elektrike dhe menaxhim me sistemin elektroenergetik në pronësi të shtetit Shkup ose shkurtimisht SH A MEPSO, Shkup ofron mundësi të barabarta për punësim pavarësisht gjinisë, rasës, moshës, mendimit politik, statusit martesor, fese, përkatësisë etnike ose nacionale.

Dokumentet e nevojshme të dorëzohen në adresën e SH A MEPSO Shkup, rr. "Maksim Gorki" nr. 4 Shkup.

Drejtori gjeneral,
Sasho Vasilevski

REPUBLIKA E MAQEDONISË

Institucioni publik qendra ndërkomunale për punë sociale Strumiçë

Në bazë të nenit 110-e të Ligjit për Mbrojtje sociale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 70/09, 36/11, 51/11, 166/12, 15/13, 79/13, 164/13, 187/13, 38/14, 44/14, 116/14, 180/14, 33/15, 77/15, 104/15, 150/15, 173/15, 192/15, 30/16, 163/17, 51/18), ndërsa në lidhje me nenin 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/14, 199/14, 27/16, 35/18) dhe Regulloren për elementet e domosdoshme të shpalljes publike për plotësimin e vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe paraqitjes për punësim, si dhe forma, përmbajtja dhe mënyra e udhëheqjes së regjistrimit të personave që kanë paraqitur të dhëna jo të vërteta gjatë punësimit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 34/15) Drejtori i Institucionit publik qendra ndërkomunale për punë sociale Strumiçë publikon

SHALLJE PUBLIKE NUMËR 3/2018

Për punësim për kohë të pacaktuar të 1 (një) ofruesi të shërbimeve publike të kategorisë A (jurist), 1 (një) ofruesi të shërbimeve publike të kategorisë A (punëtor i diplomuar social) – për kohë të caktuar dhe 1 (një) mirëmbajtës të higjienës për kohë të pacaktuar në Institucionin publik qendra ndërkomunale për punë sociale Strumiçë me vendet e punës në vijim:

1. **S03030A06002 Jurist** - nëpunës profesional i nivelit të gjashtë, një (1) realizues:

Kushtet e posaçme

- Për nivelin A6 të arritura së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar, pa përvojë pune (Shkencat juridike) ose së paku një vit përvojë pune në sferën e mbrojtjes sociale;
- Njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.

2. **S03030A06001 – Punëtor i diplomuar social** – Nëpunës profesional të nivelit të gjashtë, 1 (një) realizues:

Kushtet e posaçme

- Për nivelin A6 të arritura së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar (Punë sociale dhe politikë sociale) pa përvojë pune ose së paku një vit përvojë pune në sferën e mbrojtjes sociale;
- Njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.

3. **S03040A03004 – Mirëmbajtës të higjienës** – person ndihmës – teknik (për mirëmbajtje të objekteve) të nivelit të tretë – 1 (një) realizues.

Kushtet e posaçme: Të ketë arsim fillor të mbaruar.

Përvoja e punës: Pa përvojë pune.

Kandidatët për vendet e lartpërmendura të punës duhet të përmbushin kushtet në vijim:

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Në mënyrë aktive të njoh gjuhën maqedonase;
- Të jetë i moshës së rritur;
- Të ketë afërsi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë dhe detyrës.

Kompetencat e përgjithshme të punës në nivel të mesëm (për vendet e punës Jurist dhe punëtor i diplomuar social):

- Mësim dhe zhvillim;
- Komunikim;
- Realizim të rezultateve;
- Punë me të tjerë/punë ekipore;
- Orientim ndaj palëve/palët e prekura dhe
- Menaxhim financiar.

Orari i kohës së punës:

- Ditët e punës: e hënë – e premte
- Orët e punës në javë: 40 orë
- Orari i punës: prej ora 08:00 deri në ora 16:00 (për vendin e punës jurist dhe punëtor i diplomuar social)
- Orari i punës: prej ora 06:00 deri 10:00 dhe prej ora 16:00 deri në ora 20:00
- Neto shuma e pagesës në të holla: 23.198,00 denarë (për vendin e punës jurist dhe punëtor i diplomuar social).
- Neto shuma e pagesës në të holla: 12.008,00 denarë (për vendin e punës mirëmbajtës të higjienës).

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme është 5 (pesë) ditë pune duke konsideruar nga dita e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes (duke mos konsideruar vetë ditën e publikimit). Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes. Fletëparaqitja për shpallje mund të merret nga arkivi i Institucionit publik qendra ndërkomunale për punë sociale Strumiçë.

Kandidatët obligohen që fletëparaqitjen ta parashtrorjnë në tërësi, në mënyrë precize dhe me të dhëna të sakta.

Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike pas përfundimit të të njëjtit do të informohen për kohën dhe vendin për kontrollimin e besueshmërisë së dëshmi dhe realizimin e intervistës përmes formës me shkrim në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes.

Të drejtë për pjesëmarrje kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët përmbushin kushtet për konkurrim. Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të parashtrorjnë dëshmi për përmbushje të kushteve, në formë origjinale ose kopje të vërtetuar në noter.

Kandidatët për të gjitha pozitat e punës së bashku me fletëparaqitjen duhet të parashtrorjnë dokumentet e nevojshme për përmbushje të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme:

- Certifikatë të shtetësisë jo më të vjetër se 6 (gjashtë) muaj;
- Certifikatë të mjekut për aftësinë e përgjithshme shëndetësore;
- Vërtetim/Certifikatë se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënimi ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Dëshmi për përvojë përkatëse të punës (nëse e ka kandidati);
- Dëshmi – Diplomë/Certifikatë për arsim të mbaruar;
- Dëshmi për njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë (vetëm për vendin e punës jurist dhe punëtor i diplomuar social) .

Fletëparaqitjen së bashku me dokumentet e nevojshme kandidatët duhet ta parashtrorjnë në arkivin e Institucionit publik qendra ndërkomunale për punë sociale Strumiçë ose përmes postës në adresën në vijim: rr. "Leninova" nr. 84 Strumiçë (me shenjë për shpallje publike numër 3/2018).

Kontakt telefoni: 034-325-401

Fletëparaqitjet dhe dokumentacionet e parashtruar pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Institucioni publik qendra ndërkomunale për punë sociale Strumiçë
Drejtor
Zoran Manev



Kyprojektfinancohet nga Bashkimi Evropian

Projekti për Zhvillimin dhe Promovimin e Turizmit

Thirrja e Parë për Propozime

Në mbështetje të implementimit të Programit për Grante të RCC "Triple-P Tourism in SEE: Promotion, Policy, and Pilots", (Ref.no.3PCFP01/2018)

Afati: 16 Gusht 2018

NJOFTIM

Sekretariati i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC) shpall thirrjen për propozime për implementimin e aktiviteteve (pilot projekte me vlerë deri në EUR 54,000) në kuadër të Programit për Grante 2018-2020.

Buxheti i përgjithshëm prej 540.000 euro do të vihet në dispozicion përmes kësaj Thirrje për Propozime për të kryer aktivitete që trajtojnë nevojat për zhvillimin e shtigjeve rajonale të turizmit kulturor dhe të aventurës, siç definohet në Projektin për Zhvillimin dhe Promovimin e Turizmit (Triple P Tourism). Projekti implementohet nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC) dhe financohet nga Bashkimi Evropian.

Kjo Thirrje për Propozime ndahet në dy raunde. Në raundin e parë, deri më 16 Gusht 2018, aplikantëve u kërkohet të dërgojnë koncept propozimet për pilot projektin të shoqëruar me Deklaratën dhe dokumentacionin përkatës të regjistrimit, për arsye të kontrollit të ligjshmërisë.

Në raundin e dytë, dhe pas vlerësimit të koncept projekt propozimeve, aplikantët e përzgjedhur do të ftohen të dërgojnë Formën e plotë të Aplikimit deri më 27 Shtator 2018.

Aplikantëve që i u përzgjidhet përkohësisht Aplikimi i Plotë do të kalojnë në një kontroll të hollësishëm, në bazë të dokumenteve mbështetëse të dorëzuara. Kohëzgjatja e zbatimit të pilot projekteve (granteve) në kuadër të kësaj Thirrje për Propozime parashkohet të jetë në kohëzgjatje prej 2 deri në 7 muaj.

Udhëzimet e plota për aplikantët dhe dokumentet e nevojshme mund t'i gjeni tek: www.rcc.int/tourismgrants

PROJEKT NDËRKOMBËTAR NË TETOVË



VULLNETARËT GJALLËROJNË DY OBJEKTET E HARRUARA

Organizatorët disa herë kanë bërë thirrje deri te të rinjtë t'i bashkëngjiten këtij projekti, pasi i njëjti do të mund të shfrytëzohet nga i gjithë komuniteti

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 15 korrik - Dy hapësirave të braktisura një kohë të gjatë në qytetin e Tetovës do t'iu kthehet gjallëria. Bëhet fjalë për ish-objektin e Radio Tetovës dhe parkun në afërsi të stacionit të autobusëve. Objekti i parë do të shndërrohet në një qendër për komunitetin, ndërkaq i dyti në një "skejtpark". Ky projekt realizohet në bashkëpunim mes organizatave "Democracy Lab Tetovë", "TOESTAND" nga Brukseli dhe "Termokiss" nga Prishtina, ndërsa ka filluar më 7 korrik dhe do të përfundojë më 16 korrik, derisa Komuna e Tetovës i ka përk-

rahur me të dy objektet.

"Po punojmë tani në këtë ndërtesë dhe gjithashtu të parku i skejdbordit, gjithçka po shkon mirë. Punët kanë filluar dhe do të përfundojnë më 16 korrik", theksojnë organizatorët. Ditë më parë, "Democracy Lab" kishte nënshkruar marrëveshje me Komunën e Tetovës për të shfrytëzuar këto hapësira.

"Së bashku me drejtorin e Shokatës për avancimin e demokracisë - Democracy Lab, Sefer Selimi, nënshkruan Marrëveshje për bashkëpunim me qëllim të realizimit të projektit për transformimin e objektit të vjetër të Radio Tetovës në hapësirë alternative për aktivitete për të rinjtë dhe ndërtimin e një Skejtparku në qytetin e Tetovës. Projekti është bashkëpunim ndërkombëtar mes të organizatave Democracy Lab (Tetovë), TOESTAND (Bruksel) dhe Termokiss (Prishtinë) që do të realizohet nga vullnetarë të vendeve përkatëse në periudhën nga 7 deri më 16 korrik

në Komunën e Tetovës", thotë kryetarja e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi. Organizatorët disa herë kanë bërë thirrje deri te të rinjtë t'i bashkëngjiten këtij projekti, pasi i njëjti do të mund të shfrytëzohet nga i gjithë komuniteti. Përndryshe, objekti i ish-radio Tetovës është shfrytëzuar nga ana e Komunës së Tetovës, gjegjësisht nga zyra për Zhvillim Ekonomik Lokal. Në ndërkohë, parku përballë stacionit të autobusëve ishte destinuar për treg me shumicë, por nuk u funksionalizua asnjëherë.

Përndryshe, në fillim të vitit 2014, në Tetovë u rregullua një hapësirë për treg të ri pikërisht afër stacionit të autobusëve dhe hekurudhorë në qytetin e Tetovës. Por që atëherë e këndej, kjo pjesë nuk është vënë në funksion për qëllimin që kishte. Ka ngelur ende kjo hapësirë që nuk shfrytëzohet dhe nuk është rregulluar për atë destinim që ishte rregulluar para katër vitesh. Sot e kësaj dite, ky vend i destinuar për treg nuk po gjen

mënyrën për të qenë një treg për ata që dëshirojnë që të shesin me shumicë prodhimet e tyre. Edhe pse kanë kaluar katër vite, megjithatë i njëjti nuk përdoret nga shitësit.

Ndryshe, ideja për një treg për shitje me shumicë në Tetovë, sipas drejtuesve të NPK-së, ishte se deri më tash - prodhimet e ndryshme me shumicë është zhvilluar nëpër trotuare dhe krahas pengimit të lëvizjes së lirë të qytetarëve, po ashtu edhe prodhimet kanë qenë të ekspozuara në vende të papërshtatshme. Pas disa vitesh, Ndërmarrja Publike Komunale Tetovë - Tetovë ju bëri një ofertë tjetër shitësve ambulant për t'u futur në hapësirat e tregut të gjelbër ku gjashtë muaj pa pagesë do të mund të kryenin veprimtarinë e tyre tregtare, megjithatë as kësaj oferte shitësit ambulant nuk iu përgjigjën pozitivisht dhe vazhdojnë të shesin produktet e tyre në hapësira publike si në trotuare përreth tregut të gjelbër.

Dy shkupjan bien në humnerë

Gostivar, 15 korrik - 62 vjeçari A.P. dhe 65-vjeçari M.P. të dy nga Shkupi, duke lëvizur në këmbë nëpër rrugicën me mur mbrojtës në fshatin Galiçnik, deri më tani nga shkaqe të pasqaruara, kanë rrëshqitur dhe kanë ra në një humnerë të thellë rreth 2 metra. Gjatë rënies, dy personat kanë marrë lëndime të rënda trupore dhe janë dërguar në Spitalin e përgjithshëm "Ferid Murat" të Gostivarit, dhe pas dhënies së ndihmës mjekësore, janë dërguar në Klinikat e Shkupit. Janë kryer hetimet dhe janë duke u zbardhur të gjitha detajet lidhur me këtë rast.

Refuzojnë urdhrat e policisë, arrestohen dy persona

Tetovë, 15 korrik - Në një parking në rrugën për në fshatin Bërvenicë, gjatë marrjes së masave dhe aktiviteteve zyrtare nga ana e pjesëtarëve të policisë nga Stacioni policorë në Tetovë, për shkak të prishjes së rendit dhe qetësisë, kanë qenë të paralajmëruar personat A.J. 20 vjeçar dhe E.E. 20 vjeçar që të dy nga Tetova. Të njëjtit kanë filluar ti ofendojnë pjesëtarët e policisë, ku kanë vazhduar të sillen në mënyrë të pahijshme dhe agresive, dhe në një moment kanë tentuar edhe ti sulmojnë fizikisht. Personat janë arrestuar në Stacionin e policisë së Tetovës, dhe merren të gjitha masat për zbardhjen e plotë të rastit, ku edhe do të pasojnë padi adekuate.

KËSHILLI KOMUNAL JEP DRITË JESHILE

Këshill rinor në Komunën e Tetovës

Tetovë, 15 korrik - Këshilli i Komunës së Tetovës në mbledhjen e fundit në rend dite kishte edhe propozimvendimin për emërimin e anëtarëve në Këshillin Rinor të Komunës së Tetovës, me ç'rast pas debateve që zhvilluan këshilltarët komunal dhe me përfaqësuesit e sektorit për veprimtari publike u vendos që me 24 vota pro, 4 vota kundër, dhe 2 vota të përmbajtur ti jepet dritë e gjelbërt për formimin e këtij Këshilli rinor.

Ky këshill do të përbëhet nga katër përfaqësues të emëruar nga

Këshilli i Komunës së Tetovës, nga një përfaqësues nga Unioni i Studentëve të Universitetit të Tetovës dhe një nga UEJL, pastaj nga një përfaqësues nga shkollat e mesme, gjithsej gjashtë apo pesë përfaqësues nga OJQ-të rinore të qytetit, gjegjësisht gjithsej 17 anëtarë. Më pas, ky Këshill do ti zgjedh edhe organet e veta për të funksionuar ashtu siç duhet. Ahmed Qazimi, udhëheqës i Sektorit për Veprimtari Publike, thotë se që nga fillimi i mandatit jemi angazhuar që kjo përfshirje të jetë e përhershme dhe

kualitative, e shumëllojtë dhe në funksion të promovimit të vlerave qytetëruese dhe të përgjegjësisë që të rinjtë duhet të zhvillojnë në raport me gjithë zhvillimet tjera shoqërore në qytet.

"Përgjithësisht, të rinjtë kanë qenë pjesë e pandashme e jetës në qytet dhe një faktor dinamik i nxitjes së jetës kulturore dhe sportive. Ky orientim për afirmimin dhe përfshirjen e të rinjve në jetën e qytetit mbetet i përhershëm dhe i përcaktuar edhe me strategjinë për të rinjtë. Shpresoj se tani më ky

Këshill rinor do ta përfaqësojë interesin e të gjithë të rinjve të Qytetit të Tetovës pa dallime etnike, fetare dhe racore. Do angazhohen që të krijojnë dhe veprojnë me ide dhe me projekte kreative, me të cilët do të jenë konkurrentë me moshatarët e tjerë nga qytetet brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Maqedonisë", tha gjatë seancës Qazimi. Ai më tej sqaroi se të rinjtë kanë qenë pjesë integrale e angazhimeve tona për një qytet koheziv dhe me perspektiv për të gjithë.

"Përfshirja e të rinjve në jetën

komunitare të qytetit ka qenë një angazhim i përhershëm i imi dhe i Komunës. Prandaj kemi vlerësuar se kjo përfshirje e të rinjve mundëson që ata të identifikojnë veten e tyre dhe të jenë pjesë aktive e proceseve dhe e zhvillimeve në qytet. Në këtë drejtim, ne jemi angazhuar që maksimalisht të krijojmë hapësirën e nevojshme për përfshirjen e tyre, duke ofruar gjithë kuadrin e nevojshëm institucional për afrimin e kreacionit të tyre kulturor dhe shoqëror", thotë Qazimi. (U.H)

Basti i Theresa May mbi Brexit, mund të funksionojë



Nga
Clive CROOK

Plani i Theresa May, mbi marrëdhëniet e Britanisë me Bashkimin Europian pas Brexit, vjen të paktën 18 muaj me vonesë. Me vetëm disa muaj kohë për negociatave reale, përpara se Britania e Madhe të largohet zyrtarisht nga unioni, ai ka shkaktuar krizën më të rëndë politike me të cilën duhet të përballet ende zonja May, duke vënë në pikëpyetje të ardhmen e saj si kryeministre.

Për më tepër, është një plan që BE-ja ka shumë gjasa ta refuzojë. Besojeni apo jo, ky është një progres. Plani që ka përshkruar May - një version i plotë është premtuar të botohet të enjten - është të paktën një plan. Kjo është diçka që Britanisë i ka munguar deri më sot. Dhe është një plan për një Brexit më të butë, pra më pak traumatik, që duket se e dëshirojnë shumë konservatorë. Dhe kjo është gjithashtu diçka e mirë. Ideja është për një pakt, që përqendrohet në një marrëveshje të tregtisë së lirë midis Mbretërisë së Bashkuar dhe BE-së për mallrat. Britania do të duhej ta ruajë sistemin e saj rregullator për mallrat në përputhje me BE, dhe do t'i japë Gjykatës Evropiane të Drejtësisë të paktën një rol (megjithëse jo, insiston May, "të drejtën e veprimi" në Mbretërinë e Bashkuar), në interpretimin dhe zbatimin e rregullave.

Kompanitë britanike do të jenë të kënaqura me këtë, por militantët e Brexiter, shohin këtu shkeljen e vijave të kuqe. Shërbimet nuk do të mbulojnë, dhe Mbretëria e Bashkuar nuk do të pajtohet me parimin e lëvizjes së lirë të njerëzve midis Britanisë dhe BE-së - kështu që ky nuk do të ishte një "Brexit vetëm në emër". Propozimi, përfshin gjithashtu një marrëveshje doganore, që do të shihte Mbretërinë e Bashkuar të mblidhte taksa në emër të BE-së për mallrat që hyjnë më së pari në Britani, për të shkuar më pas në Europën kontinentale. Kjo perspektivë është e ndërlikuar - disa thonë se ajo nuk është e zbatueshme - por së bashku me shtrirjen rregullatore për mallrat, mund të shmanget nevoja për një kufi doganor midis Irlandës së Veriut dhe Irlandës, ose midis Irlandës së Veriut dhe pjesës tjetër të Britanisë së Madhe. Dhe për të negociuar me vështirësi të shtuara, marrëveshje të reja tregtare me palë të treta - diçka që një bashkim i plotë doganor me BE do ta përjashtonte.

Pra, plani qëndron në mes të mundësive midis një Brexit të ashpër (që do të thotë në rastin më të mirë një

marrëveshje të kufizuar të tregtisë së lirë, si ajo që BE-ja ka negociuar me Kanadanë) dhe anëtarësimin e plotë në tregun e brendshëm (që do të thotë pothuajse të gjitha të drejtat dhe detyrimet e BE, duke përfshirë lëvizjen e lirë, por asnjë zë në politikëbërjen e BE-së: I ashtuquajtur i opsioni norvegjez). Sigurisht, kjo nuk është zgjedhja e parë e askujt, dhe BE-ja mund ta kundërshtojë si të papranueshme "marrjen e qershisë mbi tortë". Megjithatë, ai mund të jetë alternativa më e mirë dhe më e besueshme, ndaj skenarit më të vështirë të Brexit, që do ta shihte Britaninë të dilte nga BE vitin e ardhshëm pa asnjë marrëveshje. Dorëheqjet e Dejvid Dejvis, ministri i cili fillimisht ishte përgjegjës për bisedimet Brexit dhe Boris Xhonsion, sekretarit të Jashtëm, nuk janë diçka e keqe. Që të dyja, favorizojnë një ndarje më të pastër nga Evropa - Xhonsion ishte udhëheqës i fushatës për largimin e vendit nga unioni - dhe as që ka qenë i gatshëm të mbështeste një plan hibrid, të llojit që mbështet përfundimisht kryeministria May.

Dejvis ishte larguar tashmë nga procesi, dhe Xhonsion, duke komploutuar vazhdimisht për të marrë udhëheqjen, nuk kishte asgjë konstruktive për të ofruar. Është shumë më mirë që May shpëtoi prej tyre. A do të thonë këto dorëheqje, dhe të tjerat

që ndoshta pasojnë, një garë lidërsipë që do të rrëzojë Theresa May dhe qeverinë e saj? Ndoshta - por ka më shumë të ngjarë që jo. Mund të ketë mbështetje të mjaftueshme nëse konservatorët thirren në një votëbesim të udhëheqësës së tyre (kjo duhet të kërkohej nga 48 deputetë konservatorë), por është e dyshimtë se do të kishte mjaftueshëm vota për ta rrëzuar atë (kërkon një shumicë prej 316 deputetësh). Një faktor tjetër: Tani për tani, Xhonsion dhe të tjerët, që po manovrojnë për të rrëzuar zonjën May, nuk mund të kenë besim në fitimin e zgjedhjeve të përgjithshme, nëse kjo është pika ku përfundon komploti.

Për momentin, partia dhe vendi kryesisht dëshirojnë të udhëhiqen - dhe në qoftë se zonja May, përkundër dëshmive të 18 muajve të fundit, fillon të tregojë se ka dëshirë të udhëheqë, do të mbijetojë në një periudhë afat të shkurtër. Vendosija e një plani dhe mbrojtja e tij me një bindje të dukshme, që ajo e kreut për herë të parë në Dhomën e Komunëve të hënën, ishte një hap i vonuar në drejtimin e duhur. Rreziku më i madh për udhëheqjen e saj, dhe për perspektivat ekonomike të Britanisë, nuk vjen nga partia e saj, por nga Bashkimi Europian. Gjithçka që negociatorët e Europës kanë thënë deri tani, sugjeron se ata do ta konsiderojnë të papranueshëm planin hi-

brid që ajo propozon.

Logjika e këtij pozicioni, është shumë e diskutueshme. S'ka asnjë arsye, se përse hapësira midis një marrëveshjeje të stilit të Kanadesë dhe opsionit të Norvegjisë, duhet të jetë boshe. Ndërtimi i partneritetit më të ngushtë që politika mund të lejojë, është në interesat afatgjata të Europës dhe Britanisë. Por do të jetë i nevojshëm një zbutje e theksuar e qëndrimit të BE-së, madje edhe Europën, që të mund të quajë planin e May një bazë për negociatave. Nëse Evropa e hedh poshtë atë, atëherë pozita e May, mund të jetë realisht e pashpresë. Udhëheqësit e Europës, duhet të reflektojnë mbi pasojat. Në Mbretërinë e Bashkuar, zonja May tani shihet se ka bërë gjithçka për një kompromis të papëlqyeshëm. Nëse BE e hedh poshtë këtë plan, dhe kërkon që në fakt Britania e Madhe të pranojë çfarëdolloj kushtesh që ajo dikton, kjo mund të sigurojë një fitore afatshkurtër. Por në një periudhë më afatgjatë, kjo është perspektiva që do të ndihmonte më shumë Xhonsion dhe komplotistët e tjerë anti-BE. Ndoshta Bashkimi Europian, duhet ta mendojë dy herë para se të lidhet më shumë me një armik të zhurmshëm, dhe të shohë nëse tek e fundit mund të arrihet një marrëveshje hibride.

(Bloombergview)

Në Mbretërinë e Bashkuar, zonja May tani shihet se ka bërë gjithçka për një kompromis të papëlqyeshëm. Nëse BE e hedh poshtë këtë plan, dhe kërkon që në fakt Britania e Madhe të pranojë çfarëdolloj kushtesh që ajo dikton, kjo mund të sigurojë një fitore afatshkurtër. Por në një periudhë më afatgjatë, kjo është perspektiva që do të ndihmonte më shumë Xhonsion dhe komplotistët e tjerë anti-BE



KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazelë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - nr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e diel 15 korrik | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3179 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 221 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Kur përfundoi Lufta e Ftohtë, Hungaria zinte një vend të veçantë në historinë e revolucioneve të 1989-ës. Ishte vendi i parë në orbitën sovjetike që braktiste komunizmin dhe përqafonte demokracinë liberale. Sot është sërish një përcaktuese e tendencës, duke u bërë i pari vend evropian që denoncon dhe distancohet nga demokracia liberale. Po adopton një sistem të ri vlerash, që mishërohen më së miri prej Rusisë së Vladimir Putinit, por që po gjejnë jehonë edhe në vende të tjerë.

Në një fjalim të rëndësishëm fundjavën që kaloi, Kryeministri hungarez, Viktor Orban shpjegoi se vendi i tij është i vendosur të ndërtojë një model të ri politik - demokracinë joliberalë. Kjo gjë më tërhoqi vëmendjen, për arsye se në vitin 1997 kam shkruar një ese tek Foreign Affairs, ku përdorja pikërisht këtë frazë për të përshkruar një tendencë të rrezikshme. Qeveritë demokratike, shpesh herë popullore, po përdornin mandatet e tyre për të dobësuar të drejtat e individit, ndarjen e pushteteve dhe sundimin e ligjit. Por nuk e kisha imagjinuar asnjëherë që lideri i një kombi - aq më pak nga Europa - do ta përdorte këtë term si medalje nderi.

"Tema më popullore e të menduarit sot, është përpjekja për të kuptuar se si sistemet që nuk janë perëndimorë, jo liberalë, që nuk janë demokraci liberale e që ndoshta nuk janë as demokraci, arrijnë gjithsesi të bëjnë të suksesshëm kombet e tyre", tha Orban. Për të, bota ndryshoi rrënjësisht në vitin 2008, me atë që ai e quan "kolapsi financiar i Perëndimit". Që atëherë, argumenton ai, fuqia amerikane ka qenë në rënie dhe vlerat liberale sot mishërojnë "korrupsionin, seksin

Përhapja e Putinizmit

Elementët më të rëndësishëm të Putinizmit janë nacionalizmi, feja, konservatizmi social, kapitalizmi shtetëror dhe dominimi i medias nga qeveria. Në një mënyrë apo një tjetër, ato janë të ndryshme ose kundërshtarë të vlerave perëndimore të të drejtave individuale, kozmopolitanizmit dhe internacionalizmit. Do të ishte gabim të besohet që ideologjia e Putinit krijoi popullaritetin e tij - ai ishte popullor më parë - por kjo e ruan atë

dhe dhunën". Europa Perëndimore është shndërruar në një vend "bredharakësh, mbi shpinën e shteteve sociale". Modelet joliberalë për të ardhmen, shpjegon ai, janë Rusia, Turqia, Kina, Singapori dhe India. Duke lënë mënjanë listën e tij të çuditshme (India?), veprimet e Orbanit gjatë viteve të fundit demonstrojnë se modeli i atij vetë ka qenë Rusia e Putinit. Orban ka vënë në veprim në Hungari një version që mund të përshkruhet më së miri si "Putinizëm". Për ta kuptuar, na duhet të shkojmë në origjinë, tek themeluesi.

Kur erdhi në pushtet në vitin 2000, Putini dukej një lider i mençur, i ashpër, kompetent, një



person që ishte i vendosur të rikthente stabilitetin në Rusi - një vend që po ziente prej kaosit të brendshëm, stanjacionit ekonomik dhe një falimenti në 1998. Ai u përpoq të integrojë Rusinë në botë dhe donte marrëdhënie të mira me Perëndimin, duke i kërkuar Uashingtonit anëtarësimin e Rusisë në Organizatën Botërore të Tregtisë, e madje edhe në NATO. Administrata e tij kishte teknokratë që ishin liberalë perëndimorë, të aftë sa i përket tregjeve të lirë dhe tregtisë.

Por, me kalimin e kohës, Putini vendosi rendin në vendin e tij ndërkohë që ekonomia lulëzonte, për shkak të katërfishimit të çmimeve të naftës. Ai nisi të krijojë një sistem shtypës, me një kontroll politik, ekonomik dhe social, për të ruajtur pushtetin. Kur u përball me opozitën, sidomos në zgjedhjet par-

lamentare të vitit 2011, Putini kuptoi se i duhej më shumë se sa forca për të mposhtur kundërshtarët. Ai kish nevojë për një ideologji push-teti dhe nisi ta artikulojë në fjali-me, duke miratuar ligje dhe përdorur zyrën e tij për të përcuar përkatësinë në një grup vlerash.

Elementët më të rëndësishëm të Putinizmit janë nacionalizmi, feja, konservatizmi social, kapitalizmi shtetëror dhe dominimi i medias nga qeveria. Në një mënyrë apo një tjetër, ato janë të ndryshme ose kundërshtarë të vlerave perëndimore të të drejtave individuale, kozmopolitanizmit dhe internacionalizmit. Do të ishte gabim të besohet që ideologjia e Putinit krijoi popullaritetin e tij - ai ishte popullor më parë - por kjo e ruan atë.

Orbani ka ndjekur gjurmët e

Putinit, duke dobësuar pavarësinë e gjyqësorit, kufizuar të drejtat e njeriut, folur në terma nacionalistë për hungarezët etnikë dhe mbyllur gojën medias. Metodën e kontrollit janë shpesh herë më të sofistikuara se sa censura tradicionale. Hungaria miratoi kohët e fundit një taksë 40% mbi të ardhurat nga reklamat, që dukej se kishte në shënjestër rrjetin e vetëm më të madh televiziv në vend, që mund të rezultojë në një falimentim të tij.

Po të shihni përreth botës, ka të tjerë që kanë rrokur elementët kyç të Putinizmit. Erdogani në Turqi i është larguar agjendës së tij reformiste, drejt një tjetre, që është më konservatore nga pikëpamja sociale, më islamike dhe shumë nacionaliste. Edhe ai ka përdorur hile të zgjuara për të nënshtruar median. Shumë prej udhëheqësve të të djathtës ekstreme në Europë - Marine Le Pen në Francë, Geert Wilders në Holandë dhe Nigel Farage në Britani - e shfaqin hapur admirimin për Putinin dhe vlerat që ky mbron. Suksesi i Putinizmit do të varet shumë nga suksesi i Putinit dhe Rusisë. Nëse ai triumfon në Ukrainë, duke e shndërruar në një shtet të dështuar që vjen e i lutet Moskës, atëherë do të shfaqet si fitimtar. Nëse, nga ana tjetër, Ukraina ia del mbanës jashtë orbitës së Rusisë dhe ekonomia ruse vazhdon të dobësohet, Putini mund të gjejë veten president të një petro-shteti siberian, të izoluar nga bota.

(Washington Post)



Nga
Fareed ZAKARIA

Terrori i djathtë, dështim i shtetit

E gjitha me të zeza është veshur kancelarja gjermane kur del në shkurt 2012 në pultin e oratorit dhe bën një premtim. Në këtë ditë dimri, në Berlin është mbledhur udhëheqja e shtetit gjerman, për të mbajtur zi. Viktimat nuk janë as të shquar, as kanë pasur pushtet. Me një përjashtim ata janë migrantë. Beate Zschäpe dhe terroristët radikalë të djathtë të të vetëquajturës "Lëvizje klandestine nacionalsocialiste" (NSU) i vranë ata pikërisht për këtë shkak: për gjashtë vjet me radhë banda vrastare erdhi vërdalë nëpër Gjermani, grabiti, hodhi bomba dhe vrau. Motivi i tyre: urretje raciste ndaj imigrantëve. Dhe askush nuk i ndali. Asnjë poli-

ci, asnjë shërbim i fshehtë, asnjë qeveri.

Edhe më e keqja: autoritetet gjermane të sigurisë vunë nën dyshim si kriminelë viktimat dhe familjet e tyre. Dyshuan për ta si tregtarë droge dhe anëtarë të mafias. Klishe raciste karakterizuan hetimet e policisë. Për Gjermaninë, që është krenare për rivlerësimin e krimeve nacionalsocialiste, kjo është një deklaratë falimentimi. Një dështim shtetëror.

Në këtë shkurt 2012 kancelarja u kërkon falje dhjetë familjeve të viktimave të vrara. Dhe premtori: "Ne do të bëjmë gjithçka për të sqaruar vrasjet dhe për të zbuluar bashkëfajtorët dhe organizatorët dhe për t'i vendosur të gjithë dora-

Burgim i përjetshëm për Beate Zschäpe për vrasjet e dhjetë vetëve. Për të afërmit e viktimave ky është një ngushëllim i vogël. Sepse politika i ka lënë në baltë



sit para dënimit të tyre të drejtë". Ky është një premtim i madh. Dhe është shpresa më e madhe, që kanë familjet e viktimave për trajtimin juridik të vrasjeve me para-

mendim. Tani, kur mori fund procedura spektakulare penale e viteve të shkuara para një gjykate gjermane është e qartë: premtimi nuk u mbajt.

Sepse përpjekjet e politikës dhe të gjykatave për një sqarim të plotë nuk zgjatën shumë. Shpejt u bë fjalë për fytyrën e shquar të të dyshuarës kryesore që u dënua tani, Beate Zschäpe. Rrjeti i ndihmësve dhe i mbështetësve të djathtë, që ishte i domosdoshëm për dorasit, ndërthurra e dukshme e shërbimeve të fshehta në dështimin e institucioneve për të sqaruar - e gjitha kjo kaloi hap pas hapi në harresë. Edhe te kancelarja. Deri sot shërbimet e fshehta dhe ministratë ruajnë heshtjen, kur

bëhet fjala për kontributin e tyre për rivlerësimin e asaj që ndodhi. Dhe para gjykatës doli vetëm një prerje e vogël e një rrjeti të madh mbështetësish.

Por dështimi i shtetit është shumë më i rëndë. Sepse atëherë, në vitin 2012, kancelarja premti se do të veprojë kundër atyre të cilët "i përndjekin të tjerët për shkak të prejardhjes së tyre, të ngjyrës së lëkurës dhe të fesës". Por sot, gjashtë vjet më vonë, racizmi dhe mendimi nacionalist kanë sërish vend në shoqëri, madje në Parlamentin gjerman. Ato kanë me AfD-në një zë agresiv të urretjes. Kjo në një kohë kur procesi kundër NSU-së e konfirmoi: urretja vret. (DW)



Nga
Hans PFEIFFER

NUK ËSHTË KY FUNDI QË KISHA ËNDËRRUAR

Harry Kin mund të jetë kandidati kryesor për të fituar "Këpucën e Artë" në Botërorin "Rusi 2018", por sulmuesi i kombëtares britanike nuk është aspak i kënaqur me vendin e katërt që "3 luanët" arritën në këtë Botëror. "Nuk është ky fundi që kisha menduar për Botërorin. megjithatë, kjo ishte një përvojë pozitive, ku mësova plot gjëra të reja", shprehet sulmuesi i kombëtares britanike Kin, i cili ka falënderuar fansat për mbështetjen. "Keni udhëtuar për të na qenë pranë dhe ju falënderoj për mbështetjen, na keni bërë krenarë. E gjithë skuadra dhe më të mirën në fushë, ky është një grup i ri dhe ka shumë mundësi për të qenë në nivele edhe më të larta në të ardhmen", deklaroi kapiteni i kombëtares angleze.



MEDIAT ZBULOJNË KAOSIN ME KOMBËTAREN E ARGJENTINËS



Messi, i akuzuari kryesor

Një Botëror, që filloi keq dhe përfundoi keq për Argjentinën. Zhdukja kaq e menjëhershme e "Albiceleste" nga "Rusia 2018" vazhdon të jetë temë diskutimesh dhe është pasuruar me detaje të reja nga një dhomë zhveshesh tejet të nxehtë, gati të pakontrollueshme. Dhe gjithçka komandohet nga Leo Messi. Nga faqet e "Clarín" dalin dy anekdotat, që do të përshkruanin shumë mirë se çfarë lloj ajri mund të merrni frymë në dhomën e zhveshjes së ekipit kombëtar argjentinase dhe peshën shumë relative të zgjedhjeve të Sampaolit. Megjithatë, përsëri, protagonistin do të ishte Leo Messi, i portretizuar si një nga udhëheqësit e ekipit. Udhëheqës deri në pikën, sa mund të vendosë se kush duhet të luajë dhe kush jo, por edhe për ata që mund të afrohen rishtazi në kombëtare. Messi, sipas gazetës argjentinase, do të tregonte menjëherë pakënaqësi ndaj Sampaolit dhe stafit të tij. Në veçanti ndaj Beccaceces, një nga ndihmësit e trajnerit të Argjentinës. Sipas "rindërtimit të skenës", gjithçka ka lindur pak ditë nga miqësorja me Spanjën, kur bashkëpunëtori i afërt i Sampaolit i ishte afruar "Pleshtit" dhe, duke i vënë dorën mbi shpatullën, si një goditje, do t'i shpjegonte disa zgjedhje taktike. Kaq ka mjaftuar për ta irrituar pesë herë fituesin e "Topit të Artë", i cili do të ishte shumë i mërzitur për gjestin. Pas incidentit, numri 10 i Argjentinës mësohet të ketë shkuar direkt te Sampaoli, në mënyrë që ndihmësi i tij të mos e përsëriste më diçka të tillë... "Anekdota" e dytë, e raportuar nga "Clarín", ka të bëjë me dy lojtarët, Lo Celso dhe Fazio. Sampaoli ishte i orientuar për t'i marrë ato në fushë, por edhe në këtë rast Messi do të ndikonte në zgjedhje. Jo për Fazio, sepse Messi nuk ishte i bindur që në fillim për aftësinë e ndërtimit të lojës nga ana e mbrojtësit të Romës. Dhe Lo Celso? Ai thuhet se ka pasur një përplasje me yllin e Barcelonës. Pas një loje në kuadrat, Lo Celso i ka bërë një tunel (kaluar topin për shalësh) Messit në trajnim, duke e shoqëruar këtë gjë edhe me disa të qeshura, që janë marrë si tallje nga numri 10 i Argjentinës. "Play maker"-i, që figuronte gjithmonë në mesin e titullarëve të "Albiceleste" para Kupës së Botës, tashmë e kishte humbur vendin në formacion, sepse nuk ishte shumë i mirëpritur nga Messi. Rezultati? Fazio ka luajtur shumë pak (vetëm një pjesë të lojës kundër Francës) dhe Lo Celso kurrë nuk e pa veten në formacion. Natyrisht, debati tashmë është ndezur: sa pushtet ka Leo Messi në dhomën e zhveshjes së Argjentinës? A i merr vetë vendimet trajneri Sampaoli, apo ato duhet të "noterizohen" nga kapiteni i amerikano-jugorëve? Gazeta argjentinase "Clarín" shtë munduar t'iu japë përgjigjen e vet këtyre pyetjeve, duke nxjerrë në dritë dy "anekdotat" e mësipërme.

DËSHTIMET DHE ZBULIMET E KAMPIONATIT BOTËROR

Në këtë Kupë Bote të Rosisë, edhe surprizat kanë qenë protagonistë të ngjarjes. Në syrin e ciklonit kanë përfunduar kombëtares, që në teori duhej të luftonin për titullin, por edhe lojtarë të kalibrit të lartë, të cilët janë shfaqur të zvogëluar në fushën e blertë. Rastet e De Gea, Myler, Gabriel Jezus dhe Levandovski janë ndoshta më përfaqësuesit e së keqes, ose zhgënjimit në këtë Botëror, në planin individual

Kupa Botërore është vitrina më e madhe për futbollistët. Një kompeticion i tillë, megjithatë, është një shpatë me dy tehe: ngre lart ata që paraqiten mirë, por edhe ul poshtë ata që nuk iu përgjigjen pritshmërive të para fillimit të garës. Në këtë Kupë Bote të Rosisë, edhe surprizat kanë qenë protagonistë të ngjarjes. Në syrin e ciklonit kanë përfunduar kombëtares, që në teori duhej të luftonin për titullin, por edhe lojtarë të kalibrit të lartë, të cilët janë shfaqur të zvogëluar në fushën e blertë. Rastet e De Gea (Spanjë), Myler (Gjermani), Gabriel Jezus (Brazil) dhe Levandovski (Poloni) janë ndoshta më përfaqësuesit e së keqes, ose zhgënjimit në këtë Botëror, në planin individual. Futbollistët të jashtëzakonshëm, të cilët kanë parë kalimin e tyre tepër gri në këtë Botëror, janë shënuar negativisht. Të tjerët, megjithatë, do të jenë në gjendje të përfitojnë nga roli i tyre i shkëlqyer në Kupën e Botës dhe të kërkojnë një destinacion të ri për karrierën e tyre, ose për t'u konsideruar më mirë në klubet ku bëjnë pjesë. Më të rëndësishmet janë ndoshta rastet e Rebiç (Kroaci) dhe Pavard (Francë). Lojtarët e Aindraht dhe Sh-



NË NGJITJE:

NË ZBRITJE:

Pavard

Çelësi i Kupës së Botës së Francës. Mesfushori i Shtutgartit tashmë duket se po shkon te Bajern Munihi për sezonin 2019-2020.

Quintero

Ai mori "stafetën" e Hames. Me këtë të fundit të dëmtuar, lojtari i River Plate spikati te Kolumbia, ashtu si James në vitin 2014.

Torreira

Paraqitja e tij mjaft e mirë në Kupën e Botës e bëri atë "topçi". Unai Emery pothuajse nuk e lejoi të zbriste nga avioni. Lojtari i mirë, që ka arritur tashmë në "Emirates", si pjesë e Arsenalit.

Çershjev

Më i miri te Rusia. Lojtari i Villarrealit nuk e filloi turneun si startues, por ka përfunduar me katër gola në pesë ndeshje.

tuttgart janë pika referimi në kombëtares e tyre, në këtë Botëror, kanë arritur në finale, duke marrë një rol udhëheqës, edhe pse nuk shfaqeshin të tillë në parim. Puna e tyre e mirë ndoshta do t'u sigurojë atyre një destinacion të ri në fund të turneut. Të tjerë si Torreira (Uruguai), Huan Fernando Quintero (Kolumbi), Go-

De Gea

Portieri i Mançester Junajtedit ishte në hije në këtë Botëror, duke treguar pasiguri, sidomos në pësimin e dy golave nga Ronaldo. Ai ndaloi vetëm një top në katër ndeshje që luajti.

Myler

Ai nuk ishte, as nuk ishte pritur. Botëror i tmerrshëm për të, që i dha zëvendësimin në duelin jetësor, përpara Koresë së Jugut. Në hije.

Gabriel Jezus

"9" i Brazilit nuk ka shënuar gol në Rusi. Duke se "canarinha" kishte gjetur qendërsulmuesin e duhur pas një kohe të gjatë, por ai dështoi në këtë Botëror.

Levandovski

Ai shënoi 16 gola në eliminatore, por u largua nga Rusia pa "e lagur" në këtë drejtim dhe Polonia e vuajti shumë këtë gjë.

lovin (Rusi), Hirving Lozano (Meksikë), Shaqiri (Zvicër), Maguire (Angli), Tripier (Angli), Musa (Nigeri), Jo Hyeon-Voo (Koreja e Jugut) ose Niang (Senegal), gjithashtu, e kanë rivlerësuar emrin e tyre falë turneut rus. Edhe Vrsalkjo (Kroaci) e ka ngritur "stekën" e tij falë punës së mirë gjatë gjithë turneut.

KUPA E BOTËS RUSI 2018

Belgjika në histori, e mbyll e treta Botërorin

Belgjika ka fituar 2-0 ndaj Anglisë duke marrë vendin e tretë në Kupën e Botës. Ishte një ndeshje e ekzekutuar shumë mirë nga Djajtë, të cilit gjatë shumicës së kohës kanë kontrolluar pa shumë probleme anglezët, që vetëm nëpërmjet goditjeve standarde janë treguar të rrezikshëm. Ashtu si në dy ndeshjet paraardhëse, Belgjika e nisi shumë mirë ndeshjen dhe gjen golin që në minutën e 4'. Dy lojtarët e krahëve Çadli dhe Meunier gjejnë njëri-tjetrin me të fundit që shtyn topin në rrjetë. Belgët nuk e ulin ritmin dhe kanë disa mundësi të tjera për të thelluar diferencën, ndërsa Anglia duket e përgju-



mur dhe ndryshimet e shumta nuk kanë ndikuar për mirë. Pas pushimit anglezët rrisin ritmin dhe fillojnë të krijojnë mundësi goli. Gjithsesi Djajtë mbeten të rrezikshëm në kundërsulm por janë tepër të pasaktë përpara portës. Mundësia më e mirë e Tre

Luanëve vjen nga Dier i cili vetëm për vetëm me portieri Kurtoa godet mirë, por Alderveireld shpëton portën e tij në minutën e 82' vjen goli i nokautit për Anglezët. Eden Hazard dyfishon rezultatin duke i dhuruar të tijve vendin e tretë në Kupën e Botës.

Teksa bota shihte 32 vendet që luftonin për kupën në Rusi, Italia nuk e la veten të harrohet, por zuri faqet e para të gazetave. Seria A po përgatitet të rikthehet në formë. Pas kësaj nisi dhe vazhdoi deliri për Kristiano Ronaldo

Nga Mina Rzouki, BBC

Pasi nuk arriti të kualifikohet për Botërorin 2018 në Rusi, Italia konfirmoi, në dukje, rënien e këtij sporti në vendin e tyre. Elënë prapa nga pasuria e Premier Ligës angleze dhe nga talentet e La Ligas së Spanjës, Seria A e Italisë ka marrë reputacionin e vendit që krijon talente për t'i shitur, por që nuk tërheq më yjet më të mirë e më të mëdhenj në galaksinë e futbollit. Megjithatë, teksa bota shihte 32 vendet që luftonin për kupën në Rusi, Italia nuk e la veten të harrohet, por zuri faqet e para të gazetave. Seria A po përgatitet të rikthehet në formë. Pas kësaj nisi dhe vazhdoi deliri për Kristiano Ronaldo.

PSE NË ITALI?

Kur dolën fjalët e para për një marrëveshje të mundshme, pak ishin ata që e besuan. Menduan se Ronaldoja thjesht po bënte "numrat" e zakonshëm verorë me Realin e Madridit, me synimin për të fituar më shumë mbështetje, dashuri e parë nga punëdhënësit. Por dhe nëse kishte ndërmend të largohej, asnjëri nuk mendonte që do të shkonte në Itali. Juventus, ekip që njihet për aftësinë e nuhatjes së bizneseve të mira, vendosi të dalë jashtë skenari e të bëjë blerjen më të shtrenjtë në historinë e Series A. Agjenti Jorge Mendes në fillim dha të kuptohet se një marrëveshje do të ishte e mundshme, pasi u takua me klubin për marrjen e Zhoao Kancelos nga Valencia, në qershor, për rreth 40 milionë euro. Pasi nuk la gur pa lëvizur, Juventus arriti të gjejë 105 milionë euro për t'ia dhënë Real Madridit e për të marrë 34-vjeçarin legjendar në Torino. Pasi vendosën më pas të paguajnë 30 milionë euro në vit, pas taksave (rreth 60 milionë në total), marrëveshja u krye. "Zonja e Vjetër" e mori zotërinë, dhe për të parën herë mori mbështetjen dhe respektin e rivalëve në shtëpi. Ardhja e fituesit të Topit të Artë në Serinë A është befasuese jo vetëm për Juventusin, por për të gjithë futbollin italian, pasi mund të ndihmojë të ringrihet disi reputacioni.

POR PSE NË ITALI?

Karriera e Ronaldos, në fakt, është që duhej të kishte lindur në Itali. Por duket se aty do të mbarojë. Në vitin 2003, ish menaxheri i Juventusit, Luciano Moggi, u duk se kishte lidhur marrëveshje me Sportingun e Lisbonës për blerjen e lojtarit të tyre më të ri e të talentuar.

ANALIZA E BBC

RONALDO TE JUVENTUSI, NJË GODITJE BRENDIA DHE JASHTË FUSHE



Pjesë e kësaj marrëveshjeje ishte që Marcelo Sallas i Joves të kalonte në anën tjetër, por pasi vizitoi Lisbonën, kiliani e refuzoi transfertën, duke e detyruar Juventusin të hiqte dorë nga ylli i ri portugez. Ronaldoja shkoi me Manchester Junajtedin dhe më pas ndodhi historia që njohim. Juventus ka mbetur një klub i veçantë për zemrën e Ronaldos, dhe ai e pranoi këtë më herët, gjatë këtij, viti, duke thënë: "E kam dashur gjithnjë Juventusin, që fëmijë. Më pëlqente t'i shihja në ndeshje." Lionel Messi i Barcelonës mund t'i qëndrojë besnik klubit deri në fund të karrierës. Megjithatë, Ronaldoja beson se asgjë nuk do ta linte më mirë gjurmën e tij në botën e futbollit se mbizotërimi në tri shtete të ndryshme, dhe, mundësisht, fitorja e çmimeve. Një gjë që i ka shpëtuar Juventusit, është finalizimi i suksesit të vazhdueshëm në "Champions League". Ata kanë dalë nëntë herë në finale dhe e kanë fituar vetëm dy herë. Nëse ka lojtar që di ta fitojë një finale, ai është Ronaldoja. Pasi i ka dhënë Realit të Madridit tre kupa të "Champions League" rresht, ai e di që nëse arrin ta ndihmojë Juventusin të ketë sukses, pas pesë dështimeve, ka për t'u quajtur një perëndi, duke vulosur gjurmën dhe reputacionin si personi që bën ndryshimin.

"MË SHUMË SE THJESHT PARA DHE TROFË"

Gjithashtu, është më shumë se thjesht para dhe trofë. Në Serinë A, moshë nuk ka rëndësi. Francesco Toti e la më në fund futbollin në moshën 40 vjeçare. Barzagli i Joves

sapo e shtyu afatin e kontratës me klubin, edhe pse është 37 vjeç. Buffon vazhdon të luajë fort, në moshën 40 vjeçare, dhe konfirmoi lëvizjen te PSG. Siç komentoi Patris Evra: "S'kam folur me Kristianon për këtë, por këshilla ime është që nëse do të luajë deri në vitin 2050, duhet të shkojë te Juventus". "Falënderoj Juve, sepse nëse vazhdova të fitoj pas Manchesterit, ishte edhe falë tyre. Juventus mund ta ndihmojë Ronaldo të garantojë pjesëmarrjen edhe në botërorin tjetër". Ndërkohë që mediat italiane e kanë quajtur "kontrata e shekullit", disa e shohin edhe si diçka të tepruar. Gazetari Juan Ignacio Garcia-Ochoa i "Marca" e ka vënë në dyshim vendimin e Joves për të marrë një lojtar në vitet e fundit të karrierës, e që ka humbur shtatë ndeshje të kampionatit spanjoll dhe gjashtë të Kupës së Mbretit, vetëm që të ruante formën. Ronaldoja do t'i kushtojë Juve rreth 96 milionë euro në vit, një shifër që është sa një e katërta e të ardhurave vjetore të Joves. Kompania "Fiat" mendohet se do të ndihmojë me kontratën, dhe Ronaldo do të jetë një përfaqësues botëror i Ferrarit. Kjo do të prodhojë jo vetëm fondet që nevojiten për rrogën, por do të bashkojë disa elemente të ndryshme të perandorisë së bizneseve të familjes Anjeli.

A JANË PARA TË SHPENZUARA MIRË?

Shumë veta nuk kanë vënë re që Ronaldoja do të ndikojë për mirë jo vetëm në sport, por edhe në financa, edhe pse fillimisht do të kushtojë shtrenjtë. Juventus

Kur sheh se sa bileta më shumë do të shesë prania e tij, mundësia për kontrata të reja sponsorësh e ndoshta një finale të "Champions League", atëherë Juve ka mundësi të buzëqeshë.

A DO TË PËRSHTATET ME EKIPIN E RI?

Ndikimi i tij jashtë fushe është i dukshëm. Janë ngritur pyetje se si Ronaldoja do të përshtatet te Juve, një klub i njohur që punon si një ekip, pa ego. Megjithatë, Juve ka një armë sekrete te Masimiliano Allegri. Një mjeshtër taktike, Allegri do t'i ketë krijuar idetë e tij tashmë për një formacion të përkryer, por Ronaldoja duhet t'i ketë bërë të qarta kërkesat, e kjo duket që me largimin e mundshëm të Gonzalo Higuainit. Argjentinasi mendohet se ka lëvizur te Çellsi që të ndihmojë ardhjen e Ronaldos. Kjo mund t'i shkojë për shtat yllit portugez, që s'ka luajtur gjithnjë me kënaqësi me të, kur ishin bashkë te Reali i Madridit.

Pasi Reali doli nga "Champions League" në vitin 2010, "Marca" u përkushtoi një lajm në faqen e parë të gazetës, me foton e dy sulmuesve që ishin duke debatuar. Ronaldoja u zemërua shumë që Higuaini vendosi të godasë në portë, në vend që t'ia pasojë atij. Në vitin 2015, Napoli mohoi publikisht që Higuaini ta kishte quajtur ish-shokun e skuadrës "egoist dhe të mbivlerësuar", por ka deklaruar gjithnjë se Lionel Mesi ishte më i miri.

ÇFARË DO TË THOSHTË IKJA E HIGUAINIT?

Si të ikë, si të mos ikë, Zonja e Vjetër ka besim se Allegri, i cili nuk ka frikë të provojë formacione të reja si pjesë e synimit për të vendosur ekuilibrin taktik, do të sigurohet që Ronaldoja të shkëlqejë përkrah lojtarëve si Paulo Dybala dhe Daglas Kosta. Nëse sulmuesi bën kërkesa, Juventus mund t'i bëjë lëshime duke ditur se gjithçka që bën e që kërkon është për të siguruar suksesin që ata ëndërrojnë. Ata janë krenuar më parë me fitues të "Topave të Artë", dhe tani Juventus duket se po rikthehet.

Benvenuto in Italia Ronaldo!

OFERTA STRATOSFERIKE E REAL MADRIDIT

BEJL DHE 150 MILIONË EURO PËR KIN

Sipas tabloidit britanik "The Sun", presidenti i "Los Blancos", Florentino Perez, është duke përgatitur një ofertë, që përfshin edhe Geret Bejll, ish-lojtari i këtij klubi londinez, plus 150 milionë euro, për të bindur drejtuesit e "Spurs", që të heqin dorë nga njëra prej figurave të tyre më e madhe



Real Madridi është i gatshëm për të formalizuar një ofertë stratosferike për të marrë shërbimet e Harry Kin, sulmuesit të Tottenham Hotspur dhe kombëtares së Anglisë, i cili është në rrugën e duhur për t'u kurorëzuar golashënuesi më i mirë në Botërorin e Rusisë. Sipas tabloidit britanik "The Sun", presidenti i "Los Blancos", Florentino Perez, është duke përgatitur një ofertë, që përfshin edhe Geret Bejll, ish-lojtari i këtij klubi londinez, plus 150 milionë euro, për të bindur drejt-

tuesit e "Spurs", që të heqin dorë nga njëra prej figurave të tyre më e madhe. Megjithatë, dhe sipas këtyre burimeve të njëjta, Tottenhami ka hezitimet e veta, në mënyrë të qartë mbi funksionimin e Bejll, duke iu referuar veçanërisht mënyrës mjaft të lehtë me të cilën është lënduar rregullisht, çka ndikon drejtpërdrejt në performancën e tij. Real Madridi kërkon përfshirjen e një sulmuesi të spikatur në drejtim të shënimit të golave, sepse synon të kompensojë largimin e Cristiano Ronaldos te Juventusit. E thënë ndryshe,

synohet kompensimi i mesatarisht 50 golave në sezon, sa KR7 ka qenë në gjendje të prodhojë në secilin prej nëntë viteve të tij në "Santiago Bernabeu". Dhe Harry Kin mund të jetë një nga opsionet më të mira në këtë drejtim. Megjithatë, rinovimi i tij i fundit me "Spurs", deri në vitin 2024, është një vështirësi e shtuar për aspiratat merengues. Në lojë për të zëvendësuar Ronaldon është edhe belgu Eden Hazard, por ai nuk është një sulmues i mirëfilltë, edhe pse shënon rregullisht.

DI MARIA SHUMË PRANË INTERIT



Pritet miratimi i PSZH-së

Pavarësisht se ka afruar disa lojtarë deri tani, Interi vijon të jetë aktiv në merkato, për të ndërtuar përforcuar më shumë skuadrën, në prag të sezonit që pritet të jetë shumë impenjativ. "Po punojmë për të ndërtuar një grup me 20 futbollistë, të aftë për të vendosur fatet e një ndeshjeje", deklaroi Spaletti dje në konferencë për shtyp, duke lënë të hapur ende merkaton. Së fundi ka qenë "Fox Sport" në Argentinë, që në edicionin e saj të mëngjesit, ka raportuar se zikaltrit janë shumë pranë transferimit të Angel Di Marias në Milano. Sipas tyre, agjenti i lojtarit dhe Ausilio kanë gjetur gjuhën e përbashkët, ndërsa tani pritet të fillojnë negociatat me PSZH-në, për çmimin dhe formulën e transferimit. Zikaltrit dëshirojnë një huazim me të drejtë blerjeje, si mënyra e vetme për të mos rënduar në bilanc dhe për të pasur mundësi ta aktivizojë argentinasin në "Champions", ndërsa nga ana tjetër francezët kanë nevojë për para dhe këmbëngulin për shitje përfundimtare. Gjithsesi në orën e ardhshme do të mësohen më shumë detaje rreth këtij transferimi dhe mundësive për t'u realizuar.

Publicitet

Në bazë të nenit 156, 157, 158, 159, 160 të Ligjit për sigurim shëndetësorë (Gazeta Zyrtare e RM nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16), Pëlqimi për punësim nga Ministria e Financave nr. 18-6600/2 nga data 22.06.2018, Vendimit për publikim të shpalljes publike nr. 02-468/1 nga data 13.07.2018, u.d. Drejtori i IPSH Spitali special për ginekologji dhe akusherë Nënë Tereza-Shkup, publikon

SHPALLJE PUBLIKE

për punësimin e 2 (dy) persona për vendin e punës - doktor medicine në specializim për pediatri, 7 (shtatë) persona në vendin e punës - motër medicinale, 5 (pesë) persona në vendin e punës - akushere dhe 2 (dy) persona në vendin e punës - laborant, për kohë të pacaktuar

- IPSH Spitali special për ginekologji dhe akusherë Nënë Tereza-Shkup ka nevojë për punësimin e:
 - dy (2) personave në vendin e punës - Doktor medicine në specializim për pediatri
 - shtatë (7) persona në vendin e punës - motër medicinale
 - pesë (5) persona në vendin e punës - akushere, me PMP, me arsim të lartë ose me arsim sipëror,
 - dy (2) persona në vendin e punës - laborant
- Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme të parapara me Ligjin për sigurim shëndetësorë:
 - Të jetë shtetas i RM
 - Të jetë i moshës së rritur;
 - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore
 - Të mos i jetë shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për realizim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
- Përpos me ligj të vërtetuar kushtet e përgjithshme nga pika 2 Kandidatët për **Doktor medicine** për specializim për pediatri, duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme në vijim:
 - Të ketë të mbaruar arsim të lartë (VII/1) apo 240 kredi sipas SETK-Fakulteti Mjekësisë,
 - Të dhënë provimin profesional
 - Specializim të miratuar të anesteziologjisë
 - Licencë për punë,
 - Me dhe pa përvojë pune
- Orari i punës javore është 40 orë. Pagesa neto bazë për Doktor medicine është 26.733,00 denarë.
- Përpos me ligj të vërtetuar kushtet e përgjithshme nga pika 2 Kandidatët për **motër medicinale**, duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme në vijim:
 - Arsim të mesëm të medicinës - motër medicinale (PMP - shkalla IV)
 - Të dhënë provimin profesional
 - Me dhe pa përvojë pune
- Orari i plotë i punës - punë me ndërrime. Pagesa neto bazë për motër medicinale është 18.004,00 denarë.
- Përpos me ligj të vërtetuar kushtet e përgjithshme nga pika 2 Kandidatët për **akushere, me PMP, me arsim të lartë ose me arsim sipëror**, duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme në vijim:
 - Arsim të mesëm të medicinës - akushere (PMP - shkalla IV), akushere e lartë ose akushere me arsim sipëror,
 - Të dhënë provimin profesional
 - Me dhe pa përvojë pune
 - Shkalla e arsimit nuk është përparësi.
- Orari i plotë i punës - punë me ndërrime. Pagesa neto bazë për akushere me PMP është 18.004,00 denarë, për akushere me Përgatitje të lartë profesionale është - 19.933,00 denarë dhe për akushere me Përgatitje sipërore profesionale 22.510,00 denarë.
- Përpos me ligj të vërtetuar kushtet e përgjithshme nga pika 2 Kandidatët për **laborant**, duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme në vijim:
 - Arsim të mesëm të medicinës - laborant (PMP - shkalla IV)
 - Të dhënë provimin profesional
 - Me dhe pa përvojë pune
- Orari i plotë i punës - punë me ndërrime. Pagesa neto bazë është 18.004,00 denarë.
- Si shtojcë me fletëparaqitjen kandidatët për **Doktor medicine** për specializim për pediatri janë të obliguar të dorëzojnë dokumentet në vijim:
 - Fletëparaqitje me të dhënat për kontakt
 - Biografi të shkurtë (CV)
 - Diplomë me sukses mesatar Certifikatë për Fakultet të mbaruar të medicinës, në original ose kopje të vërtetuar në noter,
 - Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, original ose kopje të vërtetuar në noter
 - Certifikatë nga mjeku, jo më të vjetër se 6 muaj, original ose kopje të vërtetuar në noter
 - Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në original ose kopje të vërtetuar në noter
 - Certifikatë për provim të dhënë profesional, original ose kopje të vërtetuar në noter
 - Licencë për punë, original ose kopje të vërtetuar në noter.
- Si shtojcë me fletëparaqitjen kandidatët për **Motër medicinale, akushere me PMP, PLP, dhe me PSP të medicinës dhe laborant** janë të obliguar të dorëzojnë dokumentet në vijim:
 - Fletëparaqitje me të dhënat për kontakt;
 - Biografi të shkurtë (CV);
 - Diplomë me sukses mesatar Certifikatë/dëftesa për arsimin e mbaruar për të gjitha vitet, në original ose kopje të vërtetuar në noter;
 - Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, original ose kopje të vërtetuar në noter;
 - Certifikatë nga mjeku, jo më të vjetër se 6 muaj, original ose kopje të vërtetuar në noter;
 - Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në original ose kopje të vërtetuar në noter;
 - Certifikatë për provim të dhënë profesional, original ose kopje të vërtetuar në noter
- Afati për dorëzimin e fletëparaqitjeve është 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit.
- Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, jo i plotë dhe i pakompletuar nuk do të jetë lëndë e shqyrtimit nga ana e komisionit për selektim të kandidatëve.
- Pas selektimit të realizuar të kandidatëve të paraqitur nga pika 3 të cilët i plotësojnë kushtet nga shpallja publike, do të realizohet provim kualifikues në pajtim me nenin 160 paragrafi 2 nga Ligji për mbrojtje shëndetësore edhe për kandidatët nga pika 5, 7 dhe 9 të cilët i plotësojnë kushtet në pajtim me shpalljen publike, do të realizohet pjesa profesionale (test) në pajtim me nenin 160 paragrafi 3 nga Ligji për mbrojtje shëndetësore.
- Fletëparaqitja me dokumentacionin e përgjithshëm dhe telefoni për kontakt, të dorëzohet në Drejtori i IPSH Spitali special për ginekologji dhe akusherë Nënë Tereza-Shkup, rr. Kosta Abasheviq nr. 3- Shkup, me postë apo në arkivin e Spitalit, me shenjë për Shpallje publike për punësim.
IPSH Spitali special për ginekologji dhe akusherë Nënë Tereza-Shkup
UD Drejtor,
D-r Bashkim Ismaili

Në bazë të nenit 7 nga Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për gjykatat (Gazeta Zyrtare 83/18), Gjykata themelore në Gostivar, më datë 10.07.2018 publikon këtë:

SHPALLJE

Për paraqitjen e kandidatëve për zgjedhjen e gjyqtarëve porotë në Gjykatën themelore Gostivar

I.

ANULOHET shpallja për paraqitje të kandidatëve për zgjedhje të gjyqtarëve porotë në Gjykatën themelore Gostivar nga 14.03.2018 shpallur në gazetën ditore Nova Makedonija dhe Koha më datë 26.03.2018.

II.

Në Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, mbahen zgjedhje për 10 gjyqtarë porotë në Gjykatën themelore Gostivar.

Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet e parapara sipas nenit 7 nga Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për gjykatat (Gazeta Zyrtare 83/18), edhe atë:

- Të jenë persona madhorë;
 - Të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë;
 - Të kenë të kryer së paku shkollimin e mesëm;
 - Në mënyrë aktive të zotojnë gjuhën maqedonase;
 - Të mos jenë më të moshuar se 60 vjet;
 - Ta gëzojnë autoritet për kryerjen e funksionit gjyqtar porotë;
 - Gjyqtarët porotë për gjykimin e të miturve zgjidhen nga radhët e personave me përvojë për edukimin dhe arsimimin e të rinjve;
- Me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë në formë origjinale ose të vërtetuar dokumentet në vijim:
- Certifikatë të shtetësisë jo më e vjetër se 6 muaj;
 - Certifikatë ose diplomë për arsim të kryer;

Fletëparaqitjet kandidatët t'i dorëzojnë në Seksin për pranim të Gjykatës Themelore Gostivar.

Fletëparaqitjet e pakompletuara dhe të vonuara nuk të shqyrtohen.

Shpallja zgjatë deri me datë 26.07.2018.

KRYETAR I GJYKATËS
QIRKO MIHAJLOSKI

URGJENTISHT

Shes truall të urbanizuar 890 m2 me markë ndërtimore 430 m2, lartësia 8,5 m, Bo + Pr + 1 + Nën, trualli i parë në "Momin Potok" - Shkup, industria e lehtë, asfalt, ndriçim të rrugëve, autobus, rrymë elektrike, ujë, kanalizim, telefon, internet, gardh, parking dhe nënobjekte të ndërtuara ndërtimore (gjihtsej 180 m2). Çmimi 165.000 euro. Tel. 078-201-960

URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit ginekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221

XHERDAN SHAQIRI FLET PAS TRANSFERIMIT TE LIVERPULI

NË 'ANFIELD' PËR TË FITUAR TITUJ

"Jam shumë i lumtur që vij në një skuadër të madhe, me histori të lavdishme, lojtarë të mëdhenj dhe trajner fantastik. Dua shumë të përmirësohem dhe të fitoj tituj, ndaj edhe zgjedha t'i bashkoem Liverpoolit", tha Shaqiri në fjalët e para si lojtar i "The Reds"



JURGEN KLOPP

Mendoj se fraza më e mirë për ta shpjeguar vendimin për ta transferuar Xherdanin është 'pa kokëçarje'. Kur një lojtar si ai është në dispozicion në këtë mënyrë atëherë duhet të reagoni menjëherë, dhe e bëjmë. Xherdani është një person që do të përshtatet perfekt te Liverpooli. Ai ka personalitet dhe lëvizshmëri, ai është dikush që do të ushqejë emocionet pozitive të fansave tonë. Ai i bashkohet një grupi të djelmohave shumë të mirë dhe e di se ata do ta mirëpresin me duar të hapura dhe do ta ndihmojnë të vendoset dhe integrohet shpejtë. Ai gjithashtu luajti shumë mirë në Kupën e Botës, prandaj ai vjen te ne me një vetëbesim të plotë

Pas një sezoni mjaft të mirë në Premier Ligë me Stok Sittin dhe një Botërori për t'u mbajtur mend, Xherdan Shaqiri ka bërë një tjetër hap të rëndësishëm në karrierën e tij. Fantazisti me origjinë shqiptarë i Zvicrës, i është bashkuar skuadrës së Liverpoolit, teksa dje ka kryer vizitat mjekësore dhe ka bërë prezantimin zyrtar. "Jam shumë i lumtur që vij në një skuadër të madhe, me histori të lavdishme, lojtarë të mëdhenj dhe trajner fantastik. Dua shumë të përmirësohem dhe të fitoj tituj, ndaj edhe zgjedha t'i bashkoem Liverpoolit", deklaroi fantazisti në fjalët e para si lojtar i "the Reds". Shaqiri shikohet nga Klopp si një alternativë mjaft e vlefshme për të tre pozicionet pas sulmuesit kryesor, por mbi të gjitha, mund të jetë një pasues i Sallah, nëse egjiptiani vendos të largohet këtë verë. "Mezi pres që ky kapitull i ri në karrierën time të fillojë dhe të luaj në 'Anfield'. Të

jem pjesë e këtij ekipi do të jetë një moment shumë i veçantë për mua. Unë jam duke e parë të ardhmen time si i kuq", ka shkruar Shaqiri. Ndryshe, Shaqiri ishte lojtari kryesor edicionin e kaluar tek Stok Siti, por kjo nuk mjaftoi pasi nuk kishte ndihmën e duhur nga bashkëlojtarët. Por gjilanasit nuk ka harruar t'i falënderojë klubin dhe

tifozët për mbështetjen e madhe që i dhanë sa ishte pjesë e Stok Sittit. "Dua ta shfrytëzoj këtë mundësi për t'i falënderuar të gjithë mbështetësit e mijë tek Stok Siti, shokët e skuadrës dhe stafin tim për mundësin që ma dhanë që të vijë në Angli dhe për t'i kaluar tri vite të mrekullueshme në këtë klub. Edhe pse sezoni i fundit për-

fundoi me trishtim të tillë, unë nuk kam asnjë dyshim se klubi do të kthehet në Ligën Premier në një të ardhmet ë afër. Gjithmonë do të kem një vend në zemrën time për Stok Sittin", ka shkruar ndër tjera Shaqiri. Shaqiri te Liverpooli do ta bartë fanellën me numër 23, numër që e bartë edhe tek Kombëtarja e Zvicrës

E prisnin në Izrael, Basha shkon në Greqi

Një kapitull i ri për Migjen Bashën, futbollistin e kombëtares së Shqipërisë. Jo në Izrael, aty ku përfliet prej kohësh, por mesfushori i Barit, që ka probleme financiare dhe është drejt falimentimit, ka hedhur firmën e tij në Greqi, me skuadrën e Aris Selanikut. Basha ka firmosur sonte dhe nga ajo që ka mësuar "Sport Ekspres", ka nënshkruar për 2 vjet me 300 mijë euro në sezon. Një tjetër motiv, nga burime pranë lojtarit, ka qenë sidomos afërsia me Italinë, ku Basha jeton prej shumë vitesh, duke e pasur edhe bashkëshorten italiane. Basha ka veshur më parë edhe fanellën e Torinos, Komos, Lucernës, Riminit, Frosinones dhe Atalantas.



SIPAS AVOKATIT TË NAPOLIT

Hysaj nuk do të shkojë të Çellsit



Çellsit zyrtarizoi në krye të bankinës së tij, ish-trajnerin e Napolit, Maurisio Sarri. Pas kalimit të trajnerit në Angli po flitej edhe për një kalim të shqiptarit Elseid Hysaj të cilin ekipi londinez e kërkonte edhe më parë. Tashmë Çellsit nënshkroi me Zhorzhinjon dhe ka qenë avokati i Napolit, Matia Grasani i cili deklaroi se asnjë futbollist tjetër i Napolit, nuk do të shkojë të "The Blues" për shkak të Sarrit. "Më lejoni t'ju them filli-

misht, se këto ditë më kanë vendosur mua përpara dy njerëzve kampion, si Aurelio De Laurentis dhe Andrea Kiaveli. Gjithmonë ka pasur një marrëdhënie të mirë mes Çellsit dhe Napolit, prej disa vitesh. Sarri ka qenë te Napoli prej 3 vitesh dhe tashmë drejton ekipin anglez. Megjithatë presidenti i klubit italian është i qartë me vendimin e tij, ai zgjedh të ruaj integritetin e grupit", deklaroi Grasani.

REFER TURK NË TAKIMIN FC SHKUPI – GLLAZGOU REXHERS

Skuadra skoceze të hënën zbarkon në Shkup

Shkup, 15 korrik - FC Shkupi të martën më 17 korrik do të zhvillojë ndeshjen e kthimit ndaj Glazgou Renxhersit në stadiumin "Filipi i Dytë" në Shkup. Ndryshe, gjatë ditës së djeshme, nga radhet e FC Shkupi kanë dalë me disa lajmërimi, respektivisht për referat kryesor, dita se kur do të arrijnë futbollistët e Glazgou Renxhers dhe konferencat për shtyp dhe skuadrës së tyre dhe të mysafire nga Skocia. "UEFA ka përcaktuar edhe referat e kësaj përballje. Sfidat kthyese mes FC Shkupit dhe Renxhersit do të drejtohet nga referat turk, nën drejtimin e referat kryesor Halil Umur Meler, që do të ndihmohet nga Kerem Ersoj dhe Ibrahim Çağlar Ujarxhan", shkruan në faqen e klubit. "FC Shkupi të hënën organizon konferencë për shtyp para ndeshjes kthyese me Glazgou Renxhers. Takimi me gazetarët do të mbahet në hapësirat e stadiumit "Filipi i Dytë" në Shkup,



me fillim në orën 12:00, ndërsa në të njëjtën ditë në ora 18.00 në stadiumin "Filipi i Dytë". Pak para fillimit të stërvitjes, në orën 17.30, mysafirët kanë paraparë të zhvillojë takim me media", shkruan në faqen e klubit nga Çairi.

Cekim, sfida e parë e cila u zhvillua të enjten në "Ibrox" përfundoi me fitore të skuadrës skoceze me rezultatin 2-0. Rezultat, i cili u jep shpresë bardhekaltërve në ndeshjen e kthimit, ndërsa sipas asaj që arritëm të kuptojmë, interesimi për këtë ndeshje është shumë i madh, andaj pritjet një numër i konsiderueshëm i tifozëve dhe dashamirëve të FC Shkupit si dhe nga qytetet tjera, por edhe nga Kosova e Shqipëria. (B.K.)

Reciprocitet, Luginën e Preshevës për Veriun e Kosovës



Kryetari i Partisë Demokratike të Shqiptarëve (PDSH) Ragmi Mustafa ka deklaruar sot se është koha e fundit që Kosova ta pranojë kërkesën e shqiptarëve në Luginë të Preshevës që Lugina të ketë të drejta dhe status politik të barabartë me statusin politik të serbëve në veri të Kosovës. Mustafa për agjencinë e lajmeve FoNet ka thënë se "Deklarata politike e miratuar sot në Kuvendin e këshilltarëve shqiptarë të Luginës së Preshevës bazohet në shumë dokumente që i ka miratuar ky Kuvend i shqiptarëve që nga viti 2006, Referendumi i shqiptarëve dhe lufta e armatosur e shqiptarëve që e ka udhëhequr Ushtria Çlirimtare e Preshevës, Medvegjës e Bujanocit". I gjithë ky është sot kapital i shqiptarëve të Luginës së Preshevës në kohën kur po afrohet përfundimi i i negociatave ndërmjet Kosovës e Serbisë, tha Mustafa. Ai ka shtuar se shqiptarët nga këto tri komuna kërkojnë të kenë statusin politik të njëjtë me statusin politik të serbëve në veri të Kosovës.

KË E FRIKËSON USHTRIA E KOSOVËS?

Autoritetet e Kosovës, në vazhdimësi kanë deklaruar se Forcat e Armatosura të Kosovës, në të ardhmen, do të jenë faktor i stabilitetit brenda për brenda Kosovës dhe për rajonin, ndërkohë që autoritetet e Serbisë i shohin këto forca si të rrezikshme për paqen dhe si faktor i destabilitetit në rajon. Zëvendësministri i Forcave të Sigurisë së Kosovës, Burim Ramadani, duke folur për Radion Evropa e Lirë, thekson se qëndrimi i autoriteteve të Kosovës se Forcat e Armatosura të Kosovës do të jenë faktor stabiliteti në rajon, është i bazuar.

"Së pari, është aftësim i Kosovës për mbrojtje, për politika të mbrojtjes dhe për operacionalitet të mbrojtjes, është barabarësi në Ballkan me shtetet tjera, është aftësim i Kosovës që të hyjë në bashkëpunim operacional me shtetet jo vetëm në rajon, por edhe më gjerë, sidomos në kohën e sfidave globale të sigurisë, me ato që quhen kërcënime hibride, me të cilat po ballafaqohet bota demokratike", thotë Ramadani. Ai shton se Kosova, me Forca të Armatosura, të cilat do të përbëhen nga të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë, do të bëhet kontribuuese e sigurisë në rajon dhe jo vetëm konsumuese e sigurisë, pa e përfshirë edhe aftësimin e kapaciteteve për reagim në emergjencë të caktuara, të mbrojtjes territoriale, por edhe në emergjencë rajonale, si dhe të jetë pjesë e operacioneve paqeruajtëse të NATO-s, në rajone të ndryshme të botës.

Në anën tjetër, zyrtarët e shtetit serb, kanë theksuar se formimi i Forcave të Armatosura të Kosovës do ta rrezikojë paqen në rajon. Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ditë më parë, duke folur për mediat serbe, ka thënë se formimi i Ushtrisë së Kosovës është i rrezikshëm.

"Nuk do të donim që serbi të



Roli i Forcave të Armatosura të Kosovës, të cilat pritet të dalin si rezultat i procesit të transformimit nga Forca e Sigurisë së Kosovës, ditëve të fundit është bërë shkas i deklaratave të autoriteteve të Kosovës dhe atyre të Serbisë, të cilët shprehin qëndrime krejtësisht të kundërta lidhur me këtë rol

qëllojë mbi serbin, sepse për çka tjetër shërben ajo ushtri? Pse, a mos do t'i sulmojnë shqiptarët në Shqipëri, shqiptarët në Maqedoni apo shqiptarët që jetojnë në Mal të Zi, me të cilët kufizohen? Kë do ta sulmojnë? Kjo ka kuptim vetëm nëse ata do të niseshin kundër serbëve dhe Serbisë", ka deklaruar Vuçiq. Deklarata të ngjashme ka pasur edhe nga zyrtarët tjerë të Qeverisë së Serbisë. Por, sipas zëvendësministrit Ramadani, deklaratat e zyrtarëve serbë se Forcat e Armatosura të Kosovës do të shkaktonin destabilitetin në rajon, i quan tërësisht të pabazuara.

"Janë deklaratat plotësisht të paqëndrueshme, sepse, së pari, Kosova nuk ka asnjë pretendim territorial. Së dyti, Forca e Sigurisë

së Kosovës në tranzicion, do të jetë forcë mbrojtëse profesionale dhe shumetnike dhe sipas standardeve të NATO-s. Për më tepër, se deklaratat e Serbisë janë të paqëndrueshme, dëshmojnë me faktin se Kosova nuk synon të zëvendësojë KFOR-in, nuk synon të zëvendësojë prezencën e NATO-s në Kosovë edhe pas tranzicionit të FSK-së, që do të ndodhë së shpejti", thekson Ramadani. Njohësi i çështjeve të sigurisë, Nuredin Ibishi, thotë për Radion Evropa e Lirë se argumentet e autoriteteve të Kosovës se Forcat e Armatosura të Kosovës do të jenë faktor stabiliteti, janë krejtësisht të qëndrueshme. Për këtë arsye, sipas tij, transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura e ka edhe mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë, përfshirë edhe NATO-n. Statusi civil i FSK-së, thotë Ibishi, e pamundëson integrimin rajonal, sikurse në Kartën e Adriatikut, por edhe më gjerë.

"Pa ndërrimin e misionit nga ai civil në mision ushtarak, kjo është krejtësisht e pamundshme. Mendoj që është koha e fundit, në konstelacion të zhvillimeve të mëtej-

me dhe prezencës kërcënuese të Rusisë në rajon, që domosdo të punohet që të arrihet deri te ky transformim. Kjo krijon një stabilitet në rajon dhe përfundimisht bien ato tendenca ruse dhe serbe se kjo krijon destabilitet", vlerëson Ibishi. Sidoqoftë, ai thekson se një nga arsyet pse Serbia kundërshton transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura është fakti se ushtria është një nga elementet qenësore të shtetësisë së një vendi, të cilat krijojnë identitetin, por edhe sigurinë e shtetit.

Megjithatë, zyrtarët e NATO-s dhe partnerët ndërkombëtarë kanë shprehur qëndrimin se transformimi i Forcave të Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura, duhet të bëhet përmes ndryshimeve kushtetuese, të cilat deri më tash janë refuzuar nga përfaqësuesit politikë të serbëve në Kuvendin e Kosovës. Autoritetet e Kosovës kanë theksuar se në rast se ky refuzim i ndryshimeve kushtetuese vazhdon nga përfaqësuesit politikë të serbëve, në një moment të caktuar do të jenë të detyruar që ta mandatojnë Ushtrinë e Kosovës me ligj. (REL)

Shqipëria të pranojë emigrantët nëse do negociata me BE-në

Kushtet janë të qarta. Brukseli kërkon në tre drejtime kryesore rezultate të qëndrueshme deri në qershor 2019 që të hapë me Shqipërinë negociatat e pranimit në BE: përfundimi i reformave, zgjidhja e mosmarrëveshjeve me Greqinë, si dhe mbyllja e rrugës së re të emigracionit ilegal drejt Shqipërisë. Koha nuk pret për të dyja palët, Shqipërinë dhe BE. Në këtë kontekst, të premten, (13.07.2018), Presidenti i Këshillit Europian Donald Tusk dhe Komisioneri i Zgjerimit, Johannes Hahn zhvilluan takime në Bruksel me kryeministrin Rama, ku vunë pikat mbi "i" për fillimin e punës një orë e më parë. Në një njoftim për shtyp nga Kryeministria në Tiranë, Presidenti Tusk citohet të ketë thënë në një

konferencë të përbashkët shtypi me kryeministrin Rama se "Nuk kam dyshime që, nëse Shqipëria do të vazhdojë me këtë temp reformash, do të jetë në gjendje që të arrijë të gjitha rezultatet e kërkuara deri në qershorin e ardhshëm. Përpjekjet e Shqipërisë për të shesuar divergjencat me Greqinë janë prova më e mirë për angazhimin e saj ndaj BE-së dhe ndaj marrëdhënieve të mira fqinjësore. Kemi rënë dakord për rritjen e përpjekjeve lidhur me mbylljen e rrugës së re të emigracionit ilegal në Shqipëri".

Shqipëria është vlerësuar për qëndrimin e saj ndaj çështjes së nxehtë të refugjatëve nga vendet e Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut drejt BE. Në vijim të këtij

vlerësimi Brukseli ka shtuar një kusht për Shqipërinë: mbylljen e rrugës së re të emigracionit ilegal nga këto vende në Shqipëri për të synuar më pas BE. "Shqipëria mbetet një partner i mirë dhe një mik i BE-së në lidhje me sigurinë e migracionin, ku kemi një bashkëpunim të fuqishëm dhe të qëndrueshëm. Sot (13.07.2018) ramë dakord për nevojën për rritjen e përpjekjeve për të mbyllur rrugën e re të emigracionit ilegal në Shqipëri. Koha e limituar dhe situata politike në vend janë dy sfidat kryesore që Shqipëria duhet të përballojë që të ketë sukses në qershor 2019". Opozita e quan qeverinë Rama "qeveri të drogës dhe narko-trafikut" dhe kërkon rrëzimin e saj. Presidenti Tusk thekson



përsëri mesazhin e njohur të BE që palët duhet të bëhen bashkë, për çështje me rëndësi kombëtare, si hyrja e Shqipërisë në BE, që përkahehet nga mbi 90% e shqiptarëve.

Ai citohet të ketë thënë të shtunën se është shpresa dhe dëshira e tij që "të gjitha forcat politike pro perëndimore në Shqipëri të punojnë drejt të njëjtit qëllim".



Mbretëresha Elizabeth mund të shkarkojë kryeministrat e 15 shteteve!

Mbretëresha Elizabeth e Mbretërisë së Bashkuar ka super pushtet. Përveç ndikimit që ka në Britaninë e Madhe, pushteti i saj kalon kufijtë e shumë shteteve. Mbretëresha Elizabeth ka të drejtën për të shkarkuar të gjithë Qeverinë e Australisë. Ajo është kryetarja e shtetit në Australi dhe ka kompetenca të caktuara mbi qeverinë.

Për shembull, në vitin 1975, përfaqësuesi i Mbretëreshës në atë kohë, shkarkoi kryeministrin e Australisë dhe shpërndau Parlamentin. Më pas vendi shkoi në zgjedhje të përgjithshme. Që prej atij viti, nuk ka pasur ndërhyrje tjetër nga Mbretëresha në qeverinë australiane.

Përveç Mbretërisë së Bashkuar dhe Australisë, Mbretëresha Elizabeth është gjithashtu kryetarja e shtetit të Antigua e Barbuda, Bahamasit, Barbadosit, Belize, Kanada, Grenada, Xhamajka, Zelandë e Re, Guinea e Re, Shën Lucia, Shën Vincent, Ishujt Solomon dhe Tuvalu. Në të gjitha këto shtete, Mbretëresha Elizabeth ka kompetenca për shkak se janë ish-koloni britanike. Megjithatë, sikurse në Britani, roli i Mbretëreshës sot është kryesisht ceremonial.

Qyteti organizon lotari për vendet e lira tek varrezat!



Për vendet e lira tek varrezat e qytetit gjerman Berchtesgaden, gjithmonë ka pasur një interesim të madh. Mediat gjermane shkruajnë se ky qytet ka vendosur që të interesuarit të kenë shanse të njëjta për të marrë një vend të lirë, për çka ka organizuar një lotari. Autoritetet e qytetit për disa vite rresht refuzonin kërkesat për blerjen e trualit tek varrezat, të cilat datojnë nga shekulli i 17-të, me arsyetimin se nuk ka hapësira të mjaftueshme. Megjithatë, pas lirim të 200 parcelave, pushteti në qytetin të vendosur në Alpet bavareze vendosi të organizojë një lotari, në mënyrë që secili i interesuar të ketë shanse të barabarta për të blerë një tokë për varr. Lotaria do të mbahet të mërkurën, dhe deri sot, janë paraqitur 280 të interesuar.

CARI I VDEKUR QË PO NDANË PUTININ NGA KISHA



Presidenti Vladimir Putin nuk manifeston ndonjë kult për Nikolën e II dhe tregohet më pak i interesuar për jehonë të konfliktit me paraardhësin e tij, Boris Yeltsin. Megjithatë situata mbetet e sikletshme për Putinin, i cili gjithmonë është pozicionuar si aleat i afërt me Kishën

Me motivin e 100 vjetorit të ekzekutimit të Carit të fundit të Rusisë nga ana e bolshevikëve ka rilindur konflikti mes shtetit rus dhe Kishës ortodokse. Çfarë do të bëhet me mbetjet e familjes mbretërore? Patriarku ortodoks, Cirili do të fillojë të hënën një procesion në kujtim të Nikollës së II, Car dhe udhëheqës i Kishës ortodokse si edhe për bashkëshorten e tij, Aleksandra Fiodorovna, për 4 vajzat e tyre dhe djalin të pushkatuar në mëngjesin e 17 korrikut 1918 në afërsi të Ekaterimburtit në Urale dhe të kanonizuar në vitin 2000. Autoritetet ruse që gjithmonë janë përpjekur të mos zgjedhin mes trashëgimisë sovjetike dhe trashëgimisë cariste nuk parashikojnë asnjë përkujtim zyrtar. 20 vite pas varrimit të mbetjeve të Carit, gruas dhe tre prej vajzave të tyre, të zbuluara në vitin 1979, Kisha ortodokse e mohon njohjen dhe origjinalitetin e mbetjeve si dhe kryerjen e analizave të ADN-së për ta konfirmuar. Kleri i dominuar nga konservatorët mohon gjithashtu origjinalitetin e mbetjeve të dy fëmijëve të tjerë të Carit, Alekseit dhe të Marias, trupat e të cilëve u ndanë nga pjesa tjetër dhe nuk u gjetën deri në vitin 2007. Kockat e këtyre fëmijëve nuk janë varrosur për mungesë marrëveshjeje mes autoriteteve dhe Kishës. Në vitin 1998 patriarku i asaj kohe, Aleksi II përçmoi varrimet e shtetit të organizuara për kockat e Nikollës së II në kështjellën e Shën Pjetrit dhe në atë të Shën Pavlit në Shën Petërburg. Në vend të tij dërgoi një prift për t'i varrosur si "mbetje të një personi të panjohur". Me rastin e 100 vjetorit mediat ruse i kërkuan

patriarkut ortodoks, Cirilit të njohë mbetjet e familjes perandorake.

TEORIA E KOMPLOTTIT

Kisha konsideron se nuk ka mjaftueshëm prova për të favorizuar origjinalitetin e mbetjeve ashtu si edhe për të realizuar analiza ADN-je dhe akuzon shtetin se po përpjeket ta largojë klerin nga kjo çështje. Sipas këtij mendimi, bolshevikët dogjën pa lënë gjurmë trupat e 11 viktimave të familjes perandorake dhe të enturazhit më të afërt në një gropë në pyllin e Uraleve, ku më pas u ndërtua një manastir i madh. Sipas teologut dhe minisonarit, Andréi Kuraiev që shquhet për opinionet e tij reformiste këtë version e mbrojtën forcat cariste gjatë luftës civile në Rusi. Në 20 vite kjo u shndërrua në një teori të madhe komploti, - shprehet Ksenia Luchenko, specialiste për Kishën ortodokse ruse.

Sipas këtyre versioneve komplotiste, Lenini ruante kokën e Nikollës së II në zyrën e tij. Tjetër teori pohon se fëmijët më të vegjël, Aleksi dhe Maria iu vodhën vdekjes dhe u strehuan jashtë vendit. Vitin e kaluar imzot Tikhon, një peshkop i ngarkuar për hetimin nga ana e Kishës dhe i afërt me presidentin Putin, aludoi se mundësia e pushkatimit të familjes perandorake ishte një lloj "vrasjeje rituali". Mjediset pro shkencës në mes të Kishës u mënjanuan pas skandalit të "Pussy Riot" në 2012, - shpjegon Andréi Kuraiev duke iu referuar grupit muzikor të përfolur që hyri në katedralen kryesore në Moskë dhe këndoi një "lutje punk" kundër Putinit. Ky rast forcoi Kishën dhe krahun e saj konservator, i cili prej atëherë rritet çdo ditë, -

thotë Kuraiev. Patriarku Ciril ka "frikë" nga reagimi që do të bëjnë konservatorët, të indinjuar tashmë nga takimi i tij në 2016 me Papa Françeskon, nëse do t'i konsiderojë origjinale mbetjet e familjes perandorake, - sinjalizon Andréi Kuraiev.

E PAKËNDSHME PËR PUTININ

Vitin e kaluar, publikimi i filmit "Matilda" që rrëfen historinë e dashurisë mes Carit të ardhshëm, Nikollës së II me një balerinë, provokoi indinjatë të ortodoksëve më radikalë që manifestonin për të ndaluar shfaqjen në sallat e kinemasë. Ky film tregoi që Nikolla i II është një figurë që mund të ndajë shoqërinë ortodokse, pohon eksperti, Roman Lunkin i akademisë së shkencave ruse. Sipas tij, Cari i fundit është objekti i një "kulti të thellë" në manastirin në afërsi të Ekaterimburtit, aty ku do të organizohet procesioni i udhëhequr nga patriarku Ciril këtë të hënë. Presidenti Vladimir Putin nuk manifeston ndonjë kult për Nikolën e II dhe tregohet më pak i interesuar për jehonë të konfliktit me paraardhësin e tij, Boris Yeltsin, - sinjalizon ekspertja, Ksenia Luchenko. Megjithatë situata mbetet e sikletshme për Putinin, i cili gjithmonë është pozicionuar si aleat i afërt me Kishën.

"SHBA-të janë më të izoluara se kurrë"

Presidenti i Iranit, Hasan Rouhani, ka vazhduar me deklaratat e tij të drejtpërdrejta në televizionin shtetëror iranian, duke folur pas takimit me udhëheqësin e parlamentit dhe sistemit gjyqësor. Ai është munduar për të qetësuar shqetësimet e ndezura nga Shtetet e Bashkuara, pas vendimit të presidentit Donald Trump që të largohet nga marrëveshja e fuqive botërore me Iranin, për programin e tyre

nuklear. Rikthimi i sanksioneve amerikane ka sjellë një rënie drastike të monedhës iraniane, dhe protesta nga tregtarët që zakonisht janë besnikë udhëheqësve islamikë. "Sot jemi në kohën ku Shtetet e Bashkuara janë më të izoluar se kurrë, pas sanksioneve. Veprimet ilegale të Amerikës kanë bërë që ajo të jetë e izoluar edhe në mesin e aleatëve të saj, siç edhe e pamë", tha Rouhani duke

iu referuar protestave që u mbajtën në Britani kundër vizitës së Trumpit. Irani është duke tentuar që të implementojë standarde të caktuara nga Task Forca e Veprimit Financiar, grupi global kundër shpëlarjes së parave nga Qeveria, dhe grupi kundër financimit të regjimeve terroriste, duke shpresuar që do të largohet nga lista e zezë që largon shumë nga investitorët e huaj.

Në vitet e fundit të luftës, Zhukovi orkestroi të gjitha operacionet e çlirimit të tokave të mbetura të Bashkimit Sovjetik nga ushtria gjermane. Ai e përfundoi luftën duke marrë kryeqytetin e Rajhut të shkatërruar, Berlinin, i cili kapitulloi me 2 maj 1945. Disa ditë më vonë Aleatët do të shpallnin fitoren mbi Europë

GIORGI ZHUKOV

YLLI I KUQ QË DREJTOI BASHKIMIN SOVJETIK DREJT FITOREVE



Me trimërinë dhe egërsinë e tij, ai u vu në vëmendje të Stalinit, në atë kohë anëtarë qeverie. Stalini e inkurajoi atë të studionte shkencën ushtarake, të cilën e filloi në Rusi dhe Gjermani. Gjatë repozaljeve të 1937-38, ku shumica e ushtrisë u pastrua nga Stalini, Zhukovi ishte me shërbim në kufirin e Mançurisë. Në marsin e 1933-shit, ai drejtoi Divizionin e katërt të kavalerisë dhe falë punës së palodhur të tij në organizimin e formacionit, divizioni shumë shpejt u veçua për mirëperformancën e tij.

Në këtë kohë Zhukovi merr Urdhrin e Leninit, një medalje shumë e lartë për tu dhënë në kohë paqeje. Përpara se të fillonte beteja e Khalin-Golit, suksesi i parë ushtarak i tij, Zhukovi kishte pas vetes çerek shekulli karrierë ush-



tarake, duke kaluar nga rangu më rang nga ushtari në komandant korpusi. Për brilancën e treguar gjatë konfliktit sovjetiko-japonez ai u emërua Hero i Bashkimit Sovjetik, dhe u gradua në gjeneral. Në qershor të 1940-s ai mori komandën e Distriktit prestigjioz ushtarak të Kievit, ku me horizontin e tij të madh ushtarak trajnoi

trupat. Që kur kishte drejtimin e këtij formacioni ai filloi të ideonte mbrojtjen e BS-së nga një sulm i mundshëm gjerman. Autoriteti i Zhukovit u rrit akoma më tej në sytë e Stalinit. Me 15 janar 1941, ai emërohet Shef Shtabi të Përgjithshëm.

Zhukovi e mori punën me 1 shkurt dhe për një kohë të gjatë ai



Lindi me 2 dhjetor 1896 në një familje fshatare të Strelkovkës në provincën e Kalugës. Në moshën 7 vjeçare, ai frekuentoi një shkollë famullitare ku mësoi shkrim dhe lexim, por e braktisi në mënyrë që të ndihmonte prindërit e tij. Për një fare kohe, ai ishte çiraku i dajës së tij në Moskë ku mësoi zanatin e këpucarit dhe për pak kohë u mor me punimin e pëlhurave



i kërkoi Stalinit që ta përgatiste ushtrinë sovjetike për një sulm të papritur gjerman. Këtu duhet të përmend një citim në studimin e Stalinit të Dmitri Volkogonit, Triumph and Tragedy - ku Zhukovi i hartoi në mes të majit Stalinit një plan që mund të kishte kthyer përmbys natyrën pasive të strategjisë sovjetike. Filloi Lufta e Madhe Patriotike (kështu njihet Lufta e Dytë Botërore nga rusët), dhe gjatë kohështrirjes së saj, Zhukovi do të ekspozonte plotësisht aftësitë e lidërshiptit dhe brilancën e tij ushtarake. Stalini dhe Zhukovi nuk ranë dakord për strategjinë e mbrojtjes në momentin e pushtimit. Zhukovi preferonte vendosjen e një linje mbrojtëse jashtë Kievit.

Stalini e quante të çmendur këtë strategji dhe e mbajti Kievin dhe injorimi që i bëri Zhukovit i kushtoi 600.000 ushtarë që u kapën rob nga gjermanët, në rrethimin e Kievit. Zhukovi u pezullua nga pozicioni i tij si Shef Shtabi dhe u mor me kërcënimin më

Kontributin më të madh të mposhtjes së Rajhut Nazist e mban mbi shpatulla Bashkimi Sovjetik. Sigurisht, mbrojtjet heroike të Leningradit, Moskës dhe Stalingradit që ndryshuan kthesën e luftës, nuk mund t'i atribuohen një grupi individësh. Fitore të tilla janë vetëm rezultat i përpjekjeve të përgjakshme të qindra-mijëra dhe miliona njerëzve.

Por në qoftë se roli i një individi duhej të futej në llogari atëherë emri i Giorgi Zhukovit është i lidhur ngushtë me opinion publik si arkitekti që drejtoi operacionet më vendimtare të Luftës së Dytë Botërore duke dhënë një kontribut të padiskutueshëm në fitoren e Aleatëve. Giorgi Zhukov lindi me 2 dhjetor 1896 në një familje fshatare të Strelkovkës në provincën e Kalugës. Në moshën 7 vjeçare ai frekuentoi një shkollë famullitare ku mësoi shkrim dhe lexim, por e braktisi në mënyrë që të ndihmonte prindërit e tij. Për një fare kohe, ai ishte çiraku i dajës së tij në Moskë ku mësoi zanatin e këpucarit dhe për pak kohë u mor me punimin e pëlhurave.

E megjithatë ai i vazhdoi studimet dhe në 1913, Zhukovi i kaloi provimet. Me shpërthimin e Luftës së Parë Botërore, Zhukovi u vendos në një regjiment kavalerie. Më vonë ai do të shënonte se e gjente kavalerinë më interesante se këmbësorinë. Në këtë periudhë në kujtimet e tij Zhukovi i është shumë mirënjohës, komandantit të njësisë, i cili duke e vlerësuar potencialin e Zhukovit e instruktonte atë që të studiojë gjerësisht çështjet ushtarake. Në konfliktin e parë botërorë ai shërbeu me kurajo dhe fitoi dy medalje.

Pas Revolucionit Bolshevik të 1917-s, ai u bë anëtar i Partisë Komuniste dhe në gusht të 1918-s, hyri vullnetarisht në Ushtrinë e Kuqe, duke marrë komandën e një regjimenti dhe më vonë ai u plagos në 1919 në Luftën Civile Ruse. Në gushtin e 1922-shit, Zhukovi merr dekoratën e parë sovjetike, Urdhrin e Flamurit të Kuq. Është e rëndësishme të theksohet këtu se komanda e një regjimenti konsiderohej gjithmonë si një hap i rëndësishëm në përvetësimin e eksperiencës ushtarake.



të afërt të fushatës Barbarosa, avancimin gjerman drejt Moskës. Ai ia doli ta mbronte Moskën falë 1941-42 dhe një dimër më vonë triumfon vendimtarisht mbi Stalingrad. Viti 1943 do të lulëzonte me fitore të tjera për Zhukovin. Në fillim të 1943-shit, ai tentoi të thyejë rrethimin gjerman 3 vjeçar të Leningradit, dhe në verën e atij viti, korri një fitore vendimtare në Kursk, betejën më të madhe të tankeve në histori.

Në vitet e fundit të luftës, Zhukovi orkestroi të gjitha operacionet e çlirimit të tokave të mbetura të Bashkimit Sovjetik nga ushtria gjermane. Ai e përfundoi luftën duke marrë kryeqytetin e Rajhut të shkatërruar, Berlinin, i cili kapitulloi me 2 maj 1945. Disa ditë më vonë Aleatët do të shpallnin fitoren mbi Europë. Një ngjarje që Zhukovi e kujton me lavdi dhe çdo rus kur e shikon atë sekuencë filmike ndihet krenar, është momenti i datës 24 qershor 1945, ku Zhukovi hipur mbi një kalë të bardhë parakaloi nëpër Sheshin e Kuq të Kremlinit, duke celebruar fitoren mbi Gjermaninë Naziste.

Nga fundi i luftës deri në mars të 1946 ai ishte Komandant i Forcave të Okupimit në zonën sovjetike të Gjermanisë. Stalini nuk e shikonte me sy të mirë popullaritetin në rritje të Zhukovit, gjë që nuk i dha paqe diktatorit të çeliktë. Edhe pse Zhukovi u bë Komandant i forcave Tokësore Sovjetike dhe Zëvendësministër i Mbrojtjes, ai qëndroi 3 muaj në këtë post.

Ai dërgohet në Distriktin Usharak të Odesës, dhe më vonë nga frika se mund të arratiset u dërguan në një distrikt më të izoluar, në Urale. Me vdekjen e Stalinit, Nikita Hrushovi e mirëpriti Zhukovin duke i dhënë një post në byronë qeveritare. Por edhe Hrushovi i druhej autoritetit në rritje të Zhukovi dhe e shkarkoi. Në 1964, lideri i ri sovjetik, Leonid Brezhnev, e restauroi pak figurën e Zhukovit por prapë se prapë, ai nuk iu kthye jetës politike dhe ushtarake. Ai i kaloi vitet e fundit të jetës ai u mor në shkrimin e një libri të jashtëzakonshëm, Kujtimet dhe Reflektimet, një autobiografi e Zhukovit, ku si temë qendrore kishte vitet e Luftës së Dytë Botërore. Megjithatë degjenerimin që i ishte bërë figurës së Zhukovit, asgjë nuk e intimidoi popullin rus të merrte pjesë masivisht në varrimin e tij me 18 qershor 1974. Audienca e përplotur i dha lamtumirën e fundit kur ai u varros në murin e Kremlinit.

GEISHAT, ARTISTET QË PERËNDIMORËT I MORËN PËR PROSTITUTA

Geisha e fundit po vdesin. "Artet dhe kultura tradicionale, kushtojnë shumë para për t'u ruajtur", tha një geisha në vitin 2017, që lufton të mbajë gjallë biznesin e saj. Sot, shumë biznese të tilla mezi janë fitimprurëse. Por ato që mbeten gjallë, e bëjnë këtë për shkak të grave që e kanë një pasion për këtë punë

Nga Mark OLIVER

"Ne duam vajzat geisha!". Në vitin 1945, britmat çanë ajrin e natës në Japoninë e pushtuar nga amerikanët. Ajo doli nga goja e ushtarëve të dehur amerikanë, të dënuar mirë me sake të ngrohtë, dhe nga përpjekjet e tyre të ngathëta për të shqiptuar ndonjë fjalë në japonisht. Ata e dinin se gieshat nuk ishin asgjë më shumë se sa prostituta. Qëkur amerikanët kishin zbarkuar në Japoni, gratë që kishin shitur trupat e tyre tek ushtarët amerikanë, e kishin quajtur veten "vajzat geisha".

Pas viteve të luftës, njerëzit ishin të dëshpëruar për çdo punë që mund të paguhej. Dhe nëse një grua ishte e gatshme të hiqte dorë nga trupi i saj, ushtarët amerikanë ishin të gatshëm të hiqnin dorë nga paratë e tyre. Natyrisht, ushtarakët amerikanë nuk e dinin se çfarë ishin realisht geishat. Ata nuk e dinin se punëtoret e seksit që ngjyenin fytyrën me bojë të bardhë, nuk kishin të bënin aspak me traditën shekullore japoneze të artistëve krenarë, që ishin geishat e vërteta. Dhe si prostitutat ashtu edhe klientët e tyre, nuk e kishin idenë se duke e shfrytëzuar këtë traditë, ata po e shkatërronin atë.

Por historia e vërtetë e geishave në Japoni, është shumë më e pasur dhe më komplekse sesa kanë menduar ata që e kanë shfrytëzuar. Pavarësisht se si e shohin shumica e njerëzve këtë term, termi "geisha" nuk do të thotë "prostitutë", por "artistë". Kur geisha e parë moderne, u shfaq në qytetet e mëdha të Japonisë në shekullin XVII, ato nuk i shisnin trupat e tyre për seks. Ato ishin artiste—dhe ata ishin edhe burra. Këta burra ishin valltarë, këngëtarë dhe muzikantë. Ata ishin artistë, por jo plotësisht të ndarë nga punonjësit e seksit. Ata do të ngrinin dyqane brenda shtëpive, dhe do të argëtonin klientët të cilët ishin duke pritur për radhën e tyre me kurtizanet më të shtrenjta (oiran). Rreth fillimit të shekullit XIX-të, gratë filluan të merrnin rolin e tyre, dhe këto geisha femra kryesisht nuk flinin me klientët e tyre. Detyra e tyre, ishte të argëtonin burrat që prisnin oiran-in.

Nëse ata flinin me klientët e tyre, do t'i merrnin biznesin punëdhënës të tyre. Kështu që këto gra nuk zgjodhën të mos i shisnin trupat e tyre - ato ishin rreptësisht të ndaluar ta bënin këtë. Për të qenë të sinqertë, disa geisha (si dhe disa gra që thjesht e quanin veten me këtë emër, pavarësisht nëse ishte e vërtetë apo jo) i shitnin trupat e tyre, dhe linjat midis artistit dhe prostitutës ishin të paqarta në kohë.

Trajnimi i një geishe mund të fillonte që kur ajo ishte 6-vjeçe. Ajo pastaj do të kalonte 5 ose më shumë vjet trajnime, duke e kaluar pjesën më të madhe në një shtëpi stërvitore (okiya), ku do të kujdeset për dhomën dhe furnizimet e saj. Për të paguar borxhin, geisha e



re mundej të punonte në atë shtëpi për pjesën më të madhe të jetës së saj.

Trajnuesit quheshin maiko, dhe do të kalo-

nin vite duke u mësuar vajzave se si të luanin instrumente muzikore, apo të visheshin. Ata do t'u mësonin valle të ndërlikuara, në të cilat lëvizja më e vogël ishte e mbushur me një thellësi të madhe simbolike. Dhe mbi të gjitha, ata do të mësonin se si të ndriçonin një dhomë. Për më tepër, këto gra duhet të përfaqësonin kulmin e feminitetit. Ato do të mësonin të ecnin me hijeshinë më të madhe, teksa ishin zbukuruar me një kimono. Ato do të mësonin se si t'i kënaqnin njerëzit duke i tërhequr me pamjen misterioze dhe magjepsëse. Dhe ato do të mësonin të shkruanin poezi dhe këngë të bukura melankolike.

Në tërësi, trajnimi i tyre zgjaste shumë vite, dhe nuk do të përfundonte asnjëherë. Edhe kur një grua ishte e stërvitur plotësisht dhe po i afrohej moshës së thyer, pritej që ajo të kalonte orë të tëra, duke praktikuar çdo ditë muzikën dhe artet. Sidoqoftë, bota artistike e geishave, nuk qëndroi përgjithmonë e ndarë nga ajo e prostitucionit. Kurtizanet filluan kopjimin e disa prej aspekteve kryesore të veshjes, sjelljes,



aftësisë për të argëtuar, dhe gjëra të ngjashme. Dhe kjo sepse për shumë nga burrat që vizitnin shtëpitë publike, geisha ishte një pjesë e

madhe e tërheqjes po aq sa vetë prostituta.

Prandaj, disa prostituta kështu filluan të vishen si geisha, duke luajtur muzikë dhe duke kënduar për klientët e tyre, me shpresën se do t'u ofronin burrave një version më të lirë të asaj që ata mund të gëzonin brenda pallateve të shtrenjta të kënaqësisë së qyteteve të mëdha, ku punonin geishat e vërteta. Kur ushtarët amerikanë pushtuan Japoninë pas humbjes së kësaj të fundit në Luftën e Dytë Botërore, kuptimi i fjalës geisha ndryshoi përgjithmonë. Prostitutat që kishin imituar geisha, i vunë në shënjestër ushtarët, të veshura me kostume të përpunuara, dhe ofruan pak më shumë se sa trupat e tyre. Për ushtarët e vetmuar rreth 5000 kilometra larg shtëpisë, joshja nga një trupi i ngrohtë për të ndarë një shtrat, ishte e vështirë për t'i rezistuar



Kur ushtarët amerikanë pushtuan Japoninë pas humbjes së kësaj të fundit në Luftën e Dytë Botërore, kuptimi i fjalës geisha ndryshoi përgjithmonë. Prostitutat që kishin imituar geisha, i vunë në shënjestër ushtarët, të veshura me kostume të përpunuara, dhe ofruan pak më shumë se sa trupat e tyre. Për ushtarët e vetmuar rreth 5000 kilometra larg shtëpisë, joshja nga një trupi i ngrohtë për të ndarë një shtrat, ishte e vështirë për t'i rezistuar

"geisha girl", si një mënyrë për të joshur burrat. Shumë shpejt, për pjesën më të madhe të botës perëndimore, fjala geisha ishte e padallueshme nga fjala prostitutë. Sot kanë mbetur vetëm një grusht geishash. Totali i vlerësuar në Japoni u ul nga rreth 80.000, në vetëm disa mijëra gjatë rrjedhës së shekullit XX-të.

Por për ato pak që mbeten, profesioni i tyre është kthyer në pastërtinë relative të para luftës, dhe ka pak ose aspak të bëjë me prostitucionin. Shtëpitë e çajit të geishave moderne, janë vende të argëtimit, shoqërimit dhe kënaqësive të arteve. Por geisha e fundit po vdesin. "Artet dhe kultura tradicionale, kushtojnë shumë para për t'u ruajtur", tha një geisha në vitin 2017, që lufton të mbajë gjallë biznesin e saj. Sot, shumë biznese të tilla mezi janë fitimprurëse. Por ato që mbeten gjallë, e bëjnë këtë për shkak të grave që e kanë një pasion për këtë punë.



Zviceranët konsumojnë rreth 5 tonelata kokainë në vit

Rreth 80 për qind e përdoruesve të kokainës janë konsumatorë të vegjël dhe marrin vetëm sasi të vogla. "Pjesa e mbetur prej 20 për qind konsumojnë shumë më tepër, një mesatare prej një gjysmë gram në ditë", thotë Zobel

Ajo përdoret me nofkën "Powder", "Borë", "Charlie" ose "Koks", ndërsa mund të merret nëpër klube, me taksë ose tek fqinjët. Kokaina është bërë drogë e përditshmërisë. Një studim nga Universiteti i Lozanës, Spitalit Universitar të Lozanës dhe "Varësia Zvicër" tani ka dëshmuar se tregu i kokainës në Zvicër, pas kanabisit është tregu më i madh për narkotikët. Vlerësohet se rreth 5 tonelata kokainë konsumohen për çdo vit në Zvicër. "Kokaina konsumohet si nga menaxherët, po ashtu edhe nga amviset, mësuesit apo kuzhinierët, pra nga të gjitha shtresat shoqërore", deklaroi Frank Zobel, zëvendës drejtor i "Varësia Zvicër". Megjithatë, rreth 80 për qind e përdoruesve të kokainës janë konsumatorë të vegjël dhe marrin vetëm sasi të vogla. "Pjesa e mbetur prej 20 për qind konsumojnë shumë më tepër, një mesatare prej një gjysmë gram në ditë", thotë Zobel. Grupi i konsumatorëve të shpeshtë mund të ndahet në dy grupe. Grupi i parë përfshin të varurit nga droga të cilët e blejnë kokainë në rrugë, me cilësi të dobët dhe sa herë që kanë para, shkruajnë mediat zvicerane. Sipas Zobel blerja e rrugës është një lotari: "Testimet tona kanë shpalosur pjesërisht një nivel pastërtie nga 0 në rreth 70 për qind - një pjesë e saj nuk do të shkojë në hundë". Grupi i dytë përfshin përdoruesit e integruar të drogës, me familje dhe punë. "Atyre u takon edhe të ftohtit: Para një prezantimi të rëndësishëm në punë, në dalje me miqtë ose gjatë seksit", thotë Zobel. "Është si doping për ta bërë atë nëpër jetën stresuese." Këta njerëz kanë para dhe i përkasin klientelës më të mirë të tregtarëve. Sipas udhëheqësve të studimit, Zobel ishte befapsuar nga fragmentimin e tregut të kokainës në Zvicër: "Afrikanët veriorë dominojnë tregun që në fillim të vitit 2000, ka edhe amerikano-latinë nga origjina e kokainës ose tranzit, ish trafikantët shqiptarë, por edhe evropianët të cilët kanë zbuluar se si mund të bëhen para me të". Kokaina po bëhet gjithnjë e më e famshme në të gjithë Europën, po ashtu edhe në Zvicër. Megjithatë, shumica e konsumatorëve e fshihnin mënyrën se si kokaina gjeti rrugën për në Zvicër. "Kokaina është një nga drogat më të dëmshme që ekziston", thotë Zobel.

ITALIA PUBLIKON RAPORTIN E VITIT

NA MBYTI DROGA SHQIPTARE



Sipas shifrave të publikuara në raport, shtetasit shqiptarë vijnë të dytët në personat e huaj të arrestuar për trafik dhe shpërndarje të kokainës (me rreth 1100 persona të arrestuar). Raporti vlerëson se nga 14.000 persona të huaj që janë përfshirë në vepra të drogës në Itali përgjatë vitit 2017, nga të cilat janë arrestuar më shumë se 10 mijë, rreth 2000 persona kanë qenë nga Shqipëria

"Shqipëria është vendi i origjinës së shumicës së sasive të marijuanës që kanë si destinacion tregjet italiane dhe evropiane". Pohimi vjen nga Drejtoria Qendrore për Shërbimet e Antidrogës në Itali, e cila sapo ka publikuar "Raportin Vjetor" në lidhje me vitin 2017. "Importet e marijuanës në Itali janë rritur ndjeshëm duke arritur në vitin 2017 në një rekord të konfiskimeve, mbi 90 ton nga rreth 41 tonë që ishin në vitin 2016", vlerëson Raporti duke shtuar se "trendi i konfiskimeve në Itali, lidhet me kultivimin e marijuanës në Shqipëri.

Raporti përmend rastin në 2017 "të konfiskimit më të madh të kryer ndonjëherë, në rajonin e Marche-ve, të barabartë me 8 ton marijuanë, të cilat kishin si destinacion Europën Veriore".

Raporti i antidrogës italiane vlerëson se "për më tepër klanet shqiptare kanë treguar se kanë një aftësi në rritje të menaxhimit në kultivimin e marijuanës dhe trafikimit të saj". Sipas dokumentit, ato përdorin bimë me rendiment të lartë dhe

metodat gjithnjë e më të larmishme të fshehjes, kultivimit dhe transportimit në brigjet italiane. Nisur nga përmasat e trafikut, sipas Raportit "grupet e krimit shqiptar konkurrojnë me organizata të tjera kriminale për kontrollin e pjesëve të rrugëve të trafikimit që arrijnë në Itali, si dhe për menaxhimin e rrjeteve të shpërndarjes së drogës.

Nga të dhënat e raportit shqiptarët zinin vendin e parë në rrjetet kriminale të huaja të narkotrafikut të përfshirë në trafikun e drogës me 25 nga 94 gjithsej. Pas tyre vijnë rrjetet nga Gambia dhe Maroku.

Raporti vlerëson se 94 rastet e raportuara në vitin 2017 të trafikimit të drogës janë më të lartat në dekadën e fundit ndërkohë që vlera më e ulët shënohej në vitin 2011, me 49 raste. Raporti i Antidrogës italiane vlerëson se "rrugët e trafikut të drogës që çojnë drejt kufijve të shtetit italian mbetën të pandryshuara. Shumica e drogave të konfiskuara, afërsisht 95% u kapën jashtë vijës bregdetare, në ujërat territoriale dhe përgjatë kufijve detarë", vlerëson raportin.

Në zonat kufitare lidhur me trafikun e marijuanës shënohet edhe numri më i madh i shqiptarëve të arrestuar, 41 persona nga 93 të huaj të ndaluar në kufijtë italianë përgjatë vitit 2017 me ngarkesa marijuane.

Por grupet shqiptare nuk e kanë kufizuar aktivitetin e tyre vetëm në trafikun e marijuanës. Raporti i Antidrogës italiane shpreh shqetësimin se "së bashku me 'Ndrangheta' në Kalabri, e cila falë një rrjeti kompleks të lidhjeve ndërkombëta-

ter ka ende një rol kyç në trafikimin e kokainës në Itali, gjatë vitit 2017, dolën në pah, disa grupe të ashpra të krimit të huaj, të përbërë nga shtetas marokene, nigerianë dhe shqiptarë. Veçanërisht këta të fundit, si dëshmi e një hopi cilësor në aftësitë e tyre operative, konkurrojnë me grupimet e tjera kriminale, kontrollin

e segmenteve të rrugëve të trafikut në Itali dhe drejtimin e rrjeteve të shpërndarjes në territorin kombëtar të substancave kryesore narkotike".

Sipas shifrave të publikuara në raport, shtetasit shqiptarë vijnë të dytët në personat e huaj të arrestuar për trafik dhe shpërndarje të kokainës (me rreth 1100 persona të arrestuar). Raporti vlerëson se nga 14.000 persona të huaj që janë përfshirë në vepra të drogës në Itali përgjatë vitit 2017, nga të cilat janë arrestuar më shumë se 10 mijë, rreth 2000 persona kanë qenë nga Shqipëria.

Raporti i policisë italiane vë në dukje shtrirjen e aktivitetit edhe në Europë të grupeve shqiptare, të cilat "renditen mes atyre më aktive, sa i përket mundësive operative, duke nisur nga aftësitë e kontrollit në fazën e zbarkimit dhe tërheqjes së furnizimit në portet holandeze dhe belge, të përdorura për futjen në Europë të kokainës, duke shfrytëzuar aftësitë e infiltrimit në strukturat logjistike dhe portuale të lëvizjeve të kontenerëve". Hetimet, sipas Raportit, kanë dokumentuar organizimin kapilar të rrjetit të shpërndarjes së kokainës në territorin evropian që lidhet me organizata kriminale shqiptare, si dhe mundësitë e mëdha në mjete dhe persona që përdoren për këtë qëllim.

Grupet shqiptare nuk e kanë kufizuar aktivitetin e tyre vetëm në trafikun e marijuanës. Raporti i Antidrogës italiane shpreh shqetësimin se "së bashku me 'Ndrangheta' në Kalabri, e cila falë një rrjeti kompleks të lidhjeve ndërkombëtare ka ende një rol kyç në trafikimin e kokainës në Itali, gjatë vitit 2017, dolën në pah, disa grupe të ashpra të krimit të huaj, të përbërë nga shtetas marokene, nigerianë dhe shqiptarë"

Evitojeni ujin e ftohtë, ju dëmton shëndetin!



E dimë se është verë dhe bën vapë, por sërish edhe në këtë stinë duhet të kujdesemi për shëndetin. Uji i ftohtë vërtet që shijon shumë në këtë periudhë, por edhe e dëmton shëndetin tonë. Më poshtë do të listojmë disa nga arsytet se pse nuk duhet të konsumojmë ujë të ftohtë në verë. Është e vështirë t'i shmangemi pijeve të ftohta, por duhet ta bëjmë për të mirën tonë.

- Kur pimë ujë të ftohtë, ne ngadalësojmë qarkullimin e gjakut në të gjithë aparatit tretës, pasi dihet që në mjedis të ftohtë, vazat e gjakut ngushtohen, pra bëjnë atë që njihet si vazokonstriksion.

- Ushqimet që ne konsumojmë, ndërkohë që pimë edhe ujë të ftohtë, nuk na shërbejnë aspak si burim energjie. Përkundrazi, energjia që sigurojmë prej tyre, nuk shkon për përballimin e aktivitetit tonë të përditshëm, por për të rregulluar temperaturën tonë të brendshme.

- Uji i ftohtë pakëson sasinë e mukusit të sekretuar përgjatë aparatit tretës, gjë që bën të mundur dobësimin e sistemit imun dhe prekjen më të lehtë prej infeksioneve bakteriale, apo virale në traktin gastrointestinal.

- Ushqimet që ti konsumon, ndërkohë që pi edhe ujë të ftohtë, metabolizohen më ngadalë në trup. Ky ngadalësim i metabolizmit mund t'ju çojë shumë lehtë edhe në shtim të peshës suaj.

- Rënie të lehtë të temperaturës trupore. Qëllimin pse ne e konsumojmë në verë ujin e ftohtë, e arrijmë më së miri, por rënia e temperaturës sonë trupore na çon shumë lehtë në shpenzim të energjive tona të brendshme, të cilat mund t'i përdornim për aktivitetet tona të përditshme.

SA DIMË NE TË USHQEHEMI SHËNDETSHËM?

Nëse në frigoriferin e shtëpisë tënde mban gjëra të shëndetshme, ti rrjedhimisht do të ushqehesh shëndetshëm. Dhe në një trup të shëndoshë, gjithmonë mendja është e shëndoshë

"Ne jemi çfarë hamë". Edhe në ëndërr na del kjo fraza. Aq shpesh e kemi dëgjuar, sa që kur na e përmendin njerëzit e afërm, fillojmë e tallemi me ta. Krijojmë situata humorit. Ne bëjmë sikur e kemi kuptuar një gjë të tillë dhe dimë ta vëmë në zbatim, por në fakt, në vendin tonë mungon kultura e të ushqyerit shëndetshëm. Kjo gjë ndodh edhe në ditët e sotme, kur mjetet e informimit janë të shumta.

Sa e sa emisione kemi parë për të ushqyerin e duhur. Sa shkrime mund të kemi lexuar në rrjetet sociale dhe prapë e njëjta histori. Nuk dimë të ndajmë gjërat e shëndetshme nga ato jo të shëndetshme. bTëksa po kaloja një ditë para një mense, dëgjoj shkarazi dikë që porositi një pjatë plot me patate të skuqura dhe me tre kokrra vezë, po ashtu të skuqura. Ktheva kokën për ta parë dhe ai më qeshi duke më thënë "Një jetë kemi. Do ta shijojmë".

Sa metodë e bukur për të shijuar jetën: Le të mos jenë gjërat të duhura për t'u ngrënë. Mjafton që neve të na pëlqejnë dhe të ka heqin pak nepsin që mund të kemi për momentin. Por le ta mendojmë pak se çfarë bëjmë. Realisht ne jetojmë të rrethuar nga gjëra të pasigurta. Ke frikë të blesh diçka, sepse të thonë që është pa kimikate të dëmshme dhe kur nis ta konsumosh, e kupton që shitësi të ka gënjer. Ndoshta edhe atë e ka gënjer prodhuesi i produktit. Ndoshta



edhe këtë të fundit e ka gënjer dikush tjetër, e kështu lista e gënjeshtreve nuk ka fund në vendin tonë. Por çfarë duhet të bëjmë? T'ia vëmë fajin vetes, sepse realisht metoda për informim ka plot dhe në ditët e sotme të mos dish se çfarë të bën mirë e çfarë jo, është pak turp.

Por ka dhe nga ata që e dinë se diçka u bën keq dhe sërish e konsumojnë. Në Amerikë shumica e personave që punojnë në zyra vuajnë nga obeziteti, sepse ushqehen me ushqime të shpejta në fast food-e. Unë ndiej se edhe ne drejt diçkaje të tillë po shkojmë. Nisim fëmijët në shkollë dhe nuk i përgatisim atyre diçka të shëndetshme në shtëpi, por u japim lekë që të blenë ushqime të gatshme, që e dimë se si gatuhen. Mjekët nga njëra anë thonë se nuk duhet gatuar me të njëjtin vaj dy herë, ne prapë i lëmë fëmijët të hanë në këto vende. Sa është siguria se fast food-et e zbatojnë atë që mjekët thonë? Zero.

Po bisedoja një ditë me një shitëse në një treg fruta perimesh. Më tha se shitjet sa kishin ardhur e kishin rënë në muajt e fundit, sidomos për frutat. Dhe si mund të presësh shëndet të plotë nga qytetarë që nuk konsumojnë fruta? Ata nuk marrin vitaminat dhe produktet e tjera të domosdoshme që gjenden vetëm në fruta. Kemi një kulturë të ushqyerit relativisht të mangët dhe mesa duket kështu do të vazhdojmë edhe në vitet që do të vijin. Nëse ne nuk zgjedhim produktet bio, përpara atyre me kimikate, apo nëse vendosim produktet pa vlerë përpara atyre që na ndihmojnë për shëndetin, ne do të vazhdojmë ta dëmtojmë shëndetin tonë pikërisht me zgjedhjet që bëjmë.

Nëse në frigoriferin e shtëpisë tënde mban gjëra të shëndetshme, ti rrjedhimisht do të ushqehesh shëndetshëm. Dhe në një trup të shëndoshë, gjithmonë mendja është e shëndoshë.

OBSH njuh varësinë nga seksi si çrregullim mendor

Për herë të parë edhe varësia ndaj seksit, hyn në listën e sëmundjeve të njohura nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, në kategorinë e problemeve mendore. Ky fakt ka ngjallur reagime skeptike të një sërë ekspertësh, sipas të cilëve nuk ka ende mjaftueshëm prova shkencore, për të mbështetur një vendim

të tillë. Por OBSH thotë se çrregullimi seksual duhet të zgjasë më shumë se gjashtë muaj, për tu klasifikuar si sëmundje. Vendimi i marrë në kuadër të "International Classification of Diseases", do të hyjë në fuqi në vitin 2022, pas pranimit në asamblenë e OBSH. Çrregullimi seksual kompleks karakterizohet

nga një skemë e dështuar në kontrollin e impulseve seksuale intensive dhe përsëritëse, të cilat manifestohen në sjelljet seksuale përsëritëse. Simptomat përqendrohen në faktin se aktiviteti seksual kthehet në qendrën e jetës së personave, aq sa lënë pas shëndetin e tyre, interesat e tjera dhe përgjegjësitë.

IVF nuk rrit rrezikun nga kanceri

IVF nuk rrit rrezikun nga kanceri i gjirit te femrat, kanceri ovarian ose ai në mitër, tregon një studim i publikuar sot. Studimet e mëparshme implikojnë trajtimin e fertilitetit në rritjen e rrezikut për sëmundje të tilla, për shkak të niveleve të larta të hormoneve të ekspozuara. Megjithatë, shkencëtarët nga University College i Londrës zbuluan se gratë kanë më shumë gjasa të zhvillojnë kushte të tilla

pas IVF nëse kanë faktorë të tjerë të rrezikut, siç është historia familjare e kancerit. Që nga fëmija i parë i lindur me IVF në korrik 1978, deri në pesë milionë foshnja kanë lindur me këtë metodë në mbarë botën. Në Britani të Madhe dhe SHBA, rreth një në tetë gra do të zhvillojnë kancerin e gjirit në një pikë në jetën e tyre. Kanceri i mitrës është forma e katërt më e zakonshme e sëmundjes. Studiuesit kanë analizuar

të dhënat e 255.786 femrave që kishin IVF në Britani të Madhe ndërmjet viteve 1991 deri 2010. Gratë ishin mesatarisht 34-vjeç dhe kishin përfunduar një raund IVF në fillim të studimit. 19 për qind e tyre kishin një shkak të paqartë të infertilitetit. Në 44 për qind të rasteve shkaku është menduar të lidhet me gratë, ndërsa problemet mashkullore përbënin 33 për qind të rasteve.



Nga Bryan LUFKIN

FACEBOOK NUK DO TË “VDESË” KURRË!

Isha student në Universitetin e Indiana në vitin 2004 kur dëgjova për herë të parë për një faqe interneti për të rinjtë në moshën time. Kam biseduar me disa miq në dhomën time të konviktit, në fillim të një semestri të ri. “A keni dëgjuar për Facebook-un?” Pyetën disa prej tyre. “Duhet të hapni një llogari. Është një mundësi për të komunikuar mes studentëve në universitet”.

Më herët gjatë muajit Prill të vitit 2018, themeluesi dhe CEO i Facebook, Mark Zuckerberg, u ul në Kongresin amerikan në përpjekje për të bindur ligjvënësit që rrjeti i tij social, fillimisht i krijuar si një mënyrë për studentët që të vihen në kontakt me njëri-tjetrin, nuk përbën kërcënim për stabilitetin e demokracisë perëndimore dhe nuk i neglizhon të dhënat personale të përdoruesve të tij. Gjatë seancës, ai pranoi se kompania e tij nuk kishte bërë mjaftueshëm për të parandaluar shërbimet që lejojnë përhapjen e lajmeve të rreme, ndërhyrjet e huaja në zgjedhje dhe rrjedhjen e të dhënave. Në Mars, rezultoi që një konsulent politikë e quajtur Cambridge Analytica përdori të dhëna të mbledhura nga miliona përdorues të Facebook pa miratimin e tyre. Skandali tronditi Facebook dhe e ka detyruar themeluesin e tij të rishqyrtojë mënyrën se si ky rrjet social funksionon.

Në raundin e dytë të ndjesës së Zuckerberg ai u përball me Parlamentin Europian këtë javë dhe u ballafaqua me pyetje edhe më të ashpra, ashtu si edhe Evropa është gati të fusë ligje të reja që do të paraqesin disa nga rregullat më strikte të privatësisë së të dhënave në botë: Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave. Kjo është shumë larg nga arsyeja që unë dhe shokët e mi të universitetit e kemi përdorur rrjetin social 14 vite më parë: dërgimin e një kërkesë miqësie të dikujt që na pëlqente etj. Si një nga mijëra përdoruesit e parë, unë mendoj se evolucioni i Facebook dhe funksioni i tij në shoqëri është interesant po aq sa edhe shqetësues. Por edhe pas katastrofës së Cambridge Analytica, Zuckerberg përfundimisht kërkoi falje ndaj 87 milionë përdoruesve të Facebook, të dhënat e të cilëve ishin të shpërndara.

“Biznesi i Facebook do të përshpejtohet”, thotë Scott Galloway, një



Ekziston edhe fakti i thjeshtë që Facebook ka një monopol. “Përmasat e Facebook dhe paratë që ka, do të thotë se ata mund të fitojnë çdo konkurs”, thotë Galloway, duke treguar shembuj të tillë si WhatsApp dhe Instagram, të cilët u “zhytën” përfundimisht në gjigandin Facebook. Tani për tani, Facebook është ende i rrënjësor në jetën tonë të përditshme dhe nuk do të ketë një ikje të menjëhershme

profesor i marketingut në Universitetin e Nju Jorkut. “Konsumatorët e bëjnë shumë të madhe, por cili është vendi i parë ku ata “hidhen” për të shprehur zemërimin e tyre? Facebook dhe Instagram. Dhe me 2.2 miliardë përdorues aktivë çdo muaj, reklamuesit nuk kanë zgjidhje tjetër përveç përdorimit të Facebook”. Kompania kërkimore eMarketer parashikoi në Shkurt se numri i përdoruesve të rinj të Facebook është duke u ulur. 2.8 milionë

amerikanë të moshës 25 dhe më të rinj e kanë braktisur Facebook-un vitin e kaluar dhe me më shumë parashikime për largime në vitin 2018. Megjithatë, ka shumë stabilitete me ata më të mëdhenjtë në moshë, madje edhe me të moshuarit. E ardhmja e Facebook-it mund të ndryshojë vetëm nëse qeveritë në vende të ndryshme vendosin që të ndalojnë përdorimin e tij, për shkak të influencës që ka.

“Unë nuk mendoj se çështja është vrasja e Facebook-it”, thotë Sherry Turkle, profesoreshë e shkencave sociale dhe teknologjisë në Institutin e Massachusetts. “Unë mendoj se çështja është se çfarë do t’i bënte njerëzit ta përdornin Facebook-un në mënyrën jo të duhur. Tashmë jemi të vetëdijshëm për rrezikun e rrjedhjes së të dhënave dhe lajmet e rreme. Dhe kështu ekziston një lëvizje e konsumatorit që kërkon parametra më të përshtatshëm. Njerëzit kërkojnë të kontrollojnë se si Facebook përdor të dhënat e tyre dhe njerëzit venë në Facebook vetëm atë që ata janë të gatshëm të ndajnë me të tjerët”.

Ekziston edhe fakti i thjeshtë që

Facebook ka një monopol. “Përmasat e Facebook dhe paratë që ka, do të thotë se ata mund të fitojnë çdo konkurs”, thotë Galloway, duke treguar shembuj të tillë si WhatsApp dhe Instagram, të cilët u “zhytën” përfundimisht në gjigandin Facebook. Tani për tani, Facebook është ende i rrënjësor në jetën tonë të përditshme dhe nuk do të ketë një ikje të menjëhershme.

“Ajo që ka më shumë gjasa të ndodhë është se njerëzit fillojnë të kuptojnë se tregjet dhe ekonomia mund të jenë më mirë, duke nxitur, duke krijuar vende të reja pune, nëse do të ndërtojmë kompani të reja në vend të vetëm njëres”, thotë Galloway. Ky është një rezultat më i mundshëm sesa thjesht rrëzimi apo zhdukja e Facebook-it. Në mënyrë që kjo të ndodhë, qeveritë do ta bëjnë Facebook më pak të fuqishëm. Dhe ndërsa suksesi i Facebook ka kënaqur nevojat tona njerëzore për komunikimin, përmasat e tij, numri i madh i përdoruesve dhe fuqia qendrore – kanë sjellë një vështrim të pashembullt, siç e kemi parë gjatë kësaj jave në Evropë. (BBC)



“Ilaçet e zgjuarsisë” po shndërrohen në sëmundje

Teprohet me përdorimin e ilaçeve që rrisin përqendrimin për të shkëlqyer më tepër në studim apo punë. Tendenca është shtuar shumë jo vetëm në Evropë, por në mbarë botën. Përdorimi i ilaçeve si drogëra të lehta po bëhet shqetësues dhe në një sondazh të kryer mbi mijëra persona në 15 vende të ndryshme, rezultoi se 14% prej tyre i kanë konsumuar. Studiuesit thonë se nga viti 2015 rritja e përdorimit të “drogës inteligjente”, kështu është pagëzuar përdorimi i këtyre lloj ilaçesh, është rritur me 24%, kryesisht në Britani. Studimi është publikuar në revistën ndërkombëtare ‘Drug Policy’ dhe ‘Nature’. Ilaçet për të cilat bëhet fjalë, janë kryesisht ato që merren për trajtimin e deficitit të vëmendjes dhe hiperaktivitetit, ilaçe për çrregullimin e gjumit, e të tilla të ngjashme. Specialistët shprehen të alarmuar dhe e argumentojnë këtë rritje të përdorimit të medikamenteve të këtij spektri me stilin e jetës në epokën bashkëkohore. Kërkohej me ngulm fuqizimi i kapaciteteve mendore edhe nga personat që janë plotësisht të shëndetshëm. Kjo ngre shqetësime etike, përtej atyre shëndetësore pasi jeta frenetike po ndryshon perceptimet.

Nënat, “sekreti” për fëmijë të shëndetshëm



Sekreti i fëmijëve të shëndetshëm qëndron i gjithi tek nënat e tyre. Ato nëna që kanë ndjekur të paktën 5 rregulla të thjeshta gjatë jetës së tyre, kanë shumë më tepër mundësi t’i japin një trashëgimi të mirë krijesave të tyre. Bëhet fjalë për ato nëna që kanë pasur një regjim të mirë ushqimor, aktivitet fizik, peshë konstante dhe elegante, mungesë duhani dhe

përdorim alkooli të moderuar. Dhe fëmijët e lindur nga nënat që kanë respektuar këto rregulla, kanë 82 % mundësi më pak për të qenë obezë apo edhe mbipeshë, në krahasim me nënat që kanë pasur një jetë më të çrregullt. Ky është konkluzioni i studimit të kryer nga Harvard School of Public Health i publikuar në British Medical Journal. Kërkuesit kanë

ndjekur stilin e jetës të rreth 17 mijë nënave dhe kanë ekzaminuar të dhënat shëndetësore të 25 mijë fëmijëve të tyre. Rezultoi se obeziteti i nënës, jeta sedentare dhe vese të tjera lidheshin me të njëjtën formë obeziteti edhe tek fëmijët e tyre, ndryshe nga ato nëna të cilat kishin një formë fizike të mirë edhe pas lindjes së fëmijëve.

DASHI 21. mars - 20. prill
 Cjatë kësaj dite Hëna dhe Saturni janë në kundërshtim me shenjën tuaj dhe mund të ulin besimin që keni në vetvete. Mos mbysni ambiciet tuaja vetëm se mendoni se nuk mund t'ia dilni mbanë. Falë yjeve mike do të keni mundësi të organizoni një udhëtim në shoqërinë e personave që keni më shumë për zemër.

DEMI 21. prill - 21. maj
 Shpirti i iniciativës dhe guximi ju lejon të përfundoni me sukses edhe detyrat më të vështira këtë ditë. Gjithashtu do të jeni mjaft energjikë, të kthjellët dhe do të keni një dëshirë të madhe për t'u impenjuar shumë e për të arritur rezultate të kënaqshme. Cilësi këto që do ju lejojnë të jeni fitues në sektorin praktik dhe privat, edhe në rastet kur mund të hasni rivalitet.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor
 Për të lindurit e kësaj shenje humori po përmirësohet pak e nga pak dhe po rigjeni sërish besimin tek aftësitë tuaja. Mos e prisni këtë moment pozitiv, shfrytëzoni për të arritur objektiva të rëndësishëm, sidomos në sektorin profesional. Yjet e ditës së sotme ju sugjerojnë ta shikoni më mirë marrëdhënien sentimentale për të evituar vuajtje dhe humbje kohe.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik
 Një ditë e mirë kjo për ju. Në sektorin profesional do të keni aleanca dhe ndihma të rëndësishme, të cilat do ju ndihmojnë të ngriheni profesionalisht. Seleksiononi mirë personat me të cilët do të bashkëpunoni në ditët në vazhdim. Gjithsesi situata juaj profesionale dhe sentimentale paraqitet dinamike.

LUANI 23. korrik - 22. gusht
 Do të gjendeni përballë një propozimi profesional, që edhe pse do ju shtojë përgjegjësitë, ju paraqet një mënyrë më krijuese për të punuar. Dëgjoni sugjerimin e një mikut tuaj, edhe pse nuk është në favorin tuaj. Në qoftë se do të jeni objektiv në gjykimin e këtij sugjerimi, në të ardhmen do të keni mundësi të konstatoni që ka pasur të drejtë.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator
 Hëna dhe Saturni do të sjellin një lodhje fizike dhe shqetësime në marrëdhëniet sentimentale. Kini parasysh se keni një histori dashurie që e keni shumë për zemër. Përpara se të hidheni në një projekt të ri që ju tërheq shumë, sigurohuni se jeni liruar nga të gjitha çështjet që mund të keni lënë pezull.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor
 Klima që përshkon ditën e sotme do të jetë mjaft e favorshme. Do të ketë zhvillime të rëndësishme që do të sjellin fitime e mirëqenie, por mbi të gjitha do të sjellin njohje të reja që do të jenë të vlefshme për punën tuaj. Në sektorin e ndjenjave do të keni mundësi të sqaroni diskutime të bëra këto kohë e fundit.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor
 Tregohuni më tolerantë ndaj një kolegëve në punë. Dikush që për arsyen se do të tregohet më i kujdesshëm ka vendosur të ndjekë një ritëm më të ngadaltë pune sesa e kishit parashikuar, por duhet të jeni të qetë. Ndoshta jeni të stresuar nga shumë ngjarje që kanë ndodhur rreth jush, do ju bëjë mirë të shkëputeni nga rutina e përditshme.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor
 Këtë ditë duhet të përballeni me disa pengesa të vështira për t'u kaluar. Duke parë kalimin aspak të favorshëm të disa planetëve në shenjën tuaj, mundohuni të mos lodheni shumë e të mos përziheni në diskutime të mërzitshme me partnerin ose familjarët tuaj. Do të arrini rezultate të shkëlqyera në aktivitetet sportive dhe do ju paraqiten shanse të reja në sektorin profesional.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar
 Një ditë mjaft e mirë pritet për ata që i përkasin shenjës së Bricjapit. Do të paraqiten mundësi të mira profesionale dhe ekonomike, që do t'i arrini nëpërmjet miqësive e marrëdhënive me persona me influencë. Ndër të tjera ka ardhur momenti të mbyllni një zënkë të vjetër midis jush dhe një mikut tuaj.

UJORI 21. janar - 19. shkurt
 Mundohuni të vendosni kontakte me personat e duhur, sepse sot mund të arrini përfitime të konsiderueshme. Jo menjëherë, por do ju duhet të prisni disa ditë. Shijojeni mbrëmjen të mbushur me emocione në qoftë se jeni çift dhe me njohje të reja në qoftë se e keni zemrën e lirë.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars
 Hëna në kundërshtim ju bën mjaft dyshues, saqë do të arrini të shikoni vetëm komplete rreth jush. Proveni t'u jepni më shumë besim personave që ju rrethojnë dhe nuk do të pendohe- ni. Duke parë tensionin që rritet gjithnjë e më shumë, mundohuni ta shkarkoni, duke u marrë me ndonjë aktivitet sportiv.

Mensur Mamuti	FUTBOLLISTI BELG NË FOTO	QYTETI I LINDJES E FUTBOLLISTIT NË FOTO	KRYEQYTETI SHQIPTAR	LLOJ ARIU AUSTRALIAN	QYTET NË SLOVENI	NE KETE DATE				
FSHAT NË KOMUNËN E SARAJIT						16 KORRIK 1987				
BASHKIM										
POLITIKANI POLAK, ROBERT										
MAL AFER BEOGRADIT										
MONEDHA E MAQEDONISË										
RRYMIMI I AJRIT				AUSTRIA	VECANËRISHT, KRYESISHT					
MIHAL POPI			KALLAJ	SIPËRFAQE E MADHE UJORE						
AKTORI INDIAN, KABIR (SANDOKAN)					TENTIME VRASJEJE TË PERSONALITETEVE TË NJOHUR					
KËNGËTARJA TARIFA						AJNSHTAJNIUM	KA NDIKIM	KËNGËT E SUKSESSHME	SHKRONJË GREKE	VENDI I PREJARDHJES SË KËNGËTARIT NË FOTO
LITRI		EKIP I FUTBOLLISTIT NË FOTO								
ELI FARA			A MESI I DITËS	ISH FUTBOLLISTI SPANJOLL, GONZALES (SHQ.)						
KOHA	PËRGËZON					PARAARDHËS I ITALIANËVE				
	LOKALE NATE					INSTITUTI I PESHKATAREVE TË SPLITIT				
JO ELASTIKE									ITALIA SHKOVA	
LLOJ DRURI (SHQ.)				ELEMENT KIMIK	ASTATI					EKIP I FUTBOLLISTIT NË FOTO
LIQEN NË HUNGARI								POSEDON	JODI	
PËRCUES, EMTUES							RRIJEDHË E VOGËL UJI			




ZGJIDHJET: MATKA, UNION, STRAK, AVALA, DENAR, ERA, A, MP, SN, BEDI, ENEDA, L, TOTENHEM, EF, MESPITA, URON, ITAL, PLASTIKE, I, AHU, AZOTI, BALATON, KA, EMITER, JAZ.

Shumë i lehtë **Sudoku** **mesatar**

8		2						9	3			9	6			7
	4			3	7		2				4	8				
				9	4						8			5	9	
	7	1	3									5	2	1		
9												7		6		
4				5		1	8			7	6	4	9	8	3	5
											7			4	1	2
		6		1		2						3				
			7		6	3	4			3		2	1			4

Shumë i lehtë: 832561479, 149837526, 567294813, 671348952, 958172634, 423659187, 314925768, 786413295, 295786341. Mesatar: 351962478, 964873215, 728145936, 483521697, 519736842, 276498351, 897654123, 142387569, 635219784.

Teknologjia na ka bërë akoma më të ngjashëm me shimpanzetë!



Kushdo që vuan prej dhimbjes së shpinës duhet të ulë përdorimin e vazh-

dueshëm të smartfonit. Dy deri në katër orë të kaluara në celular i detyrojnë ver-

tebrat e para të shtyllës kurrizore me një ngarkesë e cila mund të arrijë deri në 27 kg presion, pra përafërsisht kjo është pesha e një fëmije 7-8 vjeç. Dhimbja e shpinës e cila ka prekur pjesën më të madhe të popullsisë "moderne" mund të jetë shkak i një evolucioni jo perfekt. Nga kalimi i ecjes me katër këmbë me shpinën lart, shtylla kurrizore ka ndryshuar. Ky ndryshim nuk është bërë në mënyrë perfekte dhe madje disa nga karakteristikat vertebrale të "kushërinjve primat" mund të jenë trashëguar te ne deri sot. Personat që vuajnë nga probleme të shpinës mund të kenë shtyllë kurrizore më të ngjashme me atë të shimpanzeve, më pak të aftë për të përballuar presionin e të ecurit në këmbë.

Shkencëtare që 12 vjeç



Gitanjali Rao është vetëm 12 vjeç. E cilësuar si shkencëtarja më e re në Amerikë, ajo u lehtësoi jetën shumë njerëzve me pajisjen që shpiku. Kur Gitanjali pa në televizor se në Flint të Michiganit njerëzit po protestonin për cilësinë e ujit, u përvesh punës në laboratorin e shkollës së saj, për të ndihmuar këtë komunitet. Pajisja që ajo krijoi quhet "Tethys" dhe është në gjendje të masë sasinë e metaleve të rënda në ujë, vetëm nëpërmjet një aplikacioni të thjeshtë në celular. Shpikja e saj i ndihmoi banorët e Flintit dhe mund të jetë zgjidhja e problemit për shumë njerëz në mbarë botën, që kanë të njëjtin problem me ujë e pijshëm.

Çifti divorcohet pas 14 vitesh për faj të... Messit dhe Ronaldos



Ata ishin njohur 14 vite më parë në një lokal sportiv në Chelyabinsk, në Rusi. Dashuria për futbollin i bashkoi. Arsen 40 vjeç dhe Lyudmila 37 vjeç ranë në dashuri me njëri-tjetrin pikërisht gjatë Botërorit të vitit 2002. Arsen është tifoz i Barcelonës dhe mbështet Messin. Ndërsa Lyudmila është tifozë e Real Madrid dhe fanse e Cristiano Ronaldo. Por simpatia për dy lojtarët më të mirë të botës, bëri që ata të divorcoheshin.

Arsen thotë se ai dhe bashkëshortja bënë vazhdimisht shaka për Messin dhe Ronaldon, por ky Botëror i vuri "kapakun" martesës së tyre. Sipas tij, Lyudmila tallej vazhdimisht me Messin pas dështimit të Argjentinës në Kupën e Botës. Kulmi arri-

ti, thotë ai, në ndeshjen e Argjentinës me Nigerinë, kur gruaja nuk ndalonte së tallej Messi. Ndërsa 40-vjeçari këtë gjë nuk e duronte dot.

"Që kur filloi Kupa e Botës, Lyudmila vazhdimisht tallej me mua dhe lojtarin tim të preferuar, duke thënë se ai luante shumë keq dhe as nuk mundi të shënonte një penallti të rëndësishme që ishte në ndeshjen me Islandën. U zemërova, ndërkohë dhe unë shpreha gjithçka që ndjeja për Ronaldon e saj të bukur dhe kombëtarën portugeze, për atë vet dhe për të gjitha skuadrat e tjera që Lyudmila simpatizon. Pastaj mora gjërat e mia dhe e lashë atë njëherë e mirë", ka thënë 40-vjeçari për një gazetë lokale ruse.

Mosha kur njerëzit janë më të lumtur



Njerëzit në Mbretërinë e Bashkuar ka më shumë mundësi të jenë të lumtur në marrëdhënien e tyre kur mbushin 40 vjeç. Sipas një sondazhi britanik, sukcesi në jetë dhe lumturia në marrëdhënie vijnë pasi keni mbushur 30 dhe 40 vjeç. Në këtë sondazh u pyetën 2000 persona dhe u nxor përfundimi se femrat e shijonin rininë dhe beqarinë kur ishin 23 vjeç, ndërsa meshkujt kur ishin 25. Për sa i përket shëndetit, mosha 30-vjeçare është më e mira, pasi njerëzit e lënë pas stilin e shfrenuar të jetesës dhe nisin të kujdesen më shumë për veten. Mosha kur njerëzit janë më të lumtur me marrëdhënien e tyre është ajo 40-vjeçare. Mes kësaj moshe, 38 vjeç dhe 42 vjeç, arrijnë sukseset profesionale në përgjithësi.

622 - Fillimi i kalendarit islamik.
1099 - Luftëtarët e kryqëzatave grumbulluan hebrejtë e Jerusalemit në një Sinagogë dhe i kanë vënë flakën.
1212 - Beteja e Las Navas de Tolosa: përfundimi i epokës myslimane në Spanjë.
1439 - U ndalua të puthurit në Angli.
1519 - Debat i publik mes Martin Luterit dhe teologut Xhon Ek.
1661 - U lëshuan në përdorim bankënotat e para në Evropë nga Banka e Stokholmit.
1683 - Trupat turke arrijnë në Vjenë.
1980 - Ronald Regan nominohet për kryetar nga Republikanët në Detroit.
1999 - Xhon F. Kenedi Jr., dhe gruaja e tij Karolin Beset Kenedi vdesin gjatë një aksidenti ajror në Martha's Vineyard. Aeroplani ka qenë i drejtuar nga vet Kenedi.



Nëse prej kohësh e kufizoni vetën nga ngrënia e çokolatës që tani do të mësoni se ky mëkat i ëmbël sjell shumë përfitime. Nga një studim i bërë nga Harvard School of Public Health tregon se njerëzit që konsumojnë më shumë se 45 gramë çokolatë në javë kanë 20% më pak mundësi të preken nga hemorragjia cerebrale. Sipas studimit ngrënia e rregullt e çokolatës rrit prodhimin e insulinës, duke reduktuar kështu rrezikun e diabetit. Veçanërisht çokollata e zezë është e shëndetshme për zemrën, lufton inflamacionin dhe redukton rreziqet kardiovaskulare. Gjithashtu çokollata hollon gjakun dhe ka efekte të ngjashme me aspirinën.

KUSH E THEU XHAMIN?

Xhoni u kthye nga shkolla në shtëpi duke qarë.
- Pse qan? - e pyet mamaja e tij.
- Më qëlloi mësuesi.
- Dhe pse të qëlloi?
- Sepse u përgjigja në një pyetje, që asnjë nxënës tjetër nuk iu përgjigj.
- Dhe çfarë pyetje ishte ajo?
- "Kush theu xhamin e shkollës".



Të jesh është të perceptosh. Nëse një pemë bie në pyll dhe askush s'e dëgjon, a bën zhurmë?
(GEORGE BERKELEY)